

Marrëveshja për hedhjen e hirit dhe gipsit¹

ndërmjet

Kosovo Energy Corporation J.S.C.

dhe

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.

**HUNTON &
WILLIAMS**

John J. Beardsworth, Jr.
951 E. Byrd St.
Richmond, VA 23219
Telefoni: +1 804 788 8637
jbeardsworth@hunton.com

¹ Kjo marrëveshje është përkthyer në shqip nga origjinali në Anglisht

Pasqyra e përmbajtjes

Article 1	Përkufizimet; Interpretimi.....	1
1.1.	Përkufizimet	1
1.2.	Interpretimi	13
Article 2	Data e ekzekutimit; afati	15
2.1.	Data e hyrjes në fuqi; afati.....	15
Article 3	Përditësimi i Planit të Rikultivimit të Fushës së Minierave B&M/Sibovcit Jugor dhe Finalizimi i Lokacionit.....	15
3.1.	Përzgjedhja e Lokacionit dhe Finalizimi i Përzgjedhjes së Lokacionit	15
3.2.	Detyrimi për përditësimin e Planit të Rikultivimit	16
3.3.	Miratimi nga KPMM.....	16
Article 4	Largimi i hirit, largimi i gipsit	17
4.1.	Largimi i hirit	17
4.2.	Largimi i gipsit	18
4.3.	Dhënia e të drejtave të nevojshme pronësore	19
4.4.	Pranimi i përdorimeve të lokacioneve të tjera	19
4.5.	Toka e KEK Mihjes.....	20
Article 5	Përgjegjësia për deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo dhe Sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit	20
5.1.	Transferimi i kujdestarisë dhe kontrollit	20
5.2.	Përgjegjësitë operacionale	20
5.3.	Mbrojtja e deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo dhe Sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit	21
Article 6	Koordinimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo.....	21
6.1.	Koordinimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo	21
6.2.	Procedurat në Lokacion të KEK Mihjes.....	22
6.3.	Rregulloret e GenCo.....	22
Article 7	Rikultivimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo	22
7.1.	Rikultivimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo	22
Article 8	Mbrojtja e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë.....	23
8.1.	Mbrojtja e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë	23

Article 9		
	Zgjerimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo	24
9.1.	Zgjerimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo	24
Article 10		
	Titulli dhe rreziku i humbjes	24
10.1.	Titulli dhe rreziku i humbjes së Hirit.....	24
10.2.	Titulli dhe rreziku i humbjes së Gipsit	24
Article 11		
	Tarifat	25
11.1.	Pa tarifa.....	25
Article 12		
	Tatimet.....	25
12.1.	Tatimet e zbatueshme për Mihjen e KEK-ut	25
12.2.	Tatimet që vlejné për GenCo-n	25
Article 13		
	Sigurimi.....	25
13.1.	Mirëmbajtja e Policave të Sigurimit -- GenCo	25
13.2.	Mirëmbajtja e sigurimit - KEK Mihja	25
Article 14		
	Zotimet dhe garancitë.....	26
14.1.	Zotimet dhe garancitë e GenCo-s	26
14.2.	Zotimet dhe garancitë e Mihjes së KEK-ut	27
14.3.	Riafirmimi i zotimeve dhe garancive	28
Article 15		
	Zhdëmtimi	28
15.1.	Zhdëmtimi	28
15.2.	Kufizimi në zhdëmtim	30
15.3.	Parashtrimi i kërkesave që tejkalojnë shumën minimale të zhdëmtimit.....	31
15.4.	Mbrojtja e Kërkesave.....	31
Article 16		
	Kufizimi i përgjegjësisë	33
16.1.	Kufizimi i përgjegjësisë.....	33
Article 17		
	Shkelja; Shkëputja.....	33
17.1.	Rastet e Shkeljes nga GenCo.....	33
17.2.	Rastet e Dështimit nga Mihja e KEK-ut	34
17.3.	Njoftimi për QEK-në në lidhje me Rastet e shkeljes nga Mihja e KEK-ut	36
17.4.	Njoftimi për Shkëputjen	36
17.5.	Obligimet që pasojné Njoftimin për Shkëputjen	36
17.6.	Mjetet tjera juridike	36
17.7.	Obligimet pas Shkëputjes së Marrëveshjes së Implementimit	37

17.8.	E drejta e shkëputjes për dështim në respektim të Datës së Transferimit.....	37
Article 18		
	Forca madhore	37
18.1.	Forca madhore	37
18.2.	Obligimet e njoftimit	39
18.3.	Detyrimi për zbutje	40
18.4.	Dështimet apo Vonesat e shkaktuara nga Forca Madhore.....	40
18.5.	E drejta e shkëputjes pas një Rasti të Forcës Madhore Politike apo Ndryshimit në Ligj.....	40
Article 19		
	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	41
19.1.	Njoftimi për Kontestin.....	41
19.2.	Procedurat e Zgjidhjes së mosmarrëveshjeve	41
19.3.	Kontestet teknike	42
19.4.	Kontestet në Pagesa	43
19.5.	Arbitrazhi.....	44
19.6.	Kontestet e ndërlidhura.....	46
19.7.	Obligimet Vazhdojnë.....	46
19.8.	Aktet komerciale	46
19.9.	Imuniteti Sovran; Juridiksioni	46
Article 20		
	Të ndryshme	47
20.1.	Njoftimet.....	47
20.2.	Ndryshimet	48
20.3.	Bashkëpunimi, ndihma dhe informimi nga Mihja e KEK-ut	49
20.4.	Mbijetesa	49
20.5.	Palët e Treta Përfituese	49
20.6.	Nuk ka Heqje Dorë	49
20.7.	Marrëdhënia mes Palëve.....	49
20.8.	Shpenzimet e Palëve	49
20.9.	Pëlqimi.....	50
20.10.	Gjuha	50
20.11.	Ligji Qeverisë.....	50
20.12.	Tërësia	50
20.13.	Caktimi	50
20.14.	Kontraktimi.....	51
20.15.	Konfidencialiteti	51
20.16.	Nuk ka përgjegjësi për shqyrtim.....	52
20.17.	Palët homole	53
20.18.	Sigurimet e mëtutjeshme	53
20.19.	Pandashmëria.....	53
20.20.	Pavlefshmëria e Pjesshme	53

KJO MARRËVESHJE PËR HEDHJEN E HIRIT DHE GIPSIT (kjo “Marrëveshje”) lidhet më 19 shkurt 2018 (“Data e ekzekutimit”) nga dhe ndërmjet:

- (1) **ContourGlobal Terra 6 s.à r.l.** (“GenCo”), shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar (société à responsabilité limitée) organizuar në kuadër të ligjeve të Dukatës së Madhe të Luksemburgut, me zyrën e regjistruar në adresën 35-37 Avenue de la Liberté, L-1931 Luxembourg, Dukata e Madhe e Luksemburgut, si dhe regjistruar në Regjistrin e Tregtisë dhe Kompanive të Luksemburgut, me numrin B 195.738; dhe
- (2) **Korporata Energjetike e Kosovës, SH.A.** (“Mihja e KEK-ut”), shoqëri aksionare organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrë qendrore në adresën Nënë Tereza nr. 36, Prishtinë, Kosovë, si dhe numër të regjistrimit të biznesit 70325399, duke operuar përmes njësisë së vet afariste përgjegjëse për kapacitetet gjeneruese.

Secila prej palëve, Mihja e KEK-ut dhe GenCo në këtë marrëveshje do të referohen si “Pala” dhe bashkërisht si “Palët.”

PËRSHKRIMET (RECITALE)

- A. Si politikë, QEK mëton të angazhojë sektorin privat në një projekt infrastrukturor, i cili përfshin zhvillimin, projektimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, operimin dhe mirëmbajtjen e stabilimentit TCKR (të definuar si më poshtë) si dhe rehabilitimin e Lokacionit (të definuar si më poshtë) nga GenCo (“**Projekti Kosova e Re**”);
- B. Mihja e KEK-ut ka në pronësi deponinë ekskluzive të hirit GenCo (siç përcaktohet më poshtë) dhe deponinë ekskluzive të gipsit GenCo (siç përcaktohet më poshtë) që gjenden në lokacionin e përzgjedhur sipas nenit 3.1;
- C. GenCo mëton të formojë një subjekt të ri të organizuar sipas ligjeve të Kosovës (“**CG Kosova**”), si dhe pas formimit të CG Kosova, GenCo synon t’ia bartë të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat tek ajo, si dhe t’ia delegojë të gjitha obligimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje tek CG Kosova, ndërsa furnizuesi njeh dhe jep pëlqimin për bartjen e tillë;
- D. Në lidhje me Projektin Kosova e Re, GenCo dëshiron të dorëzojë tek KEK Mihja në deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo dhe KEK Mihja dëshiron të pranojë nga GenCo hirin (të përkufizuar në vijim) dhe gipsin (e përkufizuar në vijim) t caktuar të gjeneruar nga veprimtaria e Impiantit TCKR në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara më poshtë; dhe
- E. GenCo dëshiron dhe KEK Mihjet dëshiron për Genco që të operojë dhe mirëmbajë deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo.

PRANDAJ, duke pasur parasysh premtimet dhe pajtimet e ndërsjella të përfshira në këtë dokument, dhe me qëllim që të jenë ligjërish të detyrueshme, Palët bien dakord si më poshtë:

Article 1

Përkufizimet; Interpretimi

1.1. Përkufizimet

Sa herë që të paraqiten shprehjet vijuese me shkronjë të parë të madhe në këtë Marrëveshje, në Listat, ose Shtojcat, ato do të kenë kuptimet si në vijim:

“**Braktisja (GenCo)**” - Ndërprerja vullnetare për një periudhë prej 30 Ditëve të njëpasnjëshme të operimit të Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo ose të Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo për arsye që janë ndryshe nga:

- (a) Shkelja apo kundërvajtja nga Mihja e KEK-ut sipas kësaj Marrëveshjeje;

- (b) Veprimi apo mosveprimi i i NP-së së Specifikuar, ose Rasti i Kundërvajtjes nga QEK-ja (sipas përkufizimit në Marrëveshjen e Implementimit), sipas Marrëveshjes së Implementimit; ose
- (c) Rasti i Forcës Madhore.

“Palë e ndërlidhur” - Çdo person, çdo personi tjetër që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet një ose më shumë ndërmjetësve, kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët me Personin e tillë; me kusht që “Personi i ndërlidhur” në asnjë rast (përveç në lidhje me detyrimin e konfidencialitetit dhe zbulimin e lejueshëm të përcaktuar në Nenin 20.15(c)(i)) nuk përfshin ndonjë Person që ka interes kapital të drejtpërdrejt ose tërthortë në Sponsorin Përfundimtar. Për qëllimet e këtij përkufizimi, “kontroll” (përfshirë kuptimet e ndërlidhura, termat “kontrollues”, “nën kontroll të përbashkët me”, si dhe “kontrolluar nga”), kur përdoret në lidhje me ndonjë person, do të thotë posedim, drejtpërdrejt apo tërthorazi, i fuqisë për të drejtuar apo shkaktuar drejtimin e menaxhmentit apo politikave të atij Personi, qoftë përmes pronësisë së aksioneve votuese apo interesave të tjera të kapitalit, me kontratë apo ndryshe. Për qëllimet e këtij përkufizimi, secila NP e Specifikuar (përveç Mihjes së KEK-ut) dhe QEK është “Degë e Ndërlidhur” e Mihjes së KEK-ut.

“Marrëveshje” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Periudha e Zbatuar e Sanimit nga Pala Homologe” – periudha që vlen për sanim të rastit të kundërvajtjes nga Mihja e KEK-ut sipas kësaj Marrëveshjeje, siç parashihet me këtë Marrëveshje.

“Standardet e zbatueshme” – Bashkërisht,

- (a) Standardet Mjedisore;
- (b) Standardet e Shëndetit dhe Sigurisë;
- (c) Standardet e Zhvendosjes;
- (d) Standardet Sociale; si dhe
- (e) Për aq sa nuk përshkruhen më lart, ligjet tjera të Kosovës si dhe Pëlqimet që parashohin Standarde në lidhje me rreziqet mjedisore, sociale, të punës, shëndetit dhe sigurisë apo rendit, të llojit të trajtuar me Standardet e IFC-së për Qëndrueshmëri Mjedisore dhe Sociale, apo që parashohin përgjegjësi për shkeljen e tyre.

“Kushtet Arkeologjike” – nënkupton kushtet arkeologjike në Lokacion, që kërkojnë vlerësimin dhe mbrojtjen në pajtim me ligjet e Kosovës dhe Standardet Mjedisore.

“Hiri” - Substancë e përbërë nga mbetjet e linjtit të djegur gjeneruar nga djegia e linjtit nga centrali TCKR, duke përfshirë perzierjen e substancës së tillë me ujë ose materiale të tjera jo të rrezikshme për të lehtësuar transportimin e tyre. Hiri, siç përdoret në këtë Marrëveshje, përfshin të gjitha mbetjet e djegies së qymyrit të prodhuara zakonisht nga djegia e qymyrit në termocentralet me qymyr, duke përfshirë: hirin fluturues, hirin fundor, zgjyrën e kaldajës dhe materialin e desulfurizimit të gazrave të zjarrit.

“Korridori i tubacionit të llaçit të hirit/gipsit” - Toka në të cilën është apo do të instalohet një pjesë e sistemit të tubacionit të llaçit të hirit/gipsit në mes të Lokacionit dhe vendit të përzgjedhur sipas nenit 3.1. Sistemi i tubacionit të llaçit të hirit/gipsit përfshin një korridor toke të nevojshme për ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të tubacionit të llaçit të hirit/gipsit (i) në , mbi dhe nëpërmjet një korridori toke në mes të Lokacionit të Impiantit (TCKR) dhe Tokës së Mihjes së KEK, dhe (ii) në, mbi dhe përmes tokës së Mihjes së KEK në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo.

“Sistemi i Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit” - Tubacionet dhe pajisjet e shoqëruara (duke përfshirë pompat (duke përfshirë pompat e riqarkullimit dhe shtëpitë e pompave), mbajtëset e tubave, varëset, mbështetësit dhe instalimet dhe linjat e furnizimit me energji elektrike) që përdoren (i) për të transportuar hirin nga Impianti TCKR në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe për ta transportuar gipsin nga

Impianti TCKR tek Deponia Ekskluzive e Gipsit të GenCo dhe (ii) për ta riqarkulluar ujin nga Deponia Ekskluzive e Hirit të GenCo dhe nga Deponia Ekskluzive e Gipsit të GenCo në Impiantin TCKR ose, nëse lejohet sipas pëlqimeve të GenCo dhe Standardeve të Mjedisit, në lumin e afërm Sitnica (ose një kanal tjetër ujqor të afërm që është i pranueshëm nga GenCo në lidhje me përzgjedhjen e lokacionit) me qëllim që t'i mundësojë GenCo ta largojë ujin e tepërt nga Deponia Ekskluzive e Hirit të GenCo dhe Deponia Ekskluzive e Gipsit të GenCo në përputhje me pëlqimet e GenCo dhe standardet mjedisore.

“Minierat B&M” - Gropat e minierave të njohura si “Minierat Bardh dhe Mirash”, siç përshkruhet më tutje në Skemën 1.

“Plani i rikultivimit të fushës së minierave B&M/minierës së Sibovcit” - do të thotë,

- (a) nëse Mihja e KEK-ut zgjedh Minierat B&M si lokacioni për Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo ose Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo në përputhje me Përzgjedhjen e Lokacionit, plani i rikultivimit në lidhje me Minierat B&M të përfshira në Planin Plotësues të Mihjes për Minierën Jugperëndimore të Sibovcit të përgatitur nga Konsorciumi STEAG, i muajit maj 2006 dhe i miratuar nga KPMM, azhurnuar nga Mihja e KEK-ut në pajtim me këtë Marrëveshje dhe më pas miratuar nga KPMM; ose
- (b) nëse Mihjet e KEK-ut përzgjedhin Fushën e minierës së Sibovcit Jugor si Deponi Ekskluzive e Hirit të GenCo ose deponi Ekskluzive të Gipsit të GenCo në përputhje me përzgjedhjen e lokacionit, çdo plan ekzistues i rikultivimit që lidhet me fushën e minierës jugore të Sibovcit.

“Ditë pune” - Çdo Ditë përveç të shtunës, të dielës, apo Ditëve në të cilën bankat komerciale në Prishtinë, Kosovë, janë të lejuara me ligj që të jenë të mbyllura për punë.

“CG Kosovë” - Ka kuptimin e cekur në recitale.

“Ndryshime në ligj” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

“Ndryshimet në cilësinë e ujit brut” - ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

“Dokumentet themeltare” - Për sa i përket një subjekti të posaçëm:

- (a) të gjitha dokumentet e organizimit dhe qeverisjes, përfshirë të gjitha dokumentet e miratuara ose të paraqitura në lidhje me krijimin, formimin ose organizimin e një subjekti të tillë;
- (b) të gjitha marrëveshjet e aksionarëve, marrëveshjet e votimit, marrëveshjet e besimit të votimit, marrëveshjet e kompanisë, marrëveshjet e operimit, marrëveshjet e partneriteteve, marrëveshjet për të drejtat e regjistrimit, apo marrëveshjet e ngjashme; dhe
- (c) të gjitha ndryshimet e plotësimet e tyre.

“Pëlqimi” - Të gjitha miratimet, pëlqimet, autorizimet, njoftimet, koncesionet, pranimet, licencat, lejet, vendimet ose të ngjashme që kërkohen nga çdo autoritet publik me juridiksion mbi Projektin e Kosova e Re sipas të gjitha ligjeve të Kosovës për cilindo nga GenCo, Huadhënësi, Sponsor HoldCo, Sponsor përfundimtar, dhe Kontraktuesit e GenCo në lidhje me Projektin Kosova e Re.

“Kontratat e ndërtimit/mirëmbajtjes” - Kontrata EPC, Marrëveshja LTM, Kontrata e O&M, Kontrata EPC e punëve të kyçjes së GenCo, Kontrata e specifikuar e Rehabilitimit të Gjendjes Mjedisore, dhe Marrëveshjen për Shërbime Administrative (të përcaktuar në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë), bashkërisht.

“Kontraktuesit” - Kontraktuesit e drejtpërdrejtë të cilësdo Palë dhe nëkontraktuesit e tyre të drejtpërdrejtë, në secilin rast, të cilët janë të përfshirë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje apo çfarëdo aktiviteti që ka të bëjë me Projektin Kosova e Re.

“Dita” - Një periudhë prej njëzetekatër (24) orësh, duke filluar në orën 00:00 të secilës ditë dhe shprehja “Ditore” do të interpretohet në përputhje me rrethanat.

“Mosmarrëveshje” – Çdo kontest, mosmarrëveshje, kundërthënie apo dallim mes Palëve që lind në kuadër të, nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo kontest, mosmarrëveshje, kundërthënie apo dallim që ka të bëjë me ekzistencën, ligjshmërinë, vlefshmërinë apo realizueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje, apo ndonjë dispozite të saj apo përmbushjen apo shkeljen e ndonjërës Palë sipas dispozite të Marrëveshjes, si dhe që përfshin çdo kontest, mosmarrëveshje, kundërthënie apo dallim mes Palëve, QEK-së, NP-ve të Specifikuara, Kompanisë Holding SponSore, apo Sponsorit Ultimativ, në lidhje me detyrimet jo-kontraktuese që lindin në kuadër të, nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje.

“Plani i Menaxhimit MS” – çdo plan menaxhimi për mjedisin dhe çështjet sociale përgatitur në pajtim me Standardet e Zbatueshme nga apo në emër të GenCo-s (apo inkorporuar nga apo në emër të GenCo-s nga një plan i përgatitur nga palët tjera) në bazë të dhe në pajtim me VNMS-në (GenCo).

“Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it” – Politika Mjedisore dhe Sociale e publikuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në dispozicion në Datën e Ekzekutimit (me rivendosje të mundshme të ardhme) tek <http://www.ebrd.com/downloads/research/policies/2008policy.pdf> apo ndonjë version i mëvonshëm që duhen zbatuar nga cilido Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit.

“Data Efektive” – ka kuptimin e dhënë në Paragrafin 2.1.

“Gjendja mjedisore” – kushtet, rrethanat apo çështjet tjera faktike që lidhen me apo ndryshe ndikojnë në mjedis, që shkelin apo ndryshe shpien në përgjegjësi që rrjedh nga Standardet Mjedisore, duke përfshirë ato në lidhje me resurset natyrore (duke përfshirë florën dhe faunën), dheun, ujërat sipërfaqësorë, ujërat nëntokësorë, furnizimet aktuale apo potenciale të ujit të pijes, shtresat nën sipërfaqe, apo ajrin e ambientit. Kushtet Mjedisore përfshijnë:

- (d) Kushtet, rrethanat apo çështjet tjera faktike që lidhen me apo lindin nga prania, përdorimi, manipulimi, deponimi, trajtimi, riciklimi, gjenerimi, transportimi, lirimi, derdhja, rrjedhja, pompimi, shkarkimi, injektimi, ikja, kullimi, hudhja (përfshirë edhe braktisjen apo hedhjen e hirit, fuçive, kontejnerëve dhe enëve të tjera të mbyllura me përmbajtje të Materieve të Rrezikshme, hedhjen në mbeturina, apo kërcënimin për të liruar materie të Rrezikshme, duke përjashtuar gjurmët e materieve që shkojnë me linjitin, të cilat depozitohen në pajtim me Marrëveshjet e Projektit dhe Standardet Mjedisore; dhe
- (e) Kushtet, rrethanat apo çështjet tjera faktike që shpien drejt ekspozimit të ndonjë Personi ndaj Materieve të Rrezikshme.

“Gjendja Mjedisore/ Arkeologjike” – përfshin Kushtet Arkeologjike dhe Kushtet Mjedisore, bashkërisht.

“Standardet Mjedisore” – në lidhje me ndonjërën Palë, bashkërisht, në lidhje me pjesëmarrjen e asaj Palë në Projektin Kosova e Re, si dhe vetëm deri në masën që vlen për atë Palë apo për Projektin Kosova e Re,

- (a) Komponentët mjedisorë të Planit të Menaxhimit MS;
- (b) Standardet mjedisore të parapara me Politikën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore;
- (c) standardet mjedisore të parapara me Udhëzuesit MSHS të Grupit të Bankës Botërore;
- (d) Standardet mjedisore të parapara me Standardet e Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale të IFC-së;
- (e) Standardet mjedisore të parapara me Standardet e Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale të MIGA-s;
- (f) Standardet mjedisore të parapara me Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it;

(g) Kërkesat e parapara me legjislacionin e Kosovës në lidhje me mjedisin dhe mbrojtjen e ruajtjen e tij,

Përveç deri në masën që dispozitat e parapara në dy apo më shumë dokumente të lartpërmendura janë të tilla që Pala nuk mundet që njëkohësisht të respektojë dispozitat e tilla, e në këtë rast renditja e standardeve të lartpërmendura do të jetë rendi i prioritetit, si dhe dispozitat relevante të standardit përkatës të renditur më poshtë (apo standardeve, sipas nevojës) nuk vlen për atë masë sa t'i mundësohet asaj Pale që të jetë në përputhje me standardin e rendit më të lartë. Për shmangie të dyshimeve, asnjë dispozitë në këtë marrëveshje nuk e heq detyrimin e Palës që të respektojë standardin më strikt nga standardet e lartpërmendura.

“Kontrata EPC” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Kontraktori EPC” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

“ZRRE” - Zyra Rregullative e Energjisë dhe çdo agjenci tjetër pasuese apo zëvendësuese rregullative me autoritet dhe jurisdikcion mbi sektorin e energjisë në Kosovë.

“VNMS (GenCo)” – Vlerësimi i ndikimit mjedisor dhe social, që ndërlidhet me Projektin Kosova e Re, kryer nga, , ose në emër të , GenCo-s në pajtim me Ligjet e Kosovës, Standardet e Zbatueshme, si dhe kërkesat e Huadhënësve.

“Euro” apo “€” – Valuta e vetme e shteteve anëtare pjesëmarrëse të Bashkimit Evropian.

“Data e ekzekutimit” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Përmbyllja Financiare” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

“Dokumntet Financiare” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

“Rasti i Forcës Madhore” – ka kuptimin e dhënë në Nenin 18.1.1.

“GenCo” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Veprimi apo Mosveprimi i GenCo-s” – veprimi apo mosveprimi i GenCo-s apo ndonjë Pale të GenCo-s, veprim apo mosveprim ky që përbën shkelje apo kundërvajtje materiale ndaj detyrimeve të GenCo-s sipas kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë Marrëveshje të Projektit në të cilën është palë, apo përbën shkelje materiale të ligjeve të Kosovës nga GenCo apo ndonjë Palë e GenCo-s, si dhe veprim apo mosveprim që ka efekt negativ në aftësinë QK apo ndonjë NP specifik për t'i kryer obligimet e saj apo ushtruar të drejtat e saj sipas kësaj Marrëveshjeje apo çdo marrëveshjeje të projektit; megjithatë, me kusht që veprimi apo mosveprimi i tillë të mos konsiderohet Veprim apo Mosveprim i GenCo-s nëse veprimi apo mosveprimi i tillë shkaktohet krejtësisht apo në masë të madhe nga një Veprim apo Mosveprim i NP-së së Specifikuar.

“Kontrata EPC për punimet e lidhjes së GenCo” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Kontraktori EPC për Punët e Kyçjes së GenCo-s” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

“Pëlqimet e GenCo-s” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Implementimit.

“Kontraktori i GenCo-s” – Kontraktori EPC, Kontraktori LTM, Kontraktori për OeM, Kontraktori EPC për Punët e Kyçjes së GenCo-s, Kontraktori i Specifikuar për Rivendosjen e Gjendjes Mjedisore (definuar me Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë), Kontraktori për Shërbime Administrative (definuar me Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë), si dhe cilido prej Kontraktorëve të tjerë të GenCo-s të angazhuar në Projektin Kosova e Re, duke përfshirë NP-të e Specifikuara.

“Rasti i Kundërvajtjes së GenCo-s” – ka kuptimin e dhënë në Nenin 17.1.

“Ddeponia Ekskluzive e Hirit të GenCo” - Çdo një ose më shumë pjesë të lokacionit të përzgjedhur sipas nenit 3.1 në të cilin hiri mund të largohet e që është në përputhje me Planin e Rikultivimit të Minierave B&M/Fushës së Minierës së Subovcit Jugor (sipas rastit) dhe Standardet Mjedisore. Për të shmangur dyshimet, asgjë këtu nuk do të parandalojë që Deponia Ekskluzive e Hirit të GenCo të jetë pellg ose të jetë një lokacion i vetëm për qëllime të largimit të përzierjes së Hirit dhe Gipsit, nëse kjo parashikohet sipas kushteve të planit të rikultivimit të minierës B&M/Fushës së Minierës së Sibovcit Jugor (nëse është e aplikueshme) dhe standardet e aplikueshme. Deponia e ekskluzive e deponimit të hirit e GenCo do të përfshijë një lokacion për deponimin e Materialit të rrezikshëm ndaras dhe veçuar nga Hiri nëse kërkohet me Standarde Mjedisore.

“Ddeponia Ekskluzive e Gipsit të GenCo” - Çdo një ose më shumë pjesë të lokacionit të përzgjedhur sipas nenit 3.1 në të cilin gipsi mund të largohet e që është në përputhje me Planin e Rikultivimit të Minierave B&M/Fushës së Minierës së Subovcit Jugor (sipas rastit) dhe Standardet Mjedisore. Për të shmangur dyshimet, asgjë këtu nuk do të parandalojë që Deponia Ekskluzive e Gipsit të GenCo të jetë pellg ose të jetë një lokacion i vetëm për qëllime të largimit të përzierjes së Hirit dhe Gipsit, nëse kjo parashikohet sipas kushteve të planit të rikultivimit të minierës B&M/Fushës së Minierës së Sibovcit Jugor (nëse është e aplikueshme) dhe standardet e aplikueshme.

“Palë e GenCo” Aksionar, drejtor, zyrtar, punëtor, Kontraktor i GenCo-s, përfaqësues, agjent, anëtar, menaxher apo Degë (I Afërt) e Gjeneratorit.

“Licenca e Gjenerimit” - Licenca e lëshuar nga ZRRE-ja që lejon gjenerimin dhe furnizimin e energjisë elektrike nga TCKR siç parashikohet nga Marrëveshja e Blerjes së Energjisë Elektrike.

“QEK” – Republika e Kosovës, duke vepruar përmes Qeverisë së Kosovës.

“Garanci Qeveritare” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Implementimit.

“Gipsi” - gipsi, duke përfshirë papastërtitë që nuk janë Lëndë të Rrezikshme (pa përfshirë materialet gjurmë që janë brenda linjtit), të gjeneruara në Impiantin TCKR.

“Materie e Rrezikshme” – çdo ndotës, kontaminues, mbetje solide, produkt hidrokarbur, substancë apo mbeturinë toksike apo e rrezikshme, çdo materie e ndezshme, plasëse apo radioaktive e rregulluar me, apo që i nënshtrohet, ndonjë Standardi Mjedisor.

“Standardet e Shëndetit dhe Sigurisë” – Bashkërisht, në lidhje me pjesëmarrjen e GenCo-s në Projektin Kosova e Re vetëm deri në masën që vlen për GenCo-n apo Projektin Kosova e Re, kërkesat e vendosura nga:

- (a) standardet e shëndetit dhe sigurisë të parapara me Udhëzuesit MSHS të Grupit të Bankës Botërore;
- (b) standardet e shëndetit dhe sigurisë të parapara me Standardet e Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale të IFC-së;
- (c) Standardet e shëndetit dhe sigurisë të parapara me Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it; si dhe
- (d) Ligjet e Kosovës që parashohin sigurinë dhe shëndetin në punë,

Përveç përveç deri në masën që dispozitat e parapara në dy apo më shumë dokumente të lartpërmendura janë të tilla që GenCo nuk mundet që njëkohësisht të zbatojë dispozitat e tilla, në këtë rast renditja e standardeve të lartpërmendura do të jetë rendi i prioritetit, si dhe dispozitat relevante të standardit të renditur më poshtë (apo standardeve, sipas nevojës) nuk vlen për atë masë sa t'i mundësohet GenCo-s që të jetë në përputhje me standardin e renditur më lart. Për shmangie të dyshimeve, asnjë dispozitë në këtë marrëveshje nuk e heq detyrimin e Palës që të respektojë standardin më strikt nga standardet e lartpërmendura.

“Rregullat IBA” – Rregullat e IBA-s për Mbledhjen e Provave për Arbitrazh Ndërkombëtar (2010), të ndryshuara apo plotësuara sipas rastit kohë pas kohe.

“Rregullat ICC” – kanë kuptimin e dhënë në Nenin 19.5(c).

“KPMM” - Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Kosovë.

“ICSID” – Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve Investuese.

“Konventa ICSID” – ka kuptimin e dhënë në Nenin 19.5(a).

“Rregullat ICSID” – kanë kuptimin e dhënë në Nenin 19.5(a).

“Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH-it” – Standardet e IFC-së për Performancën në Qëndrueshmëri Mjedisore dhe Sociale, publikuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në dispozicion në Datën e Ekzekutimit (me rivendosje të mundshme të ardhme) tek http://www1.ifc.org/wps/wcm/connect/c8f524004a73daeca09afdf998895a12/IFC_Performance_Standard_s.pdf?MOD=AJPERES apo ndonjë version i mëvonshëm që duhen zbatuar nga cilido Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit.

“Marrëveshja e Zbatimit” - Marrëveshja me po këtë emër ndërmjet GenCo dhe QK me datë në apo afër datës së ekzekutimit e që ka të bëjë me Projektin Kosova e Re.

“Njohja e Zhdëmtimit” – ka kuptimin e dhënë në Nenin 15.4.1(c).

“Njoftimi i Zhdëmtimit” – ka kuptimin e dhënë në Nenin 15.4.1(a).

“Shporta e Zhdëmtimit” – do të thotë (i) në lidhje me GenCo-n apo Palët e GenCo-s, apo Kompania Holding Sponsore apo Palët e Kompanisë Holding Sponsore, si dhe Sponsorin Ultimativ apo Palët e Sponsorit Ultimativ, shuma e Humbjeve e barabartë me €250,000 si shumë e përbërë që vlen për të gjitha palët e tilla në lidhje me të gjitha Marrëveshjet e Projektit; si dhe (ii) në lidhje me QEK-në apo Palët e QEK-së, si dhe NKEC-në apo Palët e NKEC-së, si dhe Gjenerimin e KEK-ut apo Palët e Gjenerimit të KEK-ut, si dhe Mihjen e KEK-ut apo Palët e Mihjes së KEK-ut, si dhe Furnizuesin e Ujit apo Palët e Furnizuesit të Ujit si dhe NP-ët e Specifikuara apo Palët e afërta me to, shuma e Humbjeve e barabartë me €250,000 si shumë e përbërë që vlen për gjitha ato palë në lidhje me të gjitha Marrëveshjet e Projektit.

“Konsulent i Pavarur E&S” - konsulenti mjedisor dhe social i angazhuar në përputhje me nenin 3.10 të Marrëveshjes së Zbatimit dhe me detyrat e përcaktuara në nenin 4.3 të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë Elektrike.

“KEK Prodhimi” – Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, më zyrë kryesore në rr. Nëna Terezë nr. 36, Prishtinë, Kosovë, dhe me numër të regjistrimit të biznesit nr. 70325399, që operon përmes njësisë së saj të biznesit që është përgjegjës për kapacitetin e prodhimit.

“Gjenerimi i KEK-ut” – ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Rasti i Dështimit të Mihjes së KEK-ut” – ka kuptimin e dhënë në Nenin 17.2.

“Toka e KEK Mihjes” - Çdo pasuri e patundshme në pronësi të KEK Mihjes që është afër ose ngjitur me lokacionin e përzgjedhur sipas nenit 3.1, të cilat do të përshkruhen dhe cekën nga Palët në Skemën 3 të kësaj Marrëveshjeje në mënyrë të arsyeshme menjëherë pas përfundimit të procesit të Përzgjedhjes së Lokacionit .

“Palë e Mihjes së KEK-ut” – aksionar, drejtor, zyrtar, punëtor, Kontraktor, përfaqësues, agjent, anëtar, menaxher apo Degë (I Afërt) e Mihjes së KEK-ut.

“Riorganizimi apo privatizimi i Mihjes KEK” – cilado prej:

- (a) Riorganizimi i Mihjes së KEK-ut, ashtu që operacionet gjeneruese nga Mihja e KEK-ut i barten një Ndërmarrjeje të ndarë Publike;
- (b) Transferimi i aksioneve të Mihjes së KEK-ut nga QEK tek një Person që nuk është Autoritet Publik, ashtu që Mihja e KEK-ut nuk kualifikohet më si Ndërmarrje Publike, ose shitja nga Mihja e KEK-ut i të gjitha apo thelbësisht të gjitha asetëve të Mihjes së KEK-ut tek Pasardhësi i Licencuar i Mihjes së KEK-ut, ose ngjarja e një transaksioni të ngjashëm që rezulton me gjendjen ku Pasardhësi i Licencuar i Mihjes së KEK-ut merr përsipër detyrimin e Mihjes së KEK-ut për të furnizuar linjitin në Kosovë; ose
- (c) Ngjarja e ndryshimit të ligjeve në Kosovë që ka për efekt lirim të Mihjes së KEK-ut nga detyrimi për të furnizuar linjitin në Kosovë, si dhe caktimi i atij detyrimi tek një Pasardhës i Licencuar i Mihjes së KEK-ut.

“KESCO” – Kompania e Furnizimit të Energjisë Elektrike të Kosovës sh.a., shoqëri aksionare e organizuar në kuadër të ligjeve të Kosovës, me zyrë kryesore në Bulevardin Bill Clinton nr. 3, Prishtinë, Kosovë, dhe me numër të regjistrimit të biznesit nr. 70606119.

“Kosovë” – Republika e Kosovës.

“Impianti Kosova A” – termocentrali ekzistues me rreth 370 MW gjenerim elektrik (neto) me linjit, me tre apo më shumë blloqe, që gjendet në Obiliq, Kosovë, përgjithësisht njohur si “Kosova A”.

“Impianti Kosova B” – termocentrali ekzistues me rreth 530 MW gjenerim elektrik (neto) me linjit, që gjendet në Obiliq, Kosovë, përgjithësisht njohur si “Kosova B.”

“Projekti Kosova e Re” - Ka kuptimin e cekur më lartë.

“KOSTT” – “OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU – KOSTT” SH.A., shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrë kryesore në rr. Isa Boletini nr. 39, 1000 Prishtinë, Kosovë, dhe me numër të regjistrimit të biznesit nr. 70325350, apo pasardhësit në rast se KOSTT ndërpret funksionin e TSMO në kuadër të Kodit të Rrjetit. Termat “TSMO” dhe “Kodi i Rrjetit” kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

“Struktura e TCKR” - Objekti i termocentralit të prodhimit të energjisë me djegie të linjitet që do të vendoset në Obiliq, Kosovë, siç përshkruhet më në hollësi në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë Elektrike.

“Skadimi i Pëlqimit” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Implementimit.

“Ligjet e Kosovës” - Ligjet e Kosovës, si dhe të gjitha statutet, traktatet, kodet, urdhëresat, urdhrat, rregullat, rregulloret, urdhrat ekzekutivë, vendimet gjyqësore, njoftimet, vendimet, rregulloret dhe aktet nënligjore apo direktivat e tjera të ngjashme të lëshuara nga cildo Autoritet Publik, në çdo rast, që është janë të aplikueshme për Palët, Projektin Kosova e Re, ose në lidhje me Marrëveshjen e Projektit, një Dokument Financiar ose një Kontrate Ndërtimi/Mirëmbajtje, përfshirë ndryshimet e plotësimet, zëvendësimet, riinterpretimet apo modifiket e tyre nga Autoritetet Publike të Kosovës, herë pas here.

“Kredidhënës” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

“Pasardhësi i Licencuar i Mihjes së KEK-ut” – Person që licencohet sipas ligjeve të Kosovës për të ushtruar funksionet e mihjes së linjitet në sektorin minerar të Kosovës.

“Marrëveshja për furnizimin me linjit” Marrëveshja me këtë emër ndërmjet KEK Mihjes dhe GenCo me datë në ose afër datës së ekzekutimit.

“Humbje” – çdo humbje, dëmtim, përgjegjësi, pagesë apo obligim (duke përjashtuar humbjet, dëmtimet, përgjegjësinë, pagesën apo obligimet indirekte apo pasuese, , përveç në rast se kjo lind nga ndonjë neglizhencë e rëndë ose kundërvajtje e qëllimshme e Palës zhdëmtuese) si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet (përfshirë tarifat ligjore të arsyeshme) në lidhje me to.

“Marrëveshja LTM” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Kontraktori LTM” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

“Rregullat e tregut” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Efekt Material GenCo” – efekt material dhe negativ mbi:

- (a) GenCo-n apo zotësinë e saj për të përmbushur detyrimet apo ushtruar të drejtat apo për të realizuar beneficionet e plota (ekonomike apo të tjera) sipas Marrëveshjeve të Projektit, Kontratës së Ndërtimit/Mirëmbajtjes, apo Dokumentit të Financimit;
- (b) Zhvillimin, projektimin, ndërtimin, financimin, përdorimin, operimin, mirëmbajtjen, apo performancën e Stabilimentit TCKR;
- (c) Interesat e Kompanisë Holding Sponsore apo Sponsorit Ultimativ, ose kthimin e apo mbi investimet e tyre në lidhje me pjesëmarrjen e GenCo-s në Projektin Kosova e Re;
- (d) Zotësinë e cilësdo palë homologe në Marrëveshje të Projektit, Kontratë të Ndërtimit/Mirëmbajtjes, apo Dokument të Financimit për të përmbushur detyrimet e saj sipas tyre.

“Memorandumi i Mirëkuptimit” - memorandum i mirëkuptimit ndërmjet QEK-së dhe Sponsorit Ultimativ, të datës 18 dhjetor 2015.

“Politika e MIGA-s për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale” – Politika për Qëndrueshmëri Mjedisore dhe Sociale, publikuar nga Agjencia Shumëpalëshe për Garanci Investimi, në dispozicion në Datën e Ekzekutimit (me rivendosje të mundshme të ardhme) tek http://www.miga.org/documents/environ_social_review_021507.pdf apo ndonjë version i mëvonshëm që duhen zbatuar nga cilido Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit.

“Muaj” – muaj kalendarik sipas Kalendarit Gregorian.

“MW” – njësi e kapacitetit të gjenerimit elektrik e barabartë me 1 megavat elektrike apo 1,000,000 vatë elektrike.

“NKEC” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Kontrata O&M” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Kontraktori OeM” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

“Rast tjetër i Forcës Madhore” – ka kuptimin e dhënë në Nenin 18.1.2(d).

“Pala” dhe “Palët” – kanë kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Kushti i kalimit mjedisor/arkeologjik” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Kontest i pagesës” - Kontest që lidhet me ndonjë detyrim të pagesës aktuale ose të kushtëzuar (përveç atyre që lindin drejtpërdrejt nga ndërprerja e kësaj Marrëveshjeje) që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Marrëveshje, që në çdo rast është lloji i çështjes që është në masë të arsyeshme i nënshtrimit dhe zgjidhjes nga një ekspert me përvojë përkatëse.

“Personi” - Çdo individ, korporatë, ortakëri, sipërmarrje e përbashkët, shoqatë, trust biznesi, organizatë e pakorporatizuar, autoritet publik, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose subjekt tjetër.

“Lokacioni i Impiantit” - ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Lokacionit.

“Rast i Forcës Madhore Politike” – ka kuptimin e dhënë në Nenin 18.1.2(a).

“Marrëveshja për Blerjen e Energjisë” – Marrëveshja me këtë emër ndërmjet NKEC-së dhe GenCo-s, e datës apo përreth Datës së Ekzekutimit.

“Marrëveshjet e projektiti” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

“VNMS Preliminar (OEK)” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

“Praktikat e Kujdesshme Minerare” – ato praktika, metoda e procedura që janë në përputhje me kriteret e sigurisë dhe ato ligjore, të cilat realizohen me zbatimin e një shkalle të aftësisë, vigjilencës, kujdesit dhe parashikimit nga një kompani minerare e aftë dhe me përvojë apo që angazhohet në të njëjtin apo lloj të ngjashëm të sipërmarrjes apo aktivitetit me të njëjtat apo rrethana e kushte të ngjashme me ato që zotërojnë në Kosovë, si dhe që përmbushin standardet e shëndetit, sigurisë dhe ato mjedisore të kompanive ndërkombëtare shërbyese me reputacion të lartë. Praktikat e Kujdesshme Minerare nuk kufizohen në praktika optimale, metoda apo akte në përjashtim të të tjerave, por janë një spektër i praktikave, metodave e akteve të mundshme që mund të priten të arrijnë rezultatin e dëshiruar me kosto të arsyeshme, në përputhje me besueshmërinë dhe sigurinë.

“Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjes” - Ato praktika, metoda e procedura që janë në përputhje me kriteret e sigurisë dhe ato ligjore, të cilat realizohen me zbatimin e një shkalle të aftësisë, vigjilencës, kujdesit dhe parashikimit nga një gjenerator i aftë dhe me përvojë i energjisë elektrike apo që angazhohet në të njëjtin apo lloj të ngjashëm të sipërmarrjes apo aktivitetit me të njëjtat apo rrethana e kushte të ngjashme me ato që zotërojnë në Kosovë, si dhe që përmbushin standardet e shëndetit, sigurisë dhe ato mjedisore të kompanive ndërkombëtare shërbyese me reputacion të lartë. Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjes nuk kufizohen në praktika optimale, metoda apo akte në përjashtim të të tjerave, por janë një spektër i praktikave, metodave e akteve të mundshme që mund të priten të arrijnë rezultatin e dëshiruar me kosto të arsyeshme, në përputhje me besueshmërinë dhe sigurinë.

“Autoriteti Publik” – secili prej këtyre në vijim me juridiksion mbi GenCo-n, KEK Mihjet, Projektin Kosova e Re, apo ndonjë pjesë të tyre:

- (a) QK, çdo nëndivizion i saj, apo çdo autoritet i pushtetit lokal;
- (b) çdo departament, autoritet, instrument, agjenci ose organ gjyqësor i ndonjë Autoriteti Publik të përshkruar në (a) më lart;
- (c) gjykatat dhe tribunalet në Kosovë;
- (d) Secila agjenci e pavarur rregullative me juridiksion mbi GenCo-n, Mihjen e KEK-ut, Projektin Kosova e Re, apo ndonjë pjesë të tyre;
- (e) çdo autoritet shtetëror, i qytetit, krahinës, komunës, nivelit lokal apo rajonal, departament, organ, byro, instrument, komision, korporatë, degë, drejtori, agjenci, ministri, gjykatë, tribunal, autoritet gjyqësor, organ legjislativ, organ administrativ, organ rregullativ, subjekt autonom apo kuazi-autonom ose autoritet tatimor ose ndonjë departament, komunë ose nëndivizion tjetër politik, duke përfshirë, mes tjerash, çdo Person (qoftë autonom apo jo) që ushtron funksione ekzekutive, legjislative, gjyqësore, rregullative ose administrative ose që kanë të bëjnë me ndonjërin prej subjekteve të lartpërmendura.

“ndërmarrje publike”, ndërmarrja publike e përkufizuar sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike, 2008, ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrje Publike (nr. 05/L-009).

“Rast i Forcës Madhore lidhur me Ujin Brut” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë.

“Standardet e Zhvendosjes” – Bashkërisht, në lidhje me pjesëmarrjen në Projektin Kosova e Re, vetëm e vetëm deri në masën që vlen për Projektin Kosova e Re:

- (a) Standardet e zhvendosjes të parapara me Politikat Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore;
- (b) Standardet e zhvendosjes të parapara me Standardet e Qëndrueshmërisë Mjedisore të IFC-së;
- (c) Standardet e zhvendosjes të parapara me Standardet e Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale të MIGA-s;
- (d) Standardet e zhvendosjes të parapara me Politikat Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it; dhe
- (e) Kërkesat e vendosura me ligjet e Kosovës të lidhura me zhvendosjen e pavullnetshme,

Përveç deri në masën që dispozitat e parapara në dy apo më shumë dokumente të lartpërmendura janë të tilla që Personi nuk mundet që njëkohësisht të respektojë dispozitat e tilla, e në këtë rast renditja e standardeve të lartpërmendura do të jetë rendi i prioritetit, si dhe dispozitat relevante të standardit përkatës të renditur më poshtë (apo standardeve, sipas nevojës) nuk vlen për atë masë sa t'i mundësohet atij Personi që të jetë në përputhje me standardin e rendit më të lartë. Për shmangie të dyshimeve, asnjë dispozitë në këtë marrëveshje nuk e heq detyrimin e Palës që të respektojë standardin më strikt nga standardet e lartpërmendura.

“Përzgjedhja e lokacionit” - Ka kuptimin e cekur në nenin 3.1.1.

“Fusha e minierës së Sibovcit Jugor” - ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Furnizimin e Ujit.

“Lokacioni” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“Marrëveshja për transferimin e lokacionit” Marrëveshja me këtë emër ndërmjet KEK Prodhimit dhe GenCo me datë në ose afër datës së ekzekutimit.

“Standardet Sociale” – Bashkërisht, në lidhje me pjesëmarrjen e GenCo-s në Projektin Kosova e Re, vetëm e vetëm deri në masën që vlen për GenCo-n apo Projektin Kosova e Re,

- (a) Komponentët socialë të Planit të Menaxhimit MS;
- (b) Standardet sociale të parapara me Politikat Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore;
- (c) Standardet sociale të parapara me Standardet e Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale të IFC-së;
- (d) Standardet sociale të parapara me Standardet e Qëndrueshmërisë Mjedisore dhe Sociale të MIGA-s;
- (e) Standardet sociale të parapara me Politikat Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it; dhe
- (f) Kërkesat e vendosura me ligjet e Kosovës të lidhura me masat mbrojtëse sociale dhe qëndrueshmërinë,

Përveç përveç deri në masën që dispozitat e parapara në dy apo më shumë dokumente të lartpërmendura janë të tilla që GenCo nuk mundet që njëkohësisht të zbatojë dispozitat e tilla, në këtë rast renditja e standardeve të lartpërmendura do të jetë rendi i prioritetit, si dhe dispozitat relevante të standardit përkaës të renditur më poshtë (apo standardeve, sipas nevojës) nuk vlen për atë masë sa t'i mundësohet GenCo-s që të jetë në përputhje me standardin e renditur më lart. Për shmangie të dyshimeve, asnjë dispozitë në këtë marrëveshje nuk e heq detyrimin e Palës që të respektojë standardin më strikt nga standardet e lartpërmendura.

“Njoftimi i Posaçëm i Kundërvajtjes së QEK-së” – ka kuptimin e dhënë në Nenin 17.3.

“Kontrata specifike e kushtit të rikultivimit mjedisor” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë.

“NP e specifikuar” dhe “NP të specifikuara” Të gjitha minierat e KEK-ut, KEK Prodhimit, NKEC, KOSTT, Furnizuesi i Ujit dhe çdo Ndërmarrje tjetër Publike që është palë në Marrëveshjen e Projektit, sipas kontekstit. Pavarësisht të gjithave që dëshmojnë të kundërtën, çdo Person që nuk është Ndërmarrje Publike, që është pasardhës i interesave të një NP të Specifikuar sipas Marrëveshjes së Projektit, do të konsiderohet si NP e Specifikuar.

“Veprimi apo mosveprimi i NP-së së Specifikuar” – veprimi apo mosveprimi i ndonjë NP-je të Specifikuar, përveç Ndryshimit të Ligjit, veprim apo mosveprim ky që përbën shkelje apo kundërvajtje materialetë detyrimeve të NP-së së Specifikuar sipas ndonjërisë prej marrëveshjeve të Projektit në të cilat NP-ja e Specifikuar është palë apo përbën shkelje të Ligjeve të Kosovës si dhe veprim apo mosveprim i asaj NP-je të Specifikuar që ka Efekt Material mbi GenCo-n; megjithatë me kusht që, veprimi apo mosveprimi i tillë të mos konsiderohet Veprim apo Mosveprim i NP-së së Specifikuar nëse veprimi apo mosveprimi i tillë shkaktohet, tërësisht apo në masë të madhe, nga Veprimi apo Mosveprimi i GenCo-s.

“Kompania Holding Sponsore” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit.

“Pala Holding Sponsore” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit.

“Marrëveshja për Mbështetjen e sponsorit” – Marrëveshja me këtë emër ndërmjet QEK-së, Kompania Holding Sponsore, si dhe GenCo-s, e datës apo përreth Datës së Ekzekutimit.

“Tatim” – çdo tatim, ngarkesë, taksë, tarifë, detyrim, bazë e vlerësimit të tatimeve (duke përfshirë normat dhe periudhat e amortizimit të asetëve për qëllime të vlerësimit tatimor), koncesion apo pagesë fiskale, duke përfshirë tatimin në të ardhura të korporatës, tatimi në vlerë të shtuar, tatim në shitje, tatimi i ujit apo mjedisor apo energjetik, detyrimet e importit apo doganore, tatimi në burim, akciza, tatimi mbi transaksione të këmbimit të valutave të huaja, apo tatimi në pronë. Termi “Tatim” nuk përfshin tarifatat apo ngarkesat që i paguhen Autoritetit Publik në këmbim të mallrave apo shërbimeve që ofrohen nga ai Autoritet Publik në lidhje me aktivitetin komercial që ushtrohet nga ai Autoritet Publik.

“Mosmarrëveshje Teknike” do të thotë Mosmarrëveshje që ndërlidhet me ndonjë çështje apo lëndë teknike, inxhinierike, operative apo të kontabilitetit brenda kësaj Kontrate që, në çdo rast, është lloj i çështjes apo lëndës që me arsye i nënshtrohet trajtimit dhe zgjidhjes nga një ekspert.

“Afati” - Ka kuptimin e cekur në nenin 2.1.

“Njoftimi i Shkëputjes” – ka kuptimin e dhënë në Nenin 17.4.

“Data e transferimit” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Transferimit të Lokacionit.

“Sponsori Ultimativ” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit.

“Pala e Sponsorit Përfundimtar” – ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit.

“Korridori i Largimit të Ujit” - Toka në të cilën çdo pjesë e Sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit përdoret për të riqarkulluar ujin nga deponia Ekskluzive e Hirit të GenCo dhe nga Deponia Ekskluzive e Gipsit të GenCo në lumin e afërt Sitnica (ose në një tjetër rrjedhë ujore në afërsi, e pranueshme nga GenCo në lidhje me Përzgjedhjen e Lokacionit) është ose do të instalohet, siç përcaktohet më tej në Marrëveshjen e Transferimit të Lokacionit, por vetëm në masën e lejuar sipas pëlqimeve të GenCo dhe Standardeve Mjedisore.

“Furnizuesi i ujit” – HPE Ibër-Lepenc sh.a. shoqëri aksionare e organizuar në kuadër të ligjeve të Kosovës, me zyrë kryesore në Bulevardin Bill Clinton nr. 13, Prishtinë, Kosovë, dhe me numër të regjistrimit të biznesit nr. 70465157.

“Pala e furnizimit me ujë” – aksionar, drejtor, zyrtar, punëtor, Kontraktor, përfaqësues, agjent, anëtar, menaxher apo Degë (I Afërt) e Furnizuesit me Ujë.

“Banka Botërore” dhe “Grupi i Bankës Botërore” - kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

“Politikat e Masave Mbrojtëse Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore” – Politikat e Masave Mbrojtëse Mjedisore dhe Sociale, publikuar nga Banka Botërore, në dispozicion në Datën e Ekzekutimit (me rivendosje të mundshme të ardhme) tek <http://go.worldbank.org/WTA1ODE7T0> apo ndonjë version i mëvonshëm që duhen zbatuar nga cilido Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit.

“Udhëzimet MSHS të Grupit të Bankës Botërore” – Udhëzimet Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë të Grupit të Bankës Botërore, në dispozicion në Datën e Ekzekutimit (me rivendosje të mundshme të ardhme) tek <http://www.ifc.org/ehsguidelines/> apo ndonjë version i mëvonshëm që duhen zbatuar nga cilido Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit, duke përfshirë pjesët e zbatueshme të: (i) Udhëzimet Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë për Termocentrale (2008), mihje (2007) si dhe Stabilimente të Menaxhimit të Mbeturinave (2007), si dhe (ii) Neni 2.0 i Udhëzimeve Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë (MSHS): Shëndeti dhe Siguria në Punë (30 prill 2007).

“Udhëzimet MSHS të Grupit të Bankës Botërore për Impiantet e Menaxhimit të Mbeturinave” – Udhëzimet Mjedisore, Shëndetësore dhe të Sigurisë të Grupit të Bankës Botërore për Impiantet e Menaxhimit të Mbeturinave, në dispozicion në Datën e Ekzekutimit (me rivendosje të mundshme të ardhme) tek <http://www.ifc.org/wps/wcm/connect/1cd72a00488557cfbdf4ff6a6515bb18/Final+-+Waste+Management+Facilities.pdf?MOD=AJPERES> apo ndonjë version i mëvonshëm që duhen zbatuar nga cilido Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit:

“Viti” – Çdo periudhë dymbëdhjetë (12) mujore që fillon më 1 janar dhe vazhdon deri në fund të atij viti kalendarik.

1.2. Interpretimi

(a) Në këtë Marrëveshje, përveç nëse paraqitet synimi që është qartas i kundërt:

- (i) njëjësi përfshin shumësin, dhe anasjelltas;
- (ii) kalkulimet përveç çmimeve që duhet bërë në këtë kuadër do të shprehen në katër pikë decimale;
- (iii) referencat në një Person përfshijnë pasardhësit e lejuar të atij Personi dhe të deleguarit por, nëse aplikohet, vetëm nëse këta pasardhës dhe të deleguar nuk janë të ndaluar me këtë Marrëveshje, dhe referencat në një Person në një cilësi të posaçme përjashton atë Person në një cilësi tjetër apo individualisht.
- (iv) referencat në një gjini përfshin edhe gjininë tjetër;
- (v) Referimi ndaj ndonjë marrëveshjeje, dokumenti apo instrumenti nënkupton atë marrëveshjeje, dokument apo instrument të ndryshuar apo modifikuar kohë pas kohe, si dhe vënë në fuqi, në pajtim me kushtet e tij/saj; me kusht, megjithatë, që referimi ndaj standardeve të zbatueshme (përveç Ligjeve të Kosovës) të nënkuptojë që Standardet e Zbatueshme (përveç ligjeve të Kosovës) në fuqi në Datën e Ekzekutimit, si dhe pas ekzekutimit të Dokumenteve të Financimit, versionet e Standardeve të Zbatueshme (përveç Ligjeve të Kosovës) që kërkohen të përmbushen nga cilido Huadhënës sipas Dokumenteve Financiare;
- (vi) Referencat ndaj akteve ligjore apo dispozitave ligjore përfshijnë referencat ndaj të gjitha modifikimeve statutoare apo rivendosjes së atyre akteve apo dispozitave ligjore, si dhe çdo akt apo dispozitë ligjore të zëvendësuar me atë akt apo dispozitë ligjore, me kusht që

formulimi në këtë paragraf 1.2(a)(vi) të mos pengojë Palën nga kërkimi i zgjidhjeve me Ndryshim të Ligjit, siç parashihet me ndonjë Marrëveshje të Projektit;

- (vii) “këtu”, “nga kjo”, “në këtë” dhe fjalë të ngjashme do të konsiderohen si referenca në këtë Marrëveshje si tërësi dhe jo në ndonjë nen të veçantë, Shtojcë ose dispozitë tjetër, përveç nëse është cekur ndryshe në mënyrë specifike;
 - (viii) “duke përfshirë” (dhe me kuptimin reciprok “përfshin” ose “përfshihen”) do të thotë përfshirja pa kufizuar përgjithësinë e ndonjë përshkrimi që i paraprin shprehjes së tillë;
 - (ix) letër, dokument, ose instrument tjetër që përcakton se QK “nuk ka kundërshtim” (ose “nuk kundërshton” ose fjalë të tjera të ngjashme) në lidhje me një çështje të veçantë do të konsiderohen si pëlqim i QK në lidhje me atë çështje;
 - (x) në lidhje me përcaktimin e çdo periudhe kohore, “nga” do të thotë “nga dhe duke përfshirë” dhe “deri” do të thotë “deri por duke përjashtuar”;
 - (xi) referencat në dokumente, instrumente apo marrëveshje konsiderohen të jenë referenca edhe në të gjitha shtojcat, shtesat, dhe ndryshimet e tyre, dhe
 - (xii) referencat në njërën Palë për ta informuar apo për ta vënë në dijeni lidhur me një ngjarje a rrethanë do të konsiderohet t’i referohet stafit të asaj Pale që ka përgjegjësi për çështjet që kanë të bëjnë me atë ngjarje apo rrethanë, apo çdo drejtor apo zyrtar të tashëm apo të mëparshëm, i cili informohet apo vihet në dijeni.
- (b) Emërtimet dhe titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për referencë dhe nuk përbëjnë pjesë të substancës së kësaj Marrëveshje dhe nuk do të konsiderohen në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.
 - (c) Referencat brenda kësaj Marrëveshjeje në nenet, kapitujt dhe Shtojcat (dhe Shtesat e tyre) janë në nenet dhe kapitujt dhe Shtojcat (dhe Shtesat e tyre) të kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse nuk është cekur ndryshe. Referencat në kuadër të Shtojcave në nenet, kapituj dhe anekset janë referenca në nene, kapituj dhe anekse të asaj Shtojce, përveç nëse nuk ceket ndryshe. Referencat në Shtojca (apo anekse në to) në nenet dhe kapitujt e marrëveshjes janë referenca në këtë Marrëveshje, përveç nëse nuk ceket ndryshe.
 - (d) Në kryerjen e obligimeve dhe detyrimeve të tyre, dhe në përcaktimin e vlerësimeve në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, secila Palë do të ketë një detyrim të nënkuptuar në mirëbesim.
 - (e) Përveç nëse nuk ceket ndryshe në këtë Marrëveshje, referencat në kohë janë referenca në kohën standarde të Evropës Qendrore ose kohën verore të Evropës Qendrore, sipas aplikimit të atëhershëm në Lokacion.
 - (f) Kjo Marrëveshje është negociuar nga Palët me shërbimet e përfaqësimit ligjore, si dhe vijimisht, çdo rregull i ndërtimit apo interpretimit që ndryshe detyron që kjo Marrëveshje të trajtohet apo të interpretohet kundër ndonjërisë Palë si palë hartuese nuk vlen për asnjë trajtim apo interpretim të saj.
 - (g) Në masën që ekziston një konflikt ndërmjet çdo dispozite të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo Shtojce ose Aneksi, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojnë, por mungesa e një dispozite në një Shtojcë ose Aneks ose në këtë Marrëveshje (sipas rastit) nuk do të përbëjë konflikt.

Article 2 **Data e ekzekutimit; afati**

2.1. Data e hyrjes në fuqi; afati

Kjo Marrëveshje fillon dhe hyn në fuqi (efekt) në datën e mëvonshme mes (a) Datës së Ekzekutimit dhe (b) datën në të cilën hyn në fuqi Marrëveshja për Blerjen e Energjisë në pajtim me Seksionin (*Efektshmëria; Kohëzgjatja*) të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë (ku data e hyrjes në fuqi është “**Data Efektive**”), si dhe, përveç nëse nuk shkëputet ndryshe, ndërpritet në njërin nga rastet në vijim, cilido që të ndodhë më herët.

- (a) gjashtë (6) Muaj pas skadimit ose ndërprerjes së Licencës së Gjenerimit, cilado të ndodhë më vonë, dhe çdo licence ekuivalente ose zëvendësuese, pëlqimi ose dhënie tjetër të kërkuar të të drejtave, rezultati i të cilave është që GenCo-së nuk i lejohet më ta operojë Impiantin e TCKR-së; dhe
- (b) gjashtë (6) muaj pas njoftimit nga GenCo tek KEK Mihja që, në fund të një periudhe të tillë, GenCo nuk do të kërkojë më të drejtë për të:
 - (i) larguar Hirin në deponinë Ekskluzive e Hirit të GenCo; dhe
 - (ii) larguar Gipsin në deponinë Ekskluzive e Gipsit të GenCo.

(periudha e tillë, “**Afati**”).

Article 3 **Përditësimi i Planit të Rikultivimit të Fushës së Minierave B&M/Sibovcit Jugor dhe Finalizimi i Lokacionit**

3.1. Përzgjedhja e Lokacionit dhe Finalizimi i Përzgjedhjes së Lokacionit

3.1.1 Përzgjedhja e lokacionit

KEK Mihja, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e hyrjes në fuqi, do të përzgjedh lokacionin(et) për deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo nga një prej opsioneve në vijim (“**Përzgjedhja e lokacionit**”):

- (a) Minierat B&M.
- (b) Fusha e Minierës Sibovci Jugor; apo
- (c) prona tjetër e KEK Mihjes; me kusht që, sidoqoftë, prona e tillë të jetë në afërsi të Impiantit TCKR të krahasueshme me atë të Minierave B&M ose Fushës së Minierës së Sibovcit Jugor dhe me kusht që, gjithashtu, KEK Mihja do të ketë në pronësi pronën e patundshme që rrethon Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo;

me kusht, megjithatë,

- (d) në secilin rast të tillë Përzgjedhja e lokacionit do të:
 - (i) sigurojnë hapësirë të mjaftueshme për Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo për të siguruar të paktën njëzet e një (21) vite funksionim, plus një hapësirë shtesë të barabartë në sasi me zonën e parashikuar shumëzuar me njëzet për qind (20%) të shmës totale të parashikuar të hapësirës që kërkohet nga GenCo për largimin e Hirit dhe Gipsit gjatë një periudhe 21-vjeçare të tillë për Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo;
 - (ii) sigurojë Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo që të vendoset në mënyrë të arsyeshme larg pronës së përdorur nga çdo përdorues

- tjetër aktiv i zonave përreth, në mënyrë që të shmanget ndotja e përdoruesve të tjerë apo nga ta;
- (iii) caktojë qartas një hapësirë ekskluzive për largimin e hirit dhe gipsit nga Impianti TCKR, ndaras dhe veçuar nga çdo largim i Hirit dhe Gipsit nga çdo impiant tjetër gjenerues;
 - (iv) varësisht nga neni 17.2, duhet të kryhet në përputhje me:
 - (A) Standardet e aplikueshme; dhe
 - (B) Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Impiantet e Menaxhimit të Mbeturinave; dhe
 - (v) nuk ndërhyt në aftësinë e GenCo për të përmbushur standardet e aplikueshme, ose ndryshe të krijojë efekt material të GenCo; dhe
- (e) KEK Mihja do ta mbajë të informuar GenCo mbi hulumtimet dhe diskutimet e saj në lidhje me çdo Përzgjedhje të Lokacionit, dhe do të lejojë GenCo të japë komente dhe të marrë pjesë në diskutimet në lidhje me Përzgjedhjen e Lokacionit.

3.1.2 Finalizimi i Përzgjedhjes së Lokacionit

Brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i përzgjedhjes së propozuar, GenCo do të miratojë përzgjedhjen e tillë ose do të japë komente me shkrim për KEK Mihjet për përzgjedhjen e tillë. Pas kësaj, palët do të negociojnë në mirëbesim me qëllim të përzgjedhin Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga data e hyrjes në fuqi.

3.2. Detyrimi për përditësimin e Planit të Rikultivimit

Në rast se KEK Mihjet zgjedhin dhe GenCo miratojnë Minierat B&M ose Fushën e Minierës së Sibovcit Jugor si lokacionin për Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, KEK Mihja, brenda tridhjetë (30) ditëve nga përzgjedhja e tillë, do t'i propozojë GenCo një përditësim të Planit të Rikultivimit të Fushës së Minierës B&M/Minierës së Sibovcit Jugor në përputhje me praktikën e matura të minierave, Ligjet e Kosovës dhe këtë Marrëveshje në mënyrë që Plani i Rikultimit të Minierës B&M/Minierës së Sibovcit Jugor të jetë në përputhje me kërkesat e Projektit Kosova e Re. Për çfarëdo që gjendet në planin e rikultivimit të fushës së minierës B&M /Sibovcit Jugor e që do të krijojë detyrim ose përgjegjësi për GenCo, GenCo do të ketë të drejtë ta rishikojë dhe miratojë planin e rikultimit të minierës B&M/fushës së minierës së Sibovcit Jugor.

3.3. Miratimi nga KPMM

- (a) Sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se dhjetë (10) Ditë Pune pasi Palët të kenë rënë dakord mbi Përzgjedhjen e lokacionit dhe planin e aplikueshëm për rikultivim, KEK Mihja do të dorëzojë përzgjedhjen e tillë të Lokacionit dhe planin e rikultimit tek KPMM për miratim.
- (b) Nëse KPMM miraton Përzgjedhjen e Lokacionit dhe çdo plan rikultimi ose KPMM në mënyrë të arsyeshme përcakton që KPMM nuk ka juridiksion dhe autoritet në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me Përzgjedhjen e Lokacionit dhe planin e rikultivimit, atëherë KEK Mihja do ta njoftojnë GenCo brenda pesë (5) ditëve pune nga pranimi i KEK Mihjes të miratimit ose përcaktimit të tillë dhe Përzgjedhja e Lokacionit do të jetë përfundimtare.
- (c) Nëse KPMM refuzon Përzgjedhjen e Lokacionit ose planin e rikultivimit, atëherë dispozitat e nenit 3.1.2 do të aplikohen përsëri sikur Përzgjedhja e Lokacionit nuk do të jetë përfunduar ende, duke filluar nga data në të cilën KPMM e lëshon refuzimin.

Article 4
Largimi i hirit, largimi i gipsit

4.1. Largimi i hirit

4.1.1 E drejta për ta ëarguar hirin

KEK Mihja i japin GenCo, nga data e transferimit dhe gjatë gjithë afatit, të drejtën ekskluzive për largimin e hirit në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo përmes Sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit, ose ndryshe, duke u nënshtruar kushteve të mëposhtme:

- (a) GenCo do të:
 - (i) dizajnojë dhe ndërtojë Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo në përputhje me Standardet e Aplikueshme, duke përfshirë në lidhje me kontrollet mjedisore si kontrolli i derdhjes, linjat, sistemi i grumbullimit të ujërave të zeza, monitorimi i ujërave nëntokësore dhe kontrollet e mbylljes;
 - (ii) largimi i hirit në pajtim me Praktikat Prudente të Ndërmarrjeve Publike, Ligjet e Kosovës, Planin e Rikultivimit të Minerës B&M /Minierës së Sibovcit Jugor (nëse aplikohet), dhe Standardet e Aplikueshme;
 - (iii) pa kufizuar sa më sipër, siguron që Hiri largohet në ndarje të veçanta me madhësi për të mbajtur afërsisht dy (2) vite sasi Hiri, ku secila ndarje do të jetë rreshtuar (duke përfshirë rreshtin gjeoteknik) dhe do të ketë sistemet e kullimit të ujit në përputhje me kërkesat e kësaj marrëveshje; dhe
 - (iv) në përputhje me të gjitha procedurat e lëshuara nga KEK Mihja sipas nenit 6.2; dhe
- (b) GenCo nuk do të dorëzojë, dhe KEK Mihja nuk do të kërkojë të pranojë, për t'u disponuar në deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo:
 - (i) çdo substancë tjetër përveç Hirit;
 - (ii) çdo substancë që nuk është në përputhje me ligjet e Kosovës ose standardet mjedisore; ose
 - (iii) çdo material i rrezikshëm i cili, nëse pranohet për largim, krijon një Gjendje Mjedisore/Arkeologjike (përjashtuar materialet gjurmë të natyrshme brenda linjtit të larguar në përputhje me Marrëveshjet e Projektit dhe Standardet Mjedisore, për qëllime të këtij neni 4.1.1, Materialet e Rrezikshme nuk përfshijnë Hirin e dorëzuar për largim në deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo në pajtim me ligjet e Kosovës dhe standardet mjedisore),

me kusht që asgjë në këtë nen 4.1.1 nuk kufizon detyrimet e KEK Mihjes sipas Marrëveshjes së Furnizimit me Linjit dhe nuk kufizon detyrimet e KEK Mihjes sipas nenit 15.1.1(d).

4.1.2 Të drejtat e inspektimit dhe refuzimit

- (a) KEK Mihja dhe Konsulenti i Pavarur E&S do të kenë të drejtën të inspektojnë ose analizojnë, ose të bëjnë që të inspektohen ose analizohen, Hiri i siguruar në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo në çdo kohë gjatë orëve normale të punës për të siguruar që GenCo largon Hirin në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo në përputhje me këtë nen 4.1 dhe se kryen detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje. KEK Mihja dhe Konsulenti i Pavarur E&S do të sigurojnë GenCo njoftimin paraprak me shkrim së paku dy (2) Ditë Punë përpara lidhur me këtë inspektim dhe analizë dhe GenCo do të ketë të drejtë të ketë një përfaqësues të GenCo që do të jetë dëshmitar i inspektimit ose analizës së tillë.

- (b) Përveç siç parashikohet në këtë Marrëveshje, duke përfshirë edhe për shmangien e dyshimit, Article 15, KEK Mihja nuk merr përsipër asnjë detyrim në lidhje me mbetjet e ndryshme të mundshme përveç të Hirit në deponinë Ekskluzive e Hirit të GenCo.

4.1.3 Transporti

- (a) GenCo do të jetë përgjegjës, në kosto dhe shpenzime të veta (duke qenë se pranohet se GenCo do të ketë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të tilla sipas Skemës 1 të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë), për transportimin e Hirit (përmes sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit, ose ndryshe) në deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe do ta bëjë këtë në përputhje me praktikatat e prudenciale të shërbimeve, ligjet e Kosovës dhe standardet mjedisore.
- (b) GenCo do të jetë përgjegjës për instalimin e teknologjisë së përshtatshme (duke përfshirë riqarkullimin dhe trajtimin e ujit) për të siguruar që uji trajtohet në mënyrë adekuate para shkarkimit në lumin Sitnicë, deri në atë masë që shkarkimi i tillë është në përputhje me standardet e aplikueshme.

4.2. Largimi i gipsit

4.2.1 E drejta për ta larguar hirin

KEK Mihja i jep GenCo, nga data e transferimit dhe gjatë gjithë afatit, të drejtën ekskluzive për largimin e gipsit në Deponinë Ekskluzive të Gipsit, duke u nënshtruar kushteve të mëposhtme:

- (a) GenCo do të:
- (i) dizajnojë dhe ndërtojë Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo në përputhje me Standardet e Aplikueshme, duke përfshirë në lidhje me kontrollat mjedisore si kontrolli i derdhjes, linjat, sistemi i grumbullimit të ujërave të zeza, monitorimi i ujërave nëntokësore dhe kontrollat e mbylljes;
 - (ii) largimi i gipsit në pajtim me Praktikatat Prudente të Ndërmarrjeve Publike, Ligjet e Kosovës, Planin e Rikultivimit të Minerës B&M /Minierës së Sibovcit Jugor (nëse aplikohet), dhe Standardet e Aplikueshme;
 - (iii) në përputhje me të gjitha procedurat e lëshuara nga KEK Mihja sipas nenit 6.2; dhe
- (b) GenCo nuk do të dorëzojë, dhe KEK Mihja nuk do të kërkohet të pranojë, për t'u disponuar në deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo:
- (i) çdo substancë tjetër përveç Gipsit;
 - (ii) çdo substancë që nuk është në përputhje me ligjet e Kosovës ose standardet mjedisore; ose
 - (iii) çdo material i rrezikshëm i cili, nëse pranohet për largim, krijon një Gjendje Mjedisore/Arkeologjike (përfshirë materialet gjurmë të natyrshme brenda linjës të larguar në përputhje me Marrëveshjet e Projektit dhe Standardet Mjedisore, për qëllime të këtij neni 4.2.1, Materialet e Rrezikshme nuk përfshijnë Gipsin e dorëzuar për largim në deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo në pajtim me ligjet e Kosovës dhe standardet mjedisore),

me kusht që asgjë në këtë nen 4.2.1 nuk kufizon detyrimet e KEK Mihjes sipas Marrëveshjes së Furnizimit me Linjit dhe nuk kufizon detyrimet e KEK Mihjes sipas nenit 15.1.1(d).

4.2.2 Të drejtat e inspektimit dhe refuzimit

- (a) KEK Mihja dhe Konsulenti i Pavarur E&S do të kenë të drejtën të inspektojnë ose analizojnë, ose të bëjnë që të inspektohen ose analizohen, Gipsi i siguruar në Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo në çdo kohë gjatë orëve normale të punës për të siguruar që GenCo deponon dhe largon

Gipsin në Deponinë Ekskluzive të Gipsin të GenCo në përputhje me këtë nen 4.2 dhe se kryen detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje. KEK Mihja apo Konsulenti i Pavarur E&S, siç është e aplikueshme, do ti sigurojnë GenCo njoftimin paraprak me shkrim së paku dy (2) Ditë Punë përpara lidhur me këtë inspektim dhe analizë dhe GenCo do të ketë të drejtë të ketë një përfaqësues të GenCo që do të jetë dëshmitar i inspektimit ose analizës së tillë.

- (b) Përveç siç parashikohet në këtë Marrëveshje, duke përfshirë edhe për shmangien e dyshimit, Article 15, KEK Mihja nuk merr përsipër asnjë detyrim në lidhje me mbetjet e ndryshme të mundshme përveç të Hirit në deponinë Ekskluzive e Gipsit të GenCo.

4.2.3 Transporti

GenCo do të jetë përgjegjës, në kosto dhe shpenzime të veta (duke qenë se pranohet se GenCo do të ketë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të tilla sipas Skemës 1 të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë), për transportimin e Gipsit (përmes sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit, ose ndryshe) në deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo dhe do ta bëjë këtë në përputhje me praktikën e prudenciale të shërbimeve, ligjet e Kosovës dhe standardet mjedisore.

4.3. Dhënia e të drejtave të nevojshme pronësore

- (a) Minierat e KEK-ut i japin GenCo të drejtë ekskluzive të kalimit në, mbi, përtej dhe brenda deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, për përdorim nga GenCo, Kontraktuesit e GenCo dhe çdo Person i autorizuar nga GenCo me të gjitha pajisjet dhe makineritë, siç mund të jetë e nevojshme në mënyrë të arsyeshme për t'i ushtruar të drejtat e saj dhe për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje. E drejta e tillë e kalimit do të jetë në fuqi që nga Data e Bartjes si dhe mbetet në fuqi gjatë tërë afatit. Përveç kësaj, KEK Mihjet do t'i ofrojë GenCo dhe do të ekzekutojë dhe skedojë, sipas nevojat, s të gjitha të drejtat tjera, kalimit, servitutit, licencat, të drejtat e shfrytëzimit, si dhe të drejtat tjera të pronës së paluajtshme që me arsye janë të domosdoshme për qëllimin e tillë. KEK Mihja i jep GenCo të drejtë ekskluzive të kalimit në, mbi, përtej dhe brenda Tokës së KEK Mihjes, për përdorim nga GenCo, Kontraktuesit e GenCo dhe çdo Person i autorizuar nga GenCo me të gjitha pajisjet dhe makineritë, siç mund të jetë e nevojshme në mënyrë të arsyeshme për t'i ushtruar të drejtat e saj dhe për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje. E drejta e tillë e kalimit do të jetë në fuqi që nga Data e Bartjes si dhe mbetet në fuqi gjatë tërë afatit. Përveç kësaj, KEK Mihjet do t'i ofrojë GenCo dhe do të ekzekutojë dhe skedojë, sipas nevojat, s të gjitha të drejtat tjera, kalimit, servitutit, licencat, të drejtat e shfrytëzimit, si dhe të drejtat tjera të pronës së paluajtshme që me arsye janë të domosdoshme për qëllimin e tillë.
- (b) Minierat e KEK-ut i japin GenCo të drejtë ekskluzive të kalimit në, mbi, përtej dhe brenda korridorit të tubacionit të llaçit të hirit/gipsit, për përdorim nga GenCo, Kontraktuesit e GenCo dhe çdo Person i autorizuar nga GenCo me të gjitha pajisjet dhe makineritë, siç mund të jetë e nevojshme në mënyrë të arsyeshme për t'i ushtruar të drejtat e saj dhe për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje. E drejta e tillë e kalimit do të jetë në fuqi që nga Data e Bartjes si dhe mbetet në fuqi gjatë tërë afatit. Përveç kësaj, Gjenerimi i KEK-ut do t'i ofrojë GenCo të gjitha të drejtat tjera, kalimit, servitutit, licencat, të drejtat e shfrytëzimit, si dhe të drejtat tjera të pronës së paluajtshme që me arsye janë të domosdoshme për qëllimin e tillë.

4.4. Pranimi i përdorimeve të lokacioneve të tjera

- (a) GenCo pranon se KEK Mihja mund ta përdorë tokën e KEK Mihjes (përveç deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, korridorit të tubacionit të llaçit të hirit/gipsit dhe Korridorit të largimit të ujit) për çdo qëllim të ligjshëm, duke përfshirë përdorimin e përcaktuar në Planin e Rikultivimit të Fushës së Minierës B&M/Sibovcit Jugor (nëse është e aplikueshme), me kush që përdorimet e tjera të tilla nuk ndërhyjnë materialisht në të drejtat dhe detyrimet e GenCo ose ndonjë Pale të GenCo sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit dhe me

kusht. gjithashtu, që KEK Mihja nuk depoziton asnjë substancë në deponinë Ekskluzive të Hirit apo deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, duke përfshirë për shmangien e dyshimit për çdo substancë nga Impianti Kosova A apo Kosova B, dhe bën që QK, NP-të e specifikuar dhe të gjithë nënkontraktuesit e tyre dhe palët e treta në Tokën e KEK Mihjes vepron njëjtë. Në lidhje me këtë, GenCo në mënyrë specifike pranon përdorimin e tokës së KEK Mihjes (përveç deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, korridorit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit dhe Korridorit të Largimit të Ujit) si një lokacion i mbeturinave komunale, siç përcaktohet apo që do të përcaktohet në marrëveshje të veçantë ndërmjet KEK Mihjes dhe palës përgjegjëse për mbeturinat komunale dhe deponisë së djerrinës. KEK Mihja pranon dhe pajtohet se do ta zhdëmtojë GenCo në lidhje me përdorimet e tjera të lokacionit siç parashikohet në Article 15 .

- (b) GenCo nuk do të ndërhyjë në mënyrë të paarsyeshme në përdorimet e tjera të Tokës së KEK Mihjes.
- (c) GenCo nuk do të jetë përgjegjës për aktivitetet, përfshirë operimin dhe mirëmbajtjen, në Tokën e KEK Mihjes (përveç asaj që kërkohet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Marrëveshjeve të tjera të Projektit për Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, Korridorit të tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit dhe korridorit të largimit të Ujit).
- (d) KEK Mihja do të bëjë përpjekje të arsyeshme komerciale për të siguruar që asnjë palë e tretë të mos ndërhyjë në mënyrë të paarsyeshme në përdorimin e GenCo të Tokës së KEK Mihjes.

4.5. Toka e KEK Mihjes

- (a) Gjashtëdhjetë (60) Ditë pas Përzgjedhjes së Lokacionit, Palët do të zhvillojnë një përkrahje të Tokës së KEK Mihjes që synon të tregojë deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, Korridorin e Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit dhe tokën e KEK Mihjes përreth kësaj.
- (b) Menjëherë pas zhvillimit të përkrahjes të Tokës së KEK Mihjes, por në asnjë rast jo më vonë se Data e Transferimit, Palët do të ndryshojnë këtë Marrëveshje për të shtuar një përkrahje të Tokës së KEK Mihjes si Skema 3 e kësaj Marrëveshjeje.

Article 5

Përgjegjësia për deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo dhe Sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit

5.1. Transferimi i kujdestarisë dhe kontrollit

- (a) KEK Mihja do të vazhdojë të ketë në pronësi deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo.
- (b) GenCo do të zotërojë Sistemin e Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit.

5.2. Përgjegjësitë operacionale

- (a) Në kosto dhe shpenzim të GenCo (duke pranuar që GenCo do të ketë të drejtën e rimbursimit të kostove të tilla në përputhje me Skemën 1 të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë Elektrike), dhe pas marrjes së lejeve të nevojshme operative dhe të mirëmbajtjes nga autoritetet e zbatueshme , , GenCo do të operojë dhe mirëmbajë Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, Sistemin e Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit në çdo kohë në përputhje me planin e rikultivimit të minierave B&M/ minierës së Sibovcit Jugor, praktikatat prudenciale të ndërmarrjeve publike, ligjet të Kosovës dhe Standardet Mjedisore, përfshirë përmes:
 - (i) sigurimit të Hirit që depoziton në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo;

- (ii) sigurimit të Gipsit që depoziton në Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo;
 - (iii) pompimit të ujit në ose nga Deponia Ekskluzive e Hirit të GenCo dhe deponia Ekskluzive e Gipsit të GenCo, si të nevojshme për funksionimin dhe mirëmbajtjen e sigurt dhe të besueshme të deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo dhe deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, subjekt i nenit 4.1.3(b).
- (b) Pavarësisht nenit 5.2(a), të gjitha gjambat ose ndëshkimet e tjera të pësuara nga KEK Mihja ose nga ndonjë nga palët e KEK Mihjes, në lidhje me tokën e KEK Mihjes (përveç Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, Sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit) apo GenCo ose çdo Palë e GenCo për mospërbushje të ligjeve të aplikueshme të Kosovës, do të jenë përgjegjësi e vetme e Personit mospërbushës dhe nuk rimbursohen nga Pala tjetër, përveç nëse rezultojnë drejtpërdrejt nga një veprim ose mosveprim i Palës tjetër, në të cilin rast, pala që ka pësuar një detyrim të tillë do të rimbursohet nga Pala tjetër.
- (c) Në kosto dhe shpenzim të GenCo (duke pranuar që GenCo do të ketë të drejtën e rimbursimit të kostove të tilla në përputhje me Skemën 1 të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë Elektrike), dhe pas marrjes së lejeve të nevojshme operative dhe të mirëmbajtjes nga autoritetet e zbatueshme , , GenCo do të operojë dhe mirëmbajë Korridorin e Largimit të Ujit në çdo kohë në përputhje me planin e rikultivimit të minierave B&M/ minierës së Sibovcit Jugor, praktikat prudeniale të ndërmarrjeve publike, ligjet të Kosovës dhe Standardet Mjedisore.

5.3. Mbrojtja e deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo dhe Sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit

- (a) Në kosto dhe shpenzime të veta, GenCo (duke pranuar se GenCo do të ketë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të tilla në përputhje me Skemën 1 të Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë), do të ndërmerr veprimet e tilla të arsyeshme për të parandaluar kushtet që do të kishin efekt negativ në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, Sistemin e Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit në përputhje me Praktikën Prudeniale të Ndërmarrjeve Publike.
- (b) KEK Mihja mund të ndërmerr çdo veprim të arsyeshëm të nevojshëm për të parandaluar kushtet që do të kishin një efekt negativ material në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, Sistemin e Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit, ose ndonjë pronë tjetër ose Personi tjetër, në pajtim me Praktikën Prudeniale të Mihjes që GenCo nuk arrin t'i ndërmerr në përputhje me nenin 5.3(a), me kusht, megjithatë, që, përveç në rast të emergjencës, KEK Mihjet nuk do të marrin veprime të tilla, përveç nëse dhe derisa dështimi i tillë vazhdon për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pas njoftimit nga KEK Mihja se synon të marrë një veprim të tillë. GenCo rimbursos KEK Mihjen për shpenzimet e saj të arsyeshme dhe të dokumentuara të realizuara për veprimet sipas këtij neni 5.3(b).

Article 6

Koordinimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo

6.1. Koordinimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo

KEK Mihja dhe GenCo do të:

- (a) takohen periodikisht për të rishikuar gjendjen dhe mirëmbajtjen e Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, siç janë dakordur reciprokisht; dhe
- (b) punojnë në mënyrë të koordinuar, në masën e nevojshme, për të koordinuar aktivitetet operacionale dhe të mirëmbajtjes në lidhje me Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponinë

Ekskluzive të Gipsit të GenCo, Sistemin e Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit dhe Tokën e KEK Mihjes dhe për të mos ndërhyrë, parandaluar ose vonuar aktivitetet e rikultivimit, operimit dhe mirëmbajtjes të, në rastin e GenCo, Tokës së KEK Mihjes, dhe në rastin e KEK Mihjes, Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, Sistemin e Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit.

6.2. Procedurat në Lokacion të KEK Mihjes

KEK Mihja mund të nxjerr procedura të arsyeshme vendore për operimin dhe mirëmbajtjen e tokës së KEK Mihjes dhe rregulla në lidhje me qasjen përmes dhe mbi tokën e KEK Mihjes sipas praktikave prudenciale të minierave, ligjeve të Kosovës, Planit të Rikultivimit të Minerës B&M/Sibovcit Jugor (nëse është e aplikueshme), dhe standardet e aplikueshme, me kusht që procedurat e tilla janë në përputhje me standardet e aplikueshme, dhe tutje, me kusht që këto procedura do të zbatohen për çdo palë duke përdorur Tokat e KEK Mihjes. Procedurat e tilla të sigurisë mund të ndryshojnë kohe pas kohe. Duke mos anashkaluar pikat paraprake, GenCo do të ketë të drejtë të propozojë korrigjime të arsyeshme në procedurat e sigurisë si më lart, ndërsa KEK Mihja në masë të arsyeshme duhet të trajtojë ato korrigjime të propozuara.

6.3. Rregulloret e GenCo

GenCo lëshon, zbaton dhe mirëmban rregullore të sigurisë për operimin dhe mirëmbajtjen e Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, Sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit sipas praktikave prudenciale të ndërmarrjeve publike, Planit të Rikultivimit të Minerës B&M/Minierës së Sibovcit Jugor (nëse ka), Ligjeve të Kosovës dhe Standardeve të Aplikueshme. GenCo do t'i informojë punonjësit e tij dhe Kontraktuesit GenCo mbi këto rregullore dhe procedura dhe trajnon të punësuarit dhe Kontraktuesit e GenCo në të njëjtën mënyrë dhe siguron se ato janë jenë në pajtim me rregulloret dhe procedurat e tilla gjatë kryerjes së detyrave të tyre sipas kësaj marrëveshjeje. GenCo i siguron KEK Mihjes një kopje të këtyre rregulloreve dhe procedurave dhe ndryshimeve të tyre. Në rast se Genco ndërmerr punë në lidhje me pronat e KEK Mihjes e që nuk janë pjesë e Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, Sistemit të Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit, Genco duhet të veprojë në përputhje me rregullat e arsyeshme të sigurisë dhe procedurat e përcaktuara nga KEK Mihja (duke përfshirë respektimin e kushteve të lejeve të lëshuara) deri në masën që KEK Mihja jep njoftim me shkrim (dhe një kopje) të këtyre rregulloreve dhe procedurave për GenCo para kryerjes së punëve të tilla.

Article 7

Rikultivimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo

7.1. Rikultivimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo

(a) Deri në ditën e fundit të Afatit, GenCo do të ketë:

- (i) ndërmarrë të gjitha veprimet e kërkuara për tu ndërmarrë më ose para datës së tillë në Korridorin e Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit dhe Korridorin e Largimit të Ujit në pajtim me këtë Marrëveshje në përputhje me Standardet Mjedisore;
- (ii) ndërmarrë të gjitha veprimet e kërkuara për tu ndërmarrë më ose para datës së tillë në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo në përputhje me Planin e Rikultivimit të Minerës B&M/Sibovcit Jugor (nëse është e aplikueshme); dhe
- (iii) larguar, përveç nëse QK dorëzon njoftim paraprak me shkrim prej njëqind e tetëdhjetë ditësh (180) për KEK Mihjet dhe GenCo duke informuar KEK Mihjet dhe GenCo se Deponia Ekskluzive e Hirit të GenCo dhe Deponia Ekskluzive e Gipsit të GenCo do të

mbesin në operim pas fundit të Afatit apo kërkesat tjera, të gjitha pasjisjet e tij nga deponia Ekskluzive e Hirit të GenCo dhe deponia Ekskluzive e Gipsit të GenCo me qëllim të dekomisionit dhe mbylljes së deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe/apo deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo në përputhje me Standardet e zbatueshme,

Secila në pajtim me Praktikat Prudente të Ndërmarrjeve Publike, Planin e Rikultivimit të Minierës B&M /Minierës së Sibovcit Jugor (nëse aplikohet), ligjet e Kosovës, standardet e Shëndetit dhe Sigurisë, dhe Standardet e Mjedisore;

- (b) Përveç nëse QK ofron njoftim paraprak me shkrim prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve për KEK Mihjen dhe GenCo se deponia Ekskluzive e Hirit të GenCo do të mbetet në operim pas fundit të Afatit apo kërkesave të tjera, duke filluar nga Dita e fundit e Afatit, GenCo, në kosto dhe shpenzim të GenCo (me rimbursim të të gjitha kostove arsyeshme dhe prudente nga KEK Mihja pas përfundimit të mbylljes dhe stabilizimit të punës së përshkruar këtu, duke pranuar se GenCo do të ketë të drejtë t'i rimbursojë këto kosto si “shuma të papaguara” (term i cili përdoret në nenin 2.1 të Skemës 3 të Marrëveshjes së Zbatimit) në kuadër të Çmimit të Blerjes Prapa (term që përkufizohet në Marrëveshjen e Zbatimit) me kusht që ato janë pësuar në mënyrë të arsyeshme dhe të matur):

- (i) do të mbulojë deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo me argjilë; dhe
- (ii) do të ndërmerr të gjitha veprimet e kërkuara për të stabilizuar tërë hirin e depozituar në deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe gipsin e depozituar në deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo,

Secila në pajtim me Praktikat Prudente të Ndërmarrjeve Publike, Planin e Rikultivimit të Minierës B&M /Minierës së Sibovcit Jugor (nëse aplikohet), ligjet e Kosovës, standardet e Shëndetit dhe Sigurisë, dhe Standardet e Mjedisore;

- (c) Nëse QK jep një njoftim paraprak me shkrim prej njëqind e tetëdhjetë (180) Ditësh për KEK Mihjen dhe GenCo se deponia Ekskluzive e Hirit të GenCo do të mbetet në operim pas përfundimit të afatit ose ka kërkesë të ngjashme, duke filluar pas Ditës së Fundit të Afatit, KEK Mihja do të jetë përgjegjës për:

- (i) mbulimin e deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo me argjilë; dhe
- (ii) ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të kërkuara për të stabilizuar tërë hirin e depozituar në deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe gipsin e depozituar në deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo,

Secila në pajtim me Praktikat Prudente të Ndërmarrjeve Publike, Planin e Rikultivimit të Minierës B&M /Minierës së Sibovcit Jugor (nëse aplikohet), ligjet e Kosovës, standardet e Shëndetit dhe Sigurisë, dhe Standardet e Mjedisore;

Article 8

Mbrojtja e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë

8.1. Mbrojtja e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë

- (a) Në lidhje me largimin e hirit apo gipsit nga GenCo në fund të Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo, GenCo, duke bërë përpjekje të arsyeshme komerciale, do të merr hapat e nevojshëm dhe adekuatë në pajtim me Praktikat e Kujdesshme të Ndërmarrjeve dhe Praktikat Prudenciale të Mihjes për të vepruar në pajtueshmëri me të gjitha aspektet materiale me Standardet e zbatueshme dhe për të parandaluar Kushtet Mjedisore/Arkeologjike brenda kontrollit të arsyeshëm të asaj Pale.

- (b) Nëse një Palë shkakton një Kusht Mjedisor/Arkeologjik siç përshkruhet në nenin 8.1(a), Pala e tillë do të ndërmerë menjëherë të gjitha veprimet korrigjuese siç kërkohet me Standardet Mjedisore.
- (c) GenCo, sa më shpejt që të jetë e arsyeshme (por jo më shumë se katër (4) orë pasi që verbalisht personeli i GenCo ose Kontraktuesit O&M të jetë në dijeni të një aksidenti material ose emergjence) njofton Autoritetin përkatës Publik për aksidentin ose emergjencën mjedisore ose aksidentin material në lidhje me shëndetin dhe sigurinë e punëtorëve, dhe sa më shpejt të jetë e mundur (por në asnjë rast jo më shumë se katër (4) ditë pune pasi GenCo apo personeli i Kontraktuesit të O&M bëhet në dijeni mbi aksidentin material apo emergjencën) jep raport me shkrim të shkaqeve dhe rezultateve të ngjarjes dhe masave të ndërmarra deri më tani, dhe mbi veprimet e planifikuara për ta korrigjuar aksidentin e tillë material ose emergjencën dhe raporton në mënyrë periodike, por në asnjë rast jo më rrallë se në baza mujore, deri në përfundimin e çdo korrigjimi të kërkuar pas aksidentit apo emergjencës së tillë materiale, mbi programet e rehabilitimit dhe planet e reagimit ndaj emergjencave për Kushtet Mjedisore/Arkeologjike që lidhen me deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo dhe sistemin e Tubacionit të Llaçit të Hirit/Gipsit.

Article 9

Zgjerimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo

9.1. Zgjerimi i Deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo

Me kërkesë të GenCo, KEK Mihja do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të akomoduar një zgjerim ose ndonjë ndryshim tjetër të përshtatshëm për madhësinë dhe vendndodhjen e saktë të deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo apo deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo. GenCo dhe KEK Mihja bien dakord që dizajnimi dhe ndërtimi i deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo apo deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo dhe çdo zgjerim ose modifikim i tyre do të dakordohet reciprokisht nga Palët për të siguruar deponitë më të përshtatshme, të besueshme dhe ekonomike të Hirit dhe Gipsit, pa asnjë ndërprerje në disponueshmërinë e tyre për largimin e Hirit dhe Gipsit nga GenCo. Palët negociojnë në mirëbesim ndryshimet e tilla të kësaj Marrëveshjeje siç mund të jenë të arsyeshme të nevojshme për të llogaritur zgjerimin ose modifikimin tjetër të përshtatshëm për madhësinë dhe vendndodhjen e saktë të deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo apo deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo. Çdo zgjerim i deponisë Ekskluzive të Hirit të GenCo ose deponisë Ekskluzive të Gipsit të GenCo duhet të bëhet në përputhje me Praktikat Prudente të Ndërmarrjeve, Praktikat e Prudente Mihjes, Ligjet e Kosovës, Planin e Rikultivimit Fushës së Minierave B&M/Sibovcit Jugor (nëse aplikohet) dhe standardet e aplikueshme.

Article 10

Titulli dhe rreziku i humbjes

10.1. Titulli dhe rreziku i humbjes së Hirit

GenCo do të mbaj titullin dhe të gjitha rreziqet e humbjes për sa i përket Hirit para dhe pas dërgesës së hirit nga GenCo në deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo deri në skadimin apo ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje, në të cilën kohë titulli dhe rreziku i humbjes automatikisht kalon tek KEK Mihja.

10.2. Titulli dhe rreziku i humbjes së Gipsit

GenCo do të mbaj titullin dhe të gjitha rreziqet e humbjes për sa i përket gipsit para dhe pas dërgesës së Gipsit nga GenCo në deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo deri në skadimin apo ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje, në të cilën kohë titulli dhe rreziku i humbjes automatikisht kalon tek KEK Mihja.

Article 11 Tarifat

11.1. Pa tarifa

Nuk do të paguhet asnjë tarifë hyrjeje, tarifë rikultivimi, apo tarifa të tjera për largimin e hirit apo gipsit sipas kësaj Marrëveshjeje.

Article 12 Tatimet

12.1. Tatimet e zbatueshme për Mihjen e KEK-ut

Të gjitha tatimet aktuale dhe të ardhme qendrore, komunale, si dhe tatimet tjera të ligjshme që vlejné për Mihjen e KEK-ut e që rrjedhin nga apo lidhen me të drejtat e detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje paguhen nga Mihja e KEK-ut sipas dhe kurdo që nevojitet sipas Ligjeve të Kosovës.

12.2. Tatimet që vlejné për GenCo-n

Të gjitha tatimet aktuale dhe të ardhme qendrore, komunale, si dhe tatimet tjera të ligjshme që vlejné për GenCo-n e që rrjedhin nga apo lidhen me të drejtat e detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje paguhen nga GenCo sipas dhe kurdo që nevojitet sipas Ligjeve të Kosovës, si dhe shuma e Tatimeve të tilla përfshihet brenda tarifës së paraparë me Skemën 1 të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë.

Article 13 Sigurimi

13.1. Mirëmbajtja e Policave të Sigurimit -- GenCo

- (a) GenCo do të merr dhe mbajë sigurim në përputhje me Marrëveshjen e Blerjes së Energjisë. Nëse dhe në atë masë që KEK Mihja mund të emërohet si i siguruar shtesë ndaj çdo zjarri, rreziku, viktime dhe në polica të sigurimit të përgjegjësive të kërkuara sipas Marrëveshjeve të tilla të Projektit, KEK Mihja do të emërohen si e tillë nga GenCo.
- (b) Kopjet e kërkesave të parashtruara ose njoftimeve të pranimit të të ardhurave të sigurimit në lidhje me deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo dhe deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo do të ofrohen për KEK Mihjet brenda shtatë (7) ditëve të punës nga kërkesa e dorëzuar ose pranimit i të ardhurave nga GenCo.

13.2. Mirëmbajtja e sigurimit - KEK Mihja

- (a) Polica e përgjegjësive. KEK Mihja do të mbajë, ose do të sigurojë se mbahen, gjatë tërë kohës së Afatit, në fuqi dhe efekt të plotë, sigurimet e përgjithshme të përgjegjësive komerciale duke përfshirë mbulimin e detyrimit ligjor që rrjedh nga lëndimet trupore, lëndimet personale, dëmtimi i pronës, përgjegjësia kontraktuese (duke përfshirë mbulimin specifik për ndërmarrjet në këtë Marrëveshje), produktin(et) dhe operationet e përfunduara, dhe detyrimin e papritur/aksidental të ndotjes, duke përfshirë përgjegjësinë juridike që rrjedh nga aktet e kontraktuesve të pavarur. Secila mbulesë e tillë mund të jetë pjesë e polisës (apo një polise të ndarë) apo të mundësohet përmes indosamentit. Sigurimi i tillë nuk duhet të përjashtojë eksplozimin, rrënimin apo rreziqet nëntokësore. Shuma e siguruar nuk do të jetë më e vogël se njëzetepesëmilionë Euro (25,000,000 €) për ngjarje dhe në agregat në vit. GenCo do të shtohet si i siguruar shtesë.
- (b) Polica e Përgjegjësive për Dëmtim Mjedisor. KEK Mihja do të mbajë, apo siguron se mbahen, nga Data e transferimit dhe gjatë tërë Afatit në fuqi dhe efekt të plotë, sigurim të përgjegjësive së dëmtimit mjedisor duke përfshirë mbulim për tërë Tokën e KEK Mihjes për sa i përket Gjendjeve Mjedisore që ndodhin së pari më apo pas datës së transferimit. Secila mbulesë e tillë mund të jetë pjesë e polisës (apo një polise të ndarë) apo të mundësohet përmes indosamentit. Shuma e siguruar nuk do të jetë më e vogël se pesëmbëdhjetë milionë Euro (15,000,000 €) për kërkesëpadi

dhe në agregat. GenCo do të shtohet si i siguruar shtesë. Për shmangie të dyshimeve, sigurimi i përgjegjësisë për dëmtim mjedisor duhet të përfshijë sigurim të përgjegjësisë ligjore për ndotje që mbulon shpenzimet, dëmtimet dhe Humbjet që lindin nga incidentet ndotëse, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, sa i përket lëndimeve trupore dhe dëmtimeve të pronave që shkaktohen nga ekspozimi ndaj Materieve të Dëmshme, shkarkimi, emisionet, rrjedhja, migrimi, përhapja, lirimi apo ikja e ndonjë Materieje të Dëmshme, apo prania e Materieve të Dëmshme që janë depozituar ilegalisht apo të braktisura në Tokën e KEK Mihjes nga cilado palë që nuk është KEK Mihje, si dhe duke përfshirë, por pa kufizim, koston e hetimeve, rehabilitimit dhe monitorimit mjedisor që lidhet me apo del nga Gjendja Mjedisore.

(c) Përfshirjet e Kriterëve të Sigurimit. Konsiderohet që Mihja e KEK-ut nuk do të kryejë shkelje të detyrimeve të tij sipas këtij Paragrafi 13.2 deri në masën dhe për aq sa:

(i) Ose:

(A) Çdo sigurim i posaçëm (ose indosament i nevojshëm) nuk është në dispozicion nga siguresit nga të cilët Mihja e KEK-ut lejohet me Ligjet e Kosovës të blejë polisa në pajtim me këtë Paragraf , me kusht që Mihja e KEK-ut të ketë dorëzuar njoftimin për këtë tek GenCo, përcjellë me një raport të shkruar të përgatitur nga një (1) konsulent i pavarur i sigurimeve apo ndërmjetës sigurimesh në mënyrë të pavarur, pa interesa vetjakë, në cilindo rast të reputacionit të njohur ndërkombëtar, duke vërtetuar që sigurimi i tillë nuk është në dispozicion nga siguresit nga të cilët Mihja e KEK-ut lejohet me Ligjet e Kosovës të blejë polisa; dhe

(B) Çdo sigurim i posaçëm (ose indosament i nevojshëm) nuk është në dispozicion nga siguresit nga të cilët Mihja e KEK-ut lejohet me Ligjet e Kosovës të blejë polica në pajtim me këtë Paragraf 13.2(a) apo (b), me kusht që Mihja e KEK-ut të ketë dorëzuar njoftimin për këtë tek GenCo, përcjellë me një raport të shkruar të përgatitur nga një (1) konsulent i pavarur i sigurimeve apo ndërmjetës sigurimesh në mënyrë të pavarur, pa interesa vetjakë, në cilindo rast të reputacionit të njohur ndërkombëtar, duke vërtetuar që sigurimi i tillë nuk është në dispozicion nga siguresit nga të cilët Mihja e KEK-ut lejohet me Ligjet e Kosovës të blejë polica; dhe

(ii) KEK Mihja bën përpjekje të arsyeshme komerciale për të siguruar, në kosto dhe shpenzime të veta, sigurime të tjera që mbulojnë, aq shumë sa që është e mundur të arrihet, mbrojtje të krahasueshme ndaj rreziqeve që do të sigurohen dhe KEK Mihja jep njoftim për GenCo të kushteve të atij sigurimi, shoqëruar me një raport me shkrim të përgatitur nga një (1) konsulent i pavarur i sigurimeve ose një (1) agjent sigurimi që vepron në mënyrë të pavarur, në të dy rastet me pozicion ndërkombëtar, që certifikon se sigurimet e tilla, për aq sa është e mundur maksimalisht, ofrojnë mbrojtje të krahasueshme ndaj rreziqeve të siguruar për KEK Mihjet.

Article 14

Zotimet dhe garancitë

14.1. Zotimet dhe garancitë e GenCo-s

GenCo zotohet dhe i garanton Mihjes së KEK-ut që në datën e Ekzekutimit:

(a) GenCo është entitet i organizuar ligjërisht, ekziston ligjërisht, si dhe në pozitë të rregullt sipas ligjeve të Luksemburgut; me kusht, megjithatë, që në riafirmimet e dhëna nga GenCo sipas nenit

14.3, GenCo duhet të zotohet dhe t'i garantojë Mihjes së KEK që GenCo entitet i organizuar ligjërisht, ekziston ligjërisht, si dhe në pozitë të rregullt sipas ligjeve të Kosovës;

- (b) Ekzekutimi, zbatimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nga GenCo është autorizuar ligjërisht me të gjitha veprimet e kërkuara korporative, si dhe GenCo ka autorizim të plotë korporativ dhe autoritet për të ekzekutuar, zbatuar dhe përmbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (c) Kjo Marrëveshje përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe obligativ të GenCo-s, të përbarueshëm ndaj saj në pajtim me kushtet e Marrëveshjes, sa i përket zbatueshmërisë së mjeteve juridike, kufizimeve të vendosura me bankrotim, paaftësi pagese, riorganizim, moratorium apo ligje të tjera të ngjashme në fuqi, që kanë të bëjnë me apo ndikojnë në përbarimin e të drejtave të kreditorëve në përgjithësi, si dhe parimet e përgjithshme të ekuitetit;
- (d) Ekzekutimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk është në kundërtënie me asnjë dispozitë, e as nuk përbën shkelje, të ndonjë pengu, hipoteke, apo ndonjë marrëveshjeje materiale që është obligative për GenCo-n, apo ndonjë urdhri valid të ndonjë gjykate, apo ndonjë agjencie rregullative apo ndonjë organi kompetent veprimeve të të cilit i nënshtrohet GenCo; si dhe
- (e) Asnjëra prej ekzekutimit, zbatimit apo përmbushjes nga GenCo të kësaj Marrëveshjeje, përputhshmëria me kushte dhe dispozitat e saj, si dhe kryerja e transaksioneve të parapara me Marrëveshje, nuk është në konflikt e as nuk do të jetë në konflikt e as të rezultojë me shkelje apo kundërvajtje ndaj Dokumenteve Themeltare apo ndonjë prej kushteve, afateve apo dispozitave të cilitdo Ligj të Kosovës apo ndonjë leje të vlefshme, apo ndonjë urdhër, vendim, masë të përkohshme, aktgjykim apo dekret të ndonjë Autoriteti Publik ndaj GenCo-s.

14.2. Zotimet dhe garancitë e Mihjes së KEK-ut

Mihja e KEK-ut zotohet dhe i garanton GenCo-s që në datën e Ekzekutimit:

- (a) Mihja e KEK-ut është entitet i organizuar ligjërisht, ekziston ligjërisht, si dhe është në pozitë të mirë sipas Ligjeve të Kosovës;
- (b) Ekzekutimi, zbatimi dhe përmbushja e kësaj Marrëveshjeje nga Mihja e KEK-ut është autorizuar ligjërisht me të gjitha veprimet e kërkuara korporative, si dhe Mihja e KEK-ut ka autorizim të plotë korporativ dhe autoritet për të ekzekutuar, zbatuar dhe përmbushur të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (c) Kjo Marrëveshje përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe obligativ të Mihjes së KEK-ut, të përbarueshëm ndaj saj në pajtim me kushtet e Marrëveshjes, sa i përket zbatueshmërisë së mjeteve juridike, kufizimeve të vendosura me bankrotim, paaftësi pagese, riorganizim, moratorium apo ligje të tjera të ngjashme në fuqi, që kanë të bëjnë me apo ndikojnë në përbarimin e të drejtave të kreditorëve në përgjithësi, si dhe parimet e përgjithshme të ekuitetit;
- (d) Ekzekutimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nuk është në kundërtënie me asnjë dispozitë, e as nuk përbën shkelje, të ndonjë pengu, hipoteke, apo ndonjë marrëveshjeje materiale që është obligative për Mihjen e KEK-ut, apo ndonjë urdhri valid të ndonjë gjykate, apo ndonjë agjencie rregullative apo ndonjë organi kompetent veprimeve të të cilit i nënshtrohet Mihja e KEK-ut;
- (e) Mihja e KEK-ut nuk është në kundërvajtje ndaj ndonjë marrëveshjeje apo instrumenti të asnjë natyre në të cilën është Palë apo për të cilën është i detyruar, në asnjë mënyrë që të ketë efekt negativ në zotësinë e tij për të përmbushur obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, vlefshmërinë apo përbarimin e kësaj Marrëveshjeje;
- (f) Nuk ka ndonjë mjet juridik, padi, procedurë apo hetim në vazhdim, apo në njohuritë e Mihjes së KEK-ut, që kërcënon:
 - (i) Shpërbërjen e Mihjes së KEK-ut;

- (ii) përfshirjen e mospagesave të Mihjes së KEK të:
 - (A) tatimeve ndaj çdo autoriteti publik; apo
 - (B) çdo borxhi ndaj personi që është:
 - (1) shtetas ose i organizuar sipas ligjeve të Kosovës; ose
 - (2) në kontroll të të QK, KESCO, apo një NP të specifikuar; ose
- (iii) Ndryshe kundër Mihjes së KEK-ut

Që nëse vendoset në dëm të saj, do të kishte efekt material negativ në zotësinë e saj për të përmbushur obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose në vlefshmërinë apo përbarimin e kësaj Marrëveshjeje; si dhe

- (g) Asnjëra prej ekzekutimit, zbatimit apo përmbushjes nga Mihja e KEK-ut të kësaj Marrëveshjeje, përputhshmëria me kushte dhe dispozitat e saj, si dhe kryerja e transaksioneve të parapara me Marrëveshje, nuk është në konflikt e as nuk do të jetë në konflikt e as të rezultojë me shkelje apo kundërvajtje ndaj Dokumenteve Themeltare apo ndonjë prej kushteve, afateve apo dispozitave të cilitdo Ligj të Kosovës apo ndonjë leje të vlefshme, apo ndonjë urdhër, vendim, masë të përkohshme, aktgjykim apo dekret të ndonjë Autoriteti Publik ndaj Mihjes së KEK-ut.

14.3. Riafirmimi i zotimeve dhe garancive

Në Datën Efektive, GenCo duhet t'i dorëzojë një vërtetim Mihjes së KEK-ut, duke konfirmuar që zotimet dhe garancitë sipas Seksionit 14.1 janë të vërteta dhe të sakta në atë datë, ndërsa Mihja e KEK-ut duhet t'i dorëzojë një vërtetim GenCo-s duke konfirmuar që zotimet dhe garancitë sipas Seksionit 14.2 janë të vërteta dhe të sakta në atë datë.

Article 15 Zhdëmtimi

15.1. Zhdëmtimi

15.1.1 Zhdëmtimi i Mihjes së KEK-ut

Përveç dispozitës specifike si më poshtë apo tjetërkund në këtë Marrëveshje apo në Marrëveshjet e Projektit, Mihja e KEK-ut liron nga përgjegjësia dhe mbron GenCo-n dhe çdo Palë të GenCo-s nga të gjitha Humbjet e pësura apo që duhen paguar, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga apo që vendosen mbi GenCo-n apo ndonjë Palë të GenCo-s, në të gjitha rastet pas Datës Efektive:

- (a) Për lëndimet personale apo vdekjen e personave apo dëmtimin e pronës që lind nga neglizhenca apo kundërvajtja e qëllimshme nga ana e Mihjes së KEK-ut apo ndonjë Palë të Mihjes së KEK-ut në lidhje me këtë Marrëveshje;
- (b) Në lidhje me ndonjë pretendim apo parashtresë të ndonjë pale të tretë, e cila lind nga apo lidhet me shkeljen e ndonjë Ligji të Kosovës nga ana e Mihjes së KEK-ut;
- (c) Në lidhje me ndonjë pretendim apo parashtresë të ndonjë pale të tretë, e cila lind nga apo lidhet me shkeljen apo kundërvajtjen e Mihjes së KEK-ut ndaj ndonjë prej obligimeve apo zotimeve dhe garancive sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (d) Që lind nga, lidhet me, apo shkaktohet nga ndonjë Gjendje Mjedisore/Arkeologjike në lidhje me të Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo ose Tokën e Mihjes së KEK-ut që ekzistojnë në apo para Datës së Bartjes, përveç deri në masën që ato përgjegjësi:

- (i) Rezultojnë nga, lidhen me apo lindin nga ndonjë veprim i GenCo-s apo ndonjë Pale apo Personi të përafërt nën kontrollin e GenCo-s, duke përfshirë edhe në lidhje me fillimin (përfshirë ato para Datës së Bartjes, nëse ka) e aktiviteteve të GenCo-s në të Drejtën e Kalimit të GenCo-s për Dorëzimin e Linjtit ose Tokën e Mihjes së KEK-ut; ose
 - (ii) Janë zhdëmtuar nga QEK-ha sipas Seksionit 8.2 (Zhdëmtimi për Standardet Mjedisore) të Marrëveshjes së Implementimit, apo lidhen me kostot apo Humbjet që janë të pagueshme apo janë paguar tek GenCo në pajtim me Nenin 15 të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë; dhe
- (e) Rezultojnë nga, lidhen me apo lindin nga ndonjë Gjendje Mjedisore/Arkeologjike që ekziston në deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCotë, deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCoose Tokën e Mihjes së KEK-ut pas Datës së Bartjes, duke përfshirë të gjitha gjendjet që rezultojnë nga veprimi apo mosveprimi i Mihjes së KEK-ut, ndonjë Pale të Mihjes së KEK-ut, apo ndonjë NP-je të Specifikuar apo QEK-së, përveç deri në masën që ato përgjegjësi rezultojnë nga apo lidhen me ndonjë veprim të GenCo-s apo ndonjë Personi nën kontrollin e GenCo-s apo të një pale të tretë deri në masën që GenCo, duke vepruar në pajtim me Praktikrat e Matura të Ndërmarrjes, do të mund të parandalonte Gjendjen Mjedisore/Arkeologjike të shkaktuar nga ajo palë e tretë.

15.1.2 Zhdëmtimi i GenCo-së

Përveç dispozitës specifike si më poshtë apo tjetërkund në këtë Marrëveshje apo në Marrëveshjet e Projektit, GenCo liron nga përgjegjësia dhe mbron Mihjen e KEK-ut dhe çdo Palë të Mihjes së KEK-ut, në të gjitha kohët pas Datës Efektive, nga të gjitha Humbjet e pësuar apo që duhen paguar, drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga apo që vendosen mbi Mihjen e KEK-ut apo ndonjë Palë të Mihjes së KEK-ut:

- (a) Për lëndimet personale apo vdekjen e personave apo dëmtimin e pronës që lind nga neglizhenca apo kundërvajtja e qëllimshme nga ana e GenCo-s apo ndonjë Palë të GenCo-s në lidhje me këtë Marrëveshje;
- (b) Në lidhje me ndonjë pretendim apo parashtresë të ndonjë pale të tretë, e cila lind nga apo lidhet me shkeljen e ndonjë Ligji të Kosovës nga ana e GenCo-s;
- (c) Në lidhje me ndonjë pretendim apo parashtresë të ndonjë pale të tretë, e cila lind nga apo lidhet me shkeljen apo kundërvajtjen e GenCo-s ndaj ndonjë prej obligimeve apo zotimeve dhe garancive sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (d) Rezultojnë nga, lidhen me apo lindin nga ndonjë Gjendje Mjedisore/Arkeologjike në lidhje me deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo ose Tokën e Mihjes së KEK-ut që lind dhe ekziston pas Datës së Bartjes, (ose nëse GenCo merr në posedim atë lokacion pas Datës së Bartjes, data në të cilën GenCo ka marrë në posedim atë lokacion), deri në masën që ajo Gjendje Mjedisore/Arkeologjike shkaktohet nga GenCo apo ndonjë Person nën kontrollin e GenCo-s apo një palë e tretë deri në masën që GenCo, duk vepruar në pajtim me Praktikrat e Matura të Ndërmarrjes, do të mund të parandalonin Gjendjen Mjedisore/Arkeologjike shkaktuar nga ajo palë e tretë, si dhe përveç deri në masën që ato përgjegjësi lindin nga ndonjë Gjendje Mjedisore/Arkeologjike që ka ekzistuar në apo para Datës së Bartjes, apo rezultojnë nga apo lidhen me ndonjë veprim apo mosveprim të Mihjes së KEK-ut, apo ndonjë NP-je të Specifikuar apo QEK-së.

15.1.3 Përgjegjësia solidare

Në rast se lëndimi apo dëmtimi rezulton nga neglizhenca apo edhe kundërvajtja e qëllimshme e Palëve, secila Palë mban përgjegjësi sipas këtij Article 15 në proporcion me pjesën relative të fajit të vet.

15.1.4 Presumimet në lidhje me Gjendjen Mjedisore/Arkeologjike

- (a) Palët marrin përsipër dhe pajtohen që çdo Gjendje Mjedisore/Arkeologjike e zbuluar në Lokacion para datës tetëmbëdhjetë (18) Muaj pas Datës së Operacioneve Komerciale do të prezumohet të jetë e lidhur me kushtet që kanë ekzistuar më apo para Datës së Bartjes, si dhe të mos lidhen me aktivitetet e GenCo-s më pastaj, në mungesë të provave që Gjendja e tillë Mjedisore/Arkeologjike është shkaktuar nga GenCo apo ndonjë Person nën kontrollin e GenCo-s.
- (b) Duke mos anashkaluar asnjë dispozitë në të kundërtën tek Paragrafi 15.1.4(a), Palët marrin përsipër dhe pajtohen që pas Datës së Operimit Komercial, çdo Gjendje Mjedisore në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo-s, Deponinë Ekskluzive të Gjipsit të GenCo-s, apo ndonjë deponi tjetër të mirëmbajtur nga GenCo, nëse ka të tilla, që është zbuluar dhe lidhet drejtpërdrejt me mbeturinat që deponohen nga GenCo më pastaj do të prezumohet të jetë lidhur me aktivitetet e GenCo-s më pastaj, si dhe të mos lidhen me kushtet që kanë ekzistuar më apo para Datës së Bartjes.
- (c) Duke mos anashkaluar asnjë dispozitë në të kundërtën tek Marrëveshjet e Projektit, (i) në asnjë rrethanë, GenCo e as ndonjë Personë nën kontrollin e GenCo-s nuk mund të prezumohet, në asnjë moment, të ketë shkaktuar ndonjë Gjendje Arkeologjike në Lokacion (duke përfshirë Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo-s, Deponinë Ekskluzive të Gjipsit të GenCo-s apo ndonjë deponi tjetër të mirëmbajtur nga GenCo), si dhe (ii) çdo Gjendje e tillë Arkeologjike do të konsiderohet të jetë Gjendje Mjedisore/Arkeologjike e Kaluar tek kompania amë, pa marrë parasysh datën në të cilën ajo gjendje zbulohet.

15.2. Kufizimi në zhdëmtim

Duke mos anashkaluar asnjë dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshjeje, në asnjë rast, Mihja e KEK-ut apo GenCo apo ndonjë Palë e Mihjes së KEK-ut apo e GenCo-s nuk mund të zhdëmtohet deri në masën që Humbjet e mundshme janë shkaktuar nga neglizhenca apo kundërvajtja e qëllimshme e tyre, apo shkelja nga ana e tyre e kushteve të kësaj Marrëveshjeje apo Marrëveshjeve të Projektit, si dhe në asnjë rast, Mihja e KEK-ut apo GenCo apo ndonjë Palë e Mihjes së KEK-ut apo GenCo-s nuk mund të zhdëmtohet për ndonjë humbje deri në masën që ajo Palë tashmë ka pranuar të ardhurat nga sigurimi apo të ardhurat nga një palë e tretë për këtë, apo ka pranuar apo ka fituar të drejtën e pagesës nga QEK apo ndonjë NP e Specifikuar sipas ndonjë Marrëveshjeje tjetër të Projektit.

Obligimet e zhdëmtimit të Palëve të kësaj Marrëveshjeje zbriten për shumën, si dhe në lidhje me, rimbursimet nga sigurimet apo rimbursimet nga palët e treta nga një Palë e zhdëmtuar për Humbjet e zhdëmtuara me këtë marrëveshje. Nëse Pala bën pagesa në pajtim me detyrimet e saj të zhdëmtimit sipas kësaj marrëveshjeje sa i përket shumave për të cilat siguruesi apo ndonjë palë tjetër e tretë mund të ketë përgjegjësi ligjore, ajo Palë konsiderohet, deri në masën e nevojshme, e nën-siguruara e barazueshme në lidhje me, si dhe bartësja kontraktuale apo juridike, e të drejtës për kërkimin e rimbursimit të atyre shumave nga siguruesi apo pala e tretë, deri në lartësinë e të drejtave të tilla.

Për të shmangur dyshimet, kushtet e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohen të kenë tkurrur, penguar, privuar, modifikuar apo zëvendësuar kushtet e ndonjë polise të aplikueshme të sigurimit, që gjithashtu ofron mbulesë për Humbjet e zhdëmtuara. Duke mos anashkaluar pikat paraprake, zbatueshmëria e polisës së mundshme të sigurimit apo dështimi i siguruesit për të përmbushur obligimet e veta për zhdëmtimin e Humbjeve nuk fal, nuk vonon e as nuk zvogëlon obligimet e zhdëmtimit të Palës zhdëmtuese në asnjë kuptim, e as nuk arsyeton mospërmbushjen e obligimeve të tilla të asaj Pale për zhdëmtim; megjithatë, në përcaktimin e obligimeve respektive ndërmjet Palës zhdëmtuese dhe ndonjë siguruesi, duke pasuar pagesat e Palës në pajtim me obligimin e saj për zhdëmtim sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe në lidhje me ndonjë kontest ndërmjet asaj Pale zhdëmtuese si dhe atij siguruesi në lidhje me obligimin e siguruesit për të rimbursuar Palën zhdëmtuese apo për të ofruar mbulesë tjetër për

humbjen e zhdëmtuar, çdo sigurim i zbatueshëm (me përjashtim të minuseve apo mbajtjeve të zbatueshme) do të konsiderohet primare si obligim i zhdëmtimit të përcaktuar me këtë marrëveshje, si dhe obligimet e zhdëmtimit të përcaktuara me këtë marrëveshje do të konsiderohen si posaçëm të jenë ertej sigurimeve të tilla të vlefshme, por vetëm deri në masën e shumave që janë paguar tashmë për të siguruarin në atë kontratë sigurimi, si dhe me mirëkuptimn e mëtutjeshëm që Pala zhdëmtuese në të gjitha rastet do të jetë përgjegjëse për Humbjen e zhdëmtuar, deri në masën e obligimeve të veta të zhdëmtimit të përcaktuara këtu, brenda minuseve apo mbajtjeve të përcaktuara me atë sigurim të vlefshëm.

15.3. Parashtrimi i kërkesave që tejkalojnë shumën minimale të zhdëmtimit

Secila Palë mban përgjegjësi individuale, si dhe nuk ka të drejtë të parashtrojë kërkesa për zhdëmtim ndaj Palës tjetër sipas këtij Article 15, për asnjë Humbje që përndryshe do të ishte subjekt i zhdëmtimit sipas kësaj Marrëveshjeje, deri sa, sipas rastit, (i) të gjitha Humbjet e Palëve të GenCo-s apo ndonjë Humbje të Kompanisë Holding Sponsore apo Palët e Kompanisë Holding Sponsore dhe Sponsorit Ultimativ apo Palëve të Sponsorit Ultimativ, të agreguara, sipas të gjitha Marrëveshjeve të Projektit tejkalojnë Shportën e Zhdëmtimit të vlefshme për to ose (ii) të gjitha Humbjet e QEK-së apo Palëve të QEK-së dhe NkeC-së apo Palëve të NkeC-së dhe Gjenerimit të KEK-ut apo Palëve të Gjenerimit të KEK-ut dhe Mihjes së KEK-ut apo Palëve të Mihjes së KEK-ut dhe Furnizuesit të Ujit apo Palëve të Furnizuesit të Ujit Dhe të ndonjë NP-je të Specifikuar apo palëve të përafërta, të agreguara, sipas të gjitha Marrëveshjeve të Projektit tejkalojnë Shportën e Zhdëmtimit të vlefshme për to.

15.4. Mbrojtja e Kërkesave

15.4.1 Njoftimi për Kërkesat

- (a) Pala duhet që të njoftojë menjëherë Palën tjetër, me shkrim, për humbjet e mundshme apo procedurat në lidhje me të cilat Pala njoftuese është apo mund të fitojë të drejtën e zhdëmtimit në pajtim me Article 15 (“**Njoftimi për Zhdëmtimin**”).
- (b) Vonesa apo dështimi i Palës së tillë të zhdëmtuar për të bërë Njoftimin e Zhdëmtimit që kërkohet në pajtim me këtë Seksion 15.4 për Palën tjetër nuk e liron Palën Zhdëmtuese nga obligimi i zhdëmtimit që mund të ketë ndaj asaj Pale të zhdëmtuar, përveç deri në masën që ai dështim apo vonesë ka ndikuar materialisht dhe negativisht mundësinë e Palës zhdëmtuese për të mbrojtur veprimin e tillë apo ka rritur shumën e Humbjeve.
- (c) Pala të cilës i dërgohet Njoftimi për Zhdëmtim duhet të konfirmojë pranimin e atij Njoftimi, me shkrim, brenda shtatë (7) Ditësh Pune pas pranimit të Njoftimit për Zhdëmtim (“**Konfirmimi i Zhdëmtimit**”).

15.4.2 Mbrojtja e Kërkesave

- (a) Pas pranimit të Njoftimit për Zhdëmtim, si dhe me kusht që Konfirmimi i Zhdëmtimit të konfirmojë obligimin për të zhdëmtuar Palën e zhdëmtuar deri në masën e nevojshme sipas këtij Article 15, Pala zhdëmtuese ka të drejtë, me zgjedhjen e vet, të marrë përsipër dhe të kontrollojë mbrojtjen e kërkesës, veprimin, padisë apo procedurës së tillë me shpenzimet e veta dhe me përfaqësues të zgjedhur nga ajo vetë, duke iu nënshtruar aprovimit paraprak të Palës së zhdëmtuar, ndërsa aprovimi i tillë nuk mund të pengohet, kushtëzohet, vonohet apo mohohet pa arsye. Nëse ajo Palë zhdëmtuese zgjedh të marrë përsipër dhe të kontrollojë mbrojtjen e kërkesës, veprimin, padisë apo procedurës së tillë, ajo duhet ta njoftojë Palën e zhdëmtuar për atë zgjedhje në Konfirmimin e Zhdëmtimit.
- (b) Përveç dhe derisa Pala zhdëmtuese konfirmon obligimin e saj për të zhdëmtuar Palën e zhdëmtuar deri në masën e kërkuar sipas këtij Article 15 në Konfirmimin e Zhdëmtimit, si dhe merr përsipër kontrollin e mbrojtjes së kërkesës, padisë, veprimin apo procedurës, Pala e zhdëmtuar do të ketë të

drejtë, por jo obligim, që të kontestojë, mbrojë, si dhe mbrojë në gjyq, me përfaqësues juridik të zgjedhur nga ajo vetë, çdo kërkesë, veprim, padi apo procedurë të cilësdo palë të tretë të ngritur apo pretenduar ndaj asaj Palë në lidhje me, atë që rezulton, lidhet me apo lind nga cilado çështje për të cilën ka të drejtë të zhdëmtohet sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe kostot dhe shpenzimet e dokumentuara, të arsyeshme, si dhe të matura të këtyre veprimeve do t'i nënshtrohen obligimeve të zhdëmtimit, si dhe të rimbursohen menjëherë, nga pala zhdëmtuese sipas kësaj marrëveshjeje.

- (c) As Pala zhdëmtuese e as Pala e zhdëmtuar nuk kanë të drejtë të negociojnë asnjë kërkesë, veprim, padi apo procedurë pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër (ku pëlqimi i tillë nuk mund të pengohet, kushtëzohet, vonohet apo mohohet pa arsye); me kusht, megjithatë, që pas pajtimit me shkrim për të zhdëmtuar Palën e zhdëmtuar, nëse Pala zhdëmtuese fiton zgjidhjen e plotë të çështjeve që kanë të bëjnë me Palën e zhdëmtuar (duke përfshirë, pa u kufizuar në të, lirimin e plotë të Palës së zhdëmtuar nga e gjithë përgjegjësia e mëtutjeshme në lidhje me kërkesat e parashtruara) si dhe vendimet e nevojshme të gjykatës që aprovojnë atë marrëveshje, Pala zhdëmtuese mund të zgjidhë kërkesat e tilla edhe pa pëlqimin e Palës së zhdëmtuar.
- (d) Nëse Pala zhdëmtuese zgjedh të marrë përsipër dhe të kontrollojë mbrojtjen e kërkesës, veprimit, padisë apo procedurës, Pala e zhdëmtuar duhet t'i ofrojë Palës zhdëmtuese informatat që Pala zhdëmtuese mund të kërkojë me arsye, në lidhje me kërkesën, veprimin, padinë apo procedurën, si dhe duhet që (deri në masën përkatëse) të informojë Palën zhdëmtuese plotësisht për zhvillimet materiale në procedimin e kërkesës, veprimit, padisë apo procedurës së tillë.

15.4.3 Shpenzimet e përfaqësimit ligjor

- (a) Pas pranimit të Konfirmimit të Zhdëmtimit dhe marrjes përsipër të mbrojtjes nga Pala zhdëmtuese, Pala e zhdëmtuar do të ketë të drejtë të angazhojë përfaqësuesin e vet ligjor, si dhe përfaqësuesi i tillë mund të marrë pjesë në atë veprim, por tarifat dhe shpenzimet e përfaqësuesit të tillë do të barten ekskluzivisht nga ajo Palë e zhdëmtuar, kurdo dhe sido të shkaktohen, përveç nëse:
 - (i) Angazhimi i përfaqësuesit nga Pala e zhdëmtuar është autorizuar me shkrim nga Pala zhdëmtuese dhe Pala zhdëmtuese është pajtuar të paguajë tarifat dhe shpenzimet e atij përfaqësuesi;
 - (ii) Pala e zhdëmtuar duhet të ketë konstatuar me arsye dhe posaçërisht duhet të ketë njoftuar Palën zhdëmtuese që mund të ketë konflikt interesash mes Palës zhdëmtuese dhe Palës së zhdëmtuar në mbrojtjen e atij veprimi;
 - (iii) Pala zhdëmtuese nuk duhet të ketë angazhuar në fakt përfaqësues të pavarur juridik të kënaqshëm për Palën e zhdëmtuar për të marrë përsipër mbrojtjen e atij veprimi, si dhe duhet të ketë njoftuar për këtë Palën e zhdëmtuar; ose
 - (iv) Pala e zhdëmtuar duhet të ketë konstatuar me arsye dhe posaçërisht duhet të ketë njoftuar Palën zhdëmtuese që mund të ketë mbrojtje specifike në dispozicion të saj që është ndryshe apo plotësuese ndaj asaj që është në dispozicion të Palës zhdëmtuese apo që ajo kërkesë, veprim, padi apo procedurë përmban apo mund të ketë efekt negativ material mbi Palën e zhdëmtuar përtej fushëveprimit të kësaj Marrëveshjeje.
- (b) Nëse zbatohet Paragrafi 15.4.3(a)(i), 15.4.3(a)(ii), 15.4.3(a)(iii), ose 15.4.3(a)(iv), atëherë Pala e zhdëmtuar do të ketë të drejtë të drejtojë mbrojtjen e asaj kërkesë, veprimi, padie apo procedure si e vetme, si dhe tarifat dhe disbursimet, e dokumentuara të përfaqësuesit të pavarur të angazhuar nga Pala e zhdëmtuar përbëjnë shpenzime të zhdëmtuara dhe të rimbursueshme ligjore apo të tjera, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Article 16 Kufizimi i përgjegjësive

16.1. Kufizimi i përgjegjësive

- (a) Përveç nëse shprehimisht parashihet e kundërta me këtë Marrëveshje, asnjëra palë nuk mban përgjegjësi ndaj Palës tjetër me kontratë, detyrim, garanci, përgjegjësi strikte, apo sipas ndonjë instrumenti tjetër ligjor për asnjë lloj dëmi indirekt, pasues, incidental, ndëshkues apo ekzemplar. Pagesat që i detyrohen njërës Palë nga ndonjë palë e tretë konsiderohen dëme direkte, si dhe nuk përjashtohen nga dispozitat paravajtëse të këtij Seksioni 16.1, përveç në lidhje me kontratat (të tjera nga Kontrata OeM dhe Marrëveshja për Shërbime Administrative (siç përkufizohet në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë) dhe Marrëveshjet LTM të miratuara nga NKEC-ja sipas nenit 3 të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë) ndërmjet GenCo-s në njërën anë dhe palë të lidhura me Sponsorin Ultimativ si palë homologe të GenCo-s (të cilat përjashtohen nga dispozitat paravajtëse të këtij Seksioni 16.1(a)).
- (b) Asnjëra Palë nuk mban përgjegjësi ndaj Palës tjetër, përveç në bazë të, apo për shkelje të kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë Marrëveshjeje të Projektit që ka lidhur; me kusht, megjithatë, që kjo dispozitë nuk mëton të përbëjë heqje dorë nga të drejtat e njërës Palë ndaj tjetrës, sa i përket çështjeve që nuk lidhen me këtë Marrëveshje apo ndonjë aktivitet që nuk parashihet me këtë Marrëveshje, si dhe kjo dispozitë nuk mëton të kufizojë apo t'i mohojë GenCo-s të drejtën për të (i) kërkuar dhe fituar të gjitha të ardhurat e humbura shprehimisht të parapara me nenin 20 të Marrëveshjes së Implementimit, apo me ndonjë marrëveshje tjetër të projektit që mundëson atë kthim; ose (ii) zhdëmtuar dhe/ose rikuperuar kostot në lidhje me Gjendet Mjedisore/Arkeologjike të parapara me ndonjë Marrëveshje të Projektit.

Article 17 Shkelja; Shkëputja

17.1. Rastet e Shkeljes nga GenCo

Secila nga pikat vijuese përbën rast të shkeljes nga GenCo (ku secili prej këtyre është “**Rast i Shkeljes nga GenCo**”):

- (a) Dështimi nga GenCo për të kryer pagesën e ndonjë shume për Mihjen e KEK-ut sipas kësaj Marrëveshjeje brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditësh pas pranimit nga GenCo të njoftimit me shkrim nga Mihja e KEK-ut që ajo pagesë është vonuar, njoftim ky që do të specifikojë dështimin e pagesës në hollësi të arsyeshme; me kusht, megjithatë që pagesat që krijohen si pasojë e zgjidhjes së një Kontesti Pagesash, Kontesti Teknik, apo ndonjë Kontesti tjetër nuk konsiderohen borxh për qëllimet e këtij Seksioni 17.1(a) deri në pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune pas zgjidhjes së atij kontesti;
- (b) Emërimi i kujdestarit, administratorit, trustit, apo likuiduesit të GenCo-s, ose të gjitha apo thelbësisht të gjitha asetëve të GenCo-s, në ndonjë procedurë të nisur nga GenCo, sipas rastit, ose emërimi i kujdestarit, administratorit, trustit, apo likuiduesit të tillë në ndonjë procedurë të iniciuar kundër GenCo-s, që nuk shkarkohet brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh pas atij emërimi, ose nëse GenCo jep pëlqimin apo pranon në heshtje atë emërim;
- (c) Çfarëdo zotimi apo garancie të dhënë nga GenCo sipas kësaj Marrëveshjeje vërtetohet të ketë qenë jokorrekte në ndonjë aspekt material në datën e ofrimit apo riafirmimit, si dhe zotimi i tillë i gabuar ka, apo me arsye mund të pritet të ketë efekt material negativ mbi Mihjen e KEK-ut apo Projektin Kosova e Re, si dhe ai defekt nuk mund të sanohet apo nuk sanohet brenda dyzet e pesë (45) Ditësh pas pranimit nga GenCo të njoftimit me shkrim nga Mihja e KEK-ut, njoftim që duhet të specifikojë zotimin e gabuar në hollësi të arsyeshme; me kusht, megjithatë, që nëse GenCo fillon marrjen e veprimeve përkatëse për të sanuar atë defekt brenda periudhës së

përmendur prej dyzet e pesë (45) Ditësh, si dhe më pastaj me vigjilencë vazhdon të bëjë atë sanim, periudha e sanimit zgjatet për nëntëdhjetë (90) Ditë shtesë, për aq sa ai defekt mund të sanohet brenda asaj periudhe të zgjatur të sanimit;

- (d) Dështimi nga GenCo në cilindo aspekt në respektimin apo përmbushjen e ndonjë obligimi tjetër material të GenCo-s të parapara me këtë Marrëveshje që GenCo nuk ka sanuar brenda tridhjetë (30) Ditësh pas pranimit nga GenCo të njoftimit me shkrim nga Mihja e KEK-ut, ku specifikohet dështimi në detaje të arsyeshme dhe me kërkesën që ky të sanohet; me kusht, megjithatë, që nëse GenCo fillon marrjen e veprimeve të përshtatshme për të sanuar atë dështim brenda tridhjetë (30) Ditësh, si dhe më pastaj vazhdon me vigjilencë të sanojë atë dështim, periudha e sanimit do të zgjatet për një periudhë plotësuese prej nëntëdhjetë (90) Ditësh;
- (e) Pas Datës së Bartjes, ngjarja e rastit të Braktisjes (GenCo) dhe që vazhdon për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh pa pëlqim paraprak me shkrim nga Mihja e KEK-ut; dhe
- (f) Ngjarja e ndonjë shkeljeje nga GenCo të detyrimeve të saj sipas Seksionit 20.13;

Me kusht, megjithatë, që asnjë rast i tillë të mos jetë Rast i Shkeljes nga GenCo dhe GenCo do të lirohet nga përmbushja sipas kësaj Marrëveshjeje nëse shkaktohet si e tërë apo në masë të madhe nga:

- (i) Shkelja nga Mihja e KEK-ut apo kundërvajtja nga Mihja e KEK-ut sipas kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë Rastet e Shkeljes nga Mihja e KEK-ut) ose Veprimi apo Mosveprimi i një NP-je të Specifikuar;
- (ii) ose Rasti i dështimit nga QEK-ja (sipas përkufizimit në Marrëveshjen e Implementimit), sipas Marrëveshjes së Implementimit; ose
- (iii) Rasti i Forcës Madhore (përveç në rastin e mospagesës sipas Seksionit 17.1(a)); dhe

Me kusht që, tutje, deri në masën që ndonjë obligim i GenCo sipas kësaj Marrëveshjeje është gjithashtu obligim i GenCo sipas cilësdos Marrëveshjeje tjetër të Projektit, atëherë secili sanim, zgjidhje apo falje e shkeljes së atij obligimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit përbën sanim, zgjidhje apo falje sipas asaj Marrëveshjeje nëse KEK Mihja ka pranuar njoftim të arsyeshëm paraprak të atij sanimi, zgjidhjeje apo faljeje të propozuar të atij obligimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit dhe ka dështuar të kundërshtojë me arsye atë sanim, zgjidhje apo falje brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

GenCo mund të sanojë Rastet e Shkeljes nga GenCo duke mundësuar që Kontraktori i GenCo-s të sanojë atë Rast të Shkeljes nga GenCo.

17.2. Rastet e Dështimit nga Mihja e KEK-ut

Secila nga pikat vijuese përbën rast të shkeljes nga Mihja e KEK-ut (ku secili prej këtyre është “**Rast i dështimit nga Mihja e KEK-ut**”):

- (a) dështimi nga Mihja e KEK-ut për të kryer pagesën e ndonjë shume të detyruar ndaj GenCo-s sipas kësaj marrëveshjeje brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditësh pas pranimit nga Mihja e KEK-ut të njoftimit me shkrim nga GenCo për mospagesën e tillë, njoftim ky që do të specifikojë dështimin e pagesës në hollësi të arsyeshme; me kusht, megjithatë që asnjë pagesë që është e detyruar si pasojë e zgjidhjes së një Kontesti Pagesash, Kontesti Teknik, apo ndonjë Kontesti tjetër nuk konsiderohen borxh për qëllimet e këtij Seksioni 17.2(a) deri në pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune pas zgjidhjes pas zgjidhjes së atij kontesti;
- (b) Emërimi i kujdestarit, administratorit, trustit, apo likuiduesit të Mihjes së KEK-ut, ose të gjitha apo thelbësisht të gjitha asetëve të Mihjes së KEK-ut, në ndonjë procedurë të nisur nga Mihja e KEK-ut, sipas rastit, ose emërimi i kujdestarit, administratorit, trustit, apo likuiduesit të tillë në

ndonjë procedurë të iniciuar kundër Mihjes së KEK-ut, që nuk shkarkohet brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh pas atij emërimi, ose nëse Mihja e KEK-ut jep pëlqimin apo pranon në heshtje atë emërim.

- (c) Çfarëdo zotimi apo garancie të dhënë nga KEK Mihja sipas kësaj Marrëveshjeje vërtetohet të ketë qenë jokorrekte në ndonjë aspekt material në datën e ofrimit apo riafirmimit, si dhe zotimi i tillë i gabuar ka, apo me arsye mund të pritet të ketë efekt material negativ mbi GenCo apo Projektin Kosova e Re, si dhe ai defekt nuk mund të sanohet apo nuk sanohet brenda dyzet e pesë (45) Ditësh pas pranimit nga KEK Mihja të njoftimit me shkrim nga GenCo, njoftim që duhet të specifikojë zotimin e gabuar në hollësi të arsyeshme; me kusht, megjithatë, që nëse KEK Mihja fillon marrjen e veprimeve përkatëse për të sanuar atë defekt brenda periudhës së përmendur prej dyzet e pesë (45) Ditësh, si dhe më pastaj me vigjilencë vazhdon të bëjë atë sanim, periudha e sanimit zgjatet për nëntëdhjetë (90) Ditë shtesë, për aq sa ai defekt mund të sanohet brenda asaj periudhe të zgjatur të sanimit;
- (d) Dështimi nga Mihja e KEK-ut në cilindo aspekt në respektimin apo përmbushjen e ndonjë obligimi tjetër material të Mihjes së KEK-ut të parapara me këtë Marrëveshje që Mihja e KEK-ut nuk ka sanuar brenda tridhjetë (30) Ditësh pas pranimit nga Mihja e KEK-ut të njoftimit me shkrim nga GenCo, ku specifikohet dështimi në detaje të arsyeshme dhe me kërkesën që ky të sanohet; me kusht, megjithatë, që nëse Mihja e KEK-ut fillon marrjen e veprimeve të përshtatshme për të sanuar atë dështim brenda tridhjetë (30) Ditësh, si dhe më pastaj vazhdon me vigjilencë të sanojë atë dështim, periudha e sanimit do të zgjatet për një periudhë plotësuese prej nëntëdhjetë (90) Ditësh; dhe
- (e) Ngjarja e ndonjë shkeljeje nga Mihja e KEK-ut të detyrimeve të saj sipas Seksionit 20.13;

Me kusht, megjithatë, që asnjë rast i tillë të mos jetë Rast i Shkeljes nga Mihja e KEK-ut dhe që Mihja e KEK-ut do të lirohet nga përmbushja sipas kësaj Marrëveshjeje nëse shkaktohet si e tërë apo në masë të madhe nga:

- (i) Kundërvajtja nga GenCo të apo shkelje nga GenCo sipas kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë Rastet e Shkeljes nga GenCo) ose Veprimi apo Mosveprimi i GenCo-s;
- (ii) Rasti i Forcës Madhore (përveç në rastin e mospagesës sipas Seksionit 17.2(a)); dhe

Me kusht, më tutje, që deri në masën që ndonjë obligim i Mihjes së KEK-ut sipas kësaj Marrëveshjeje është gjithashtu obligim i Mihjes së KEK-ut sipas cilësdo Marrëveshjeje të Projektit, atëherë secili sanim, zgjidhje apo falje e shkeljes së atij obligimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit përbën sanim, zgjidhje apo falje sipas asaj Marrëveshjeje nëse GenCo ka pranuar njoftim të arsyeshëm paraprak të atij sanimi, zgjidhjeje apo faljeje të propozuar të atij obligimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit dhe ka dështuar të kundërshtojë me arsye atë sanim, zgjidhje apo falje brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

Mihja e KEK-ut mund të sanojë Rastet e Shkeljes nga Mihja e KEK-ut duke mundësuar që Kontraktori i Mihjes së KEK-ut të sanojë atë Rast të Shkeljes nga Mihja e KEK-ut.

Duke mos anashkaluar paragrafin 3.1.1(d)(iv) e as dispozita të tjera të kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë Marrëveshjeje tjetër të Projektit, dështimi i Mihjes së KEK-ut për të respektuar, apo ndryshe për të ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me, Standardet e Zbatueshme apo ligjet e Kosovës, nuk do të jetë Rast i shkeljes nga Mihja e KEK-ut si dhe nuk do të ketë masa sanuese të asnjë lloji për GenCo-n në lidhje me to, përveç dispozitës së Seksionit 19.2(i) e deri tek Seksioni 19.2(k) të Marrëveshjes së Implementimit (si dhe të gjitha dispozitat e ndërlidhura (në të gjitha Marrëveshjet e Projektit), të cilat parashohin të drejtat dhe mjetet juridike të GenCo-s kundrejt Rastit të Shkeljes nga KEK-ja (sipas definimit në Marrëveshjen e Implementimit) ose në aspektin e mbrojtjes për dobi të GenCo-s në lidhje me ndonjë Veprim apo Mosveprim të NP-së së Specifikuar).

17.3. Njoftimi për QEK-në në lidhje me Rastet e shkeljes nga Mihja e KEK-ut

Nëse ngjan Rasti i Shkeljes nga Mihja e KEK-ut, GenCo duhet të dorëzojë njoftimin (“**Njoftim i Posaçëm i Shkeljes nga QEK**”) për ngjarjen e atij Rasti të Shkeljes nga Mihja e KEK-ut tek QEK-ja në adresën e specifikuar në Marrëveshjen e Implementimit. QEK-ja do të ketë Periudhën e Zbatueshme të Sanimit nga Pala Homologe pas pranimit të Njoftimit të Posaçëm të Shkeljes nga QEK gjatë të cilës duhet të bëhet pagesa ose të ndërmerret veprimi i nevojshëm nga Mihja e KEK-ut sipas kësaj marrëveshjeje me të njëjtin efekt sikur ajo pagesë apo veprim të bëhej apo të ndërmerrej nga Mihja e KEK-ut.

17.4. Njoftimi për Shkëputjen

- (a) Në pajtim me Seksionin 17.4(c), nëse ndonjë Rast i Shkeljes nga Mihja e KEK-ut apo nga GenCo, sipas rastit, ndodh dhe është në vazhdim, Pala që nuk është në shkelje mund të shkëpusë këtë marrëveshje duke dorëzuar njoftimin (“**Njoftimi për Shkëputjen**”) tek Pala shkelëse, njoftim ky që duhet të specifikojë në hollësi të arsyeshme Rastin e Shkeljes nga Mihja e KEK-ut apo GenCo, sipas rastit, që shpie tek Njoftimi për Shkëputje; me kusht, megjithatë, që GenCo nuk mund të dorëzojë Njoftimin për Shkëputje përveç nëse si dhe deri sa të ketë dorëzuar Njoftimin e Posaçëm të Shkëputjes për QEK-në si dhe që periudha e sanimit e paraparë me Seksionin 17.3 të skaduar pa pasur sanim të mundësuar nga QEK; si dhe me kusht, më tutje, që asnjëra Palë të mos mund të dorëzojë Njoftim të Shkëputjes në rast që Marrëveshja e Implementimit shkëputet dhe QEK-ja blen Stabilimentin TCKR në pajtim me nenin 20 (*Të drejtat dhe Obligimet në rast të Shkëputjes; Kompensimi*) të Marrëveshjes së Implementimit dhe kjo Marrëveshje të ripërtërihet në pajtim me Seksionin 17.7.
- (b) Sipas seksionit 17.4(c), nëse cilado Marrëveshje tjetër e Projektit shkëputet në pajtim me kushtet e saj, atëherë secila Palë mund të shkëpusë atë Marrëveshje duke i dorëzuar Njoftimin për Shkëputjen Palës tjetër, njoftim ky që do të specifikojë Marrëveshjen tjetër të Projektit që shkëputet; me kusht, megjithatë, që në rast se (i) ngjan Blerja e aksioneve kontrolluese (sipas definimit në Marrëveshjen e Implementimit) sipas Marrëveshjes së Implementimit, si dhe (ii) kjo marrëveshje duhet të ripërtërihet në pajtim me Skemën 4 (*Rregullimet e blerjes së aksioneve kontrolluese*) të Marrëveshjes së Implementimit, atëherë asnjëra Palë nuk mund të dorëzojë Njoftim të Shkëputjes.
- (c) Sipas Seksionit 17.5, kjo Marrëveshje shkëputet në datën e specifikuar në Njoftimin për Shkëputjen, datë kjo që nuk mund të jetë më e hershme sesa data që është dhjetë (10) Ditë Pune pas datës në të cilën Njoftimi për Shkëputjen i dorëzohet Palës tjetër ose më shumë se tridhjetë (30) Ditë pas datës së atij dorëzimi.

17.5. Obligimet që pasojnë Njoftimin për Shkëputjen

Palët duhet të vazhdojnë të ushtrojnë detyrimet e veta përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje deri në zgjidhjen përfundimtare të ndonjë Kontesti në lidhje me apo që lind nga Njoftimi për Shkëputjen.

17.6. Mjetet tjera juridike

- (a) Përveç sipas parashikimit në këtë Marrëveshje si dhe në pajtim me Seksionet 17.6(b) dhe 17.6(c), ushtrimi i të drejtës së Palës që të shkëpusë këtë Marrëveshje, siç parashihet këtu, nuk e pengon Palën e tillë prej ushtrimit të të drejtave apo mjeteve të tjera që janë paraparë me këtë Marrëveshje apo që janë të mundshme me ligj apo ekuitet; me kusht, megjithatë, që asnjëra Palë të mos ketë të drejtë të shkëpusë apo të trajtojë obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje si të hedhura poshtë, përveç në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Sipas dispozitave të 16 si dhe përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Marrëveshje, mjetet juridike janë kumulative, si dhe ushtrimi, apo dështimi në ushtrim të ndonjëres prej të drejtave apo mjeteve nga Palët nuk e

kufizon e as e pengon ushtrimin, si dhe nuk përbën heqje dorë, nga të drejtat apo mjetet tjera të asaj Pale.

- (b) Duke mos anashkaluar pikat paraprake apo dispozitat tjera të kësaj Marrëveshjeje, Palët pajtohen që në rast se QEK shkëput Marrëveshjen e Implementimit në pajtim me kushtet e vetë Marrëveshjes së Implementimit, QEK blen Stabilimentin TCKR, GenCo i transferon Stabilimentin TCKR QEK-së, në pajtim me kushtet e Marrëveshjes së Implementimit, si dhe secila Palë duhet të ketë paguar të gjitha shumat që bëhen të pagueshme dhe janë borxh sipas kësaj Marrëveshjeje si dhe Marrëveshjeve të Projektit si pjesë e kompensimit për blerje, atëherë, me këtë transfer dhe pagesë, çdo pretendim apo përgjegjësi e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje do të shuhen plotësisht, si dhe asnjëra Palë nuk mund të ketë më pretendim apo mjet ndaj Palës tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç siç parashihet me Seksionin 20.4.
- (c) Duke mos anashkaluar pikat paraprake apo dispozitat tjera të kësaj Marrëveshjeje, Palët pajtohen që në rast se QEK shkëput Marrëveshjen e Implementimit në pajtim me kushtet e vetë Marrëveshjes së Implementimit, QEK blen Stabilimentin TCKR, GenCo i transferon Stabilimentin TCKR QEK-së, në pajtim me kushtet e Marrëveshjes së Implementimit, si dhe secila Palë duhet të ketë paguar të gjitha shumat që bëhen të pagueshme dhe janë borxh sipas kësaj Marrëveshjeje si dhe Marrëveshjeve të Projektit si pjesë e kompensimit për blerje, atëherë, me këtë transfer dhe pagesë, çdo pretendim apo përgjegjësi e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje do të shuhen plotësisht, si dhe asnjëra Palë nuk mund të ketë më pretendim apo mjet ndaj Palës tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç siç parashihet me Seksionin 20.4.

17.7. Obligimet pas Shkëputjes së Marrëveshjes së Implementimit

Në rast se Marrëveshja e implementimit shkëputet dhe QEK blen Stabilimentin TCKR sipas nenit 20 (*Të drejtat dhe obligimet në shkëputje; Kompensimi*) të Marrëveshjes së Implementimit, deri në masën e paraparë me Marrëveshjen e Implementimit, Palët pajtohen që Mihja e KEK-ut të ekzekutojë, bashkë me QEK-në dhe GenCo-n, të gjitha marrëveshjet dhe dokumentet e arsyeshme të nevojshme për të implementuar bartjen dhe ripërtërirjen e kësaj Marrëveshjeje nga dhe pas datës së asaj shkëputjes.

17.8. E drejta e shkëputjes për dështim në respektim të Datës së Transferimit

- (a) Duke mos anashkaluar asnjë dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshjeje, nëse GenCo shkëput Marrëveshjen për Bartjen e Lokacionit në pajtim me Seksionin 5.4 (Shkëputja për dështim në përmbushje të Kushteve Paraprake) të saj, atëherë GenCo ose Mihja e KEK-ut do të kenë të drejtë të shkëpusin këtë Marrëveshje me njoftim për Palën tjetër.
- (b) Duke mos anashkaluar asnjë dispozitë tjetër të kësaj Marrëveshjeje, nëse Gjenerimi i KEK-ut shkëput Marrëveshjen për Bartjen e Lokacionit në pajtim me Seksionin 5.4 (*Shkëputja për dështim në përmbushje të Kushteve Paraprake*) të saj, atëherë GenCo ose Mihja e KEK-ut do të kenë të drejtë të shkëpusin këtë Marrëveshje me njoftim për Palën tjetër.

Article 18 Forca madhore

18.1. Forca madhore

18.1.1 Përkufizimi i Forcës madhore

“**Rasti i Forcës Madhore**” do të thotë cilido rast apo rrethanë apo kombinim i ngjarjeve apo rrethanave (duke përfshirë efektet e tyre) që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një Pale, si dhe që në apo pas Datës së Ekzekutimit, pengon apo vonon përmbushjen, nga ajo Palë (për qëllimet e këtij 8, “Pala e prekur”), të obligimeve të saj brenda apo sipas kësaj Marrëveshjeje (përfshirë aftësinë e Palës për të larguar hirin apo gipsin); me kusht, megjithatë, që ai pengim apo

vonesë të mos mund të jetë parandaluar, tejkaluar apo sanuar, tërësisht apo pjesërisht nga Pala e prekur përmes ushtrimit të kujdesit dhe vigjilencës së arsyeshme.

18.1.2 Rastet që shprehimisht kualifikohen si raste të Forcës Madhore

Pa u kufizuar në Seksionin 18.1.1, “**Rastet e Forcës Madhore**” shprehimisht përfshijnë secilën prej rasteve dhe rrethanave vijuese (bashkë me efektet e tyre), por vetëm deri në masën që secila prej tyre të plotësojnë kriteret e parapara me Seksionin 18.1.1:

- (a) Sa i përket GenCo apo ndonjë Palë të GenCo-s brenda kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit pse Kontratës së Ndërtimit/Mirëmbajtjes, rastet apo rrethanat që ndodhin brenda apo drejtpërdrejt përfshijnë Kosovën (ku secila është “**Rast i Forcës Madhore Politike**”):
 - (i) Akt i luftës (i deklaruar apo i padeklaruar), pushtim, konflikt i armatosur, apo akt i armikut të huaj, bllokadë, embargo, revolucion, trazirë, mosbindje, kryengritje civile, apo akt i një fushate terroriste apo sabotazhit politik;
 - (ii) çdo Kalim i Pëlqimit;
 - (iii) Përveç nëse GenCo ushtron të drejtat që ka në lidhje me Seksionin 19.2(e) të Marrëveshjes së Implementimit, çfarëdo veprimi nga ndonjë Autoritet Publik që shkakton humbje të përhershme apo të përkohshme të posedimit e cila rezulton nga konfiskimi, shpronësimi apo përvetësimi i tërë apo një pjese substanciale të Lokacionit, aseteve të GenCo-s, apo Projektit Kosova e Re;
 - (iv) Kontaminim radioaktiv apo rrezatim jonizues;
 - (v) çdo gjendje të kalimit mjedisor/Arkeologjik;
 - (vi) QEK, Mihja e KEK-ut apo ndonjë NP e Specifikuar është, apo bëhet, Palë e Kufizuar (siç definohet me Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë);
 - (vii) Çfarëdo Rasti i Forcës Madhore Politike sipas ndonjë Marrëveshjeje Projekti; ose
 - (viii) Çfarëdogreve, punime minimale, ngadalësim pune, apo ndonjë veprimi analog të punëtorëve me motivim politik;
- (b) Sa i përket GenCo-s apo një Pale të GenCo-s sipas kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit apo ndonjë Kontrate Ndërtimi/Mirëmbajtjeje, çfarëdo Ndryshimi në Ligj;
- (c) Sa i përket GenCo-s apo një Pale të GenCo-s sipas kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit apo ndonjë Kontrate Ndërtimi/Mirëmbajtjeje, çfarëdo (i) Rasti i Forcës Madhore i lidhur me Ujin Brut ose (ii) Ndryshimi në Ligj lidhur me Ujin Brut; dhe
- (d) Rastet tjera përtej kontrollit të arsyeshëm të Palës së prekur, apo në rastin e GenCo-s, një Pale të GenCo-s të prekur, ose në rastin e Mihjes së KEK-ut, një Pale të prekur të Mihjes së KEK-ut (ku secili është “**Rast tjetër i Forcës Madhore**”), duke përfshirë, por pa u kufizuar tek:
 - (i) Vetëtimë, zjarr, tërmet, cunami, vërshim, thatësi, stuhi, ciklon, tajfun apo tornado;
 - (ii) Ndonjë Rast i Forcës Madhore në NP-në e Specifikuar (siç definohet në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë);
 - (iii) Çfarëdo greve, punime minimale, ngadalësim pune, apo ndonjë veprimi analog të punëtorëve me motivim politik;
 - (iv) Zjarri, eksplozimi, apo kontaminimi kimik që nuk lidhet me ndonjë Gjendje Mjedisore/Arkeologjike të Kaluar Tutje; ose

- (v) Epidemi apo murtajë.

18.1.3 Rastet që nuk kualifikohen shprehimisht si raste të Forcës Madhore

Rastet e Forcës Madhore shprehimisht nuk përfshijnë gjendjet vijuese, përveç dhe deri në masën që rastet apo rrethanat e tilla ngjajnë drejtpërdrejt si pasojë e një Rasti të Forcës Madhore:

- (a) Vjetërimi dhe përdorimi normal i materialeve dhe pajisjeve;
- (b) Avaritë në pajisje;
- (c) Mungesa e fondeve për shkak të arsyeve komerciale, ekonomike apo financiare, duke përfshirë pamundësinë e një Pale që të sigurojë fitime apo për të arritur normë të kënaqshme kthimi;
- (d) Përveç siç parashihet me Seksionin 18.1.2(d)(ii), vonesa në përmbushje të detyrimeve të ndonjë Kontraktori apo furnizuesi (përfshirë liferimin e vonuar të pajisjeve) që rezulton me dështimin e Palës së prekur që të përmbushë obligimet sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (e) Rezultatet apo pasojat e ndonjë shkeljeje nga ndonjë Palë e Ligjeve të Kosovës, kushteve të ndonjë Pëlqimi, apo ndonjërisë prej Marrëveshjeve të Projektit;
- (f) Rezultatet apo pasojat e ndonjë veprimi a mosveprimi të qëllimshëm apo neglizhence nga ndonjëra Palë, apo dështimi nga njëra Palë që të respektojë Praktikat e Matura të Ndërmarrjes ose Praktikat e Kujdesshme Minerare;
- (g) Sa i përket vetëm Mihjes së KEK-ut, Rast i Forcës Madhore Politike, Ndryshimit në Ligj, Rastit të Forcës Madhore lidhur me Ujin Brut, apo Ndryshimi në Cilësinë e Ujit Brut.

18.2. Obligimet e njoftimit

- (a) Nëse, për shkak të një Rasti të Forcës Madhore, Pala është tërësisht apo pjesërisht e paafte të përmbushë obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, Pala e prekur duhet që:
 - (i) T'i dorëzojë Palës tjetër njoftimin për Rastin e Forcës Madhore sa më herët që është praktikisht e mundur, por në asnjë rast më vonë sesa data e mëvonshme prej pesë (5) Ditësh Pune pas marrjes së njohurisë për ngjarjen e Rastit të Forcës Madhore ose nëse Rasti i Forcës Madhore pengon Palën nga ofrimi i njoftimit për Palën tjetër, njëzet e katër (24) orë pas rikthimit të cilitdo mjet të ofrimit të njoftimit ndërmjet Mihjes së KEK-ut dhe GenCo-s; si dhe
 - (ii) T'i dorëzojë Palës tjetër njoftimin e dytë, që përshkruan Rastin e Forcës Madhore në detaje të arsyeshme, si dhe deri në masën që mund të përcaktohet me arsyeshmëri në kohën e atij njoftimi, që ofron një vlerësim paraprak të obligimeve të prekura, një përafrim preliminar të periudhës kohore për të cilën Pala e prekur nuk do të jetë në gjendje të përmbushë ato obligime, si dhe çështjet tjera relevante sa më shpejt që është e mundur, por në çfarëdo rasti, jo më vonë se shtatë (7) ditë pas njoftimit fillestar për ngjarjen e Rastit të Forcës Madhore që është dhënë nga Pala e prekur.
- (b) Kurdo që është e përshtatshme, apo me arsye kërkohet nga Pala tjetër, Pala e prekur duhet të dorëzojë edhe njoftime të tjera për Palën tjetër, duke përshkruar më mirë Rastin e Forcës Madhore dhe shkakun(qet) e saj, si dhe duke ofruar apo përditësuar informatat në lidhje me veprimet e Palës së prekur për të shmangur dhe/ose zbutur efektin(et) e saj deri në masën e mundshme, për kohën që Pala e prekur me arsye parasheh që nuk do të jetë në gjendje të përmbushë ndonjë obligim, e prekur nga Rasti i Forcës Madhore.
- (c) Pala e prekur duhet t'i dorëzojë njoftimin Palës tjetër për:
 - (i) Në lidhje me ndonjë Rast të vazhdueshëm të Forcës Madhore, pushimin e Rastit të Forcës Madhore; si dhe

- (ii) Aftësinë e saj për të rifilluar përbushjen e obligimeve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje;
Sa më shpejt që është e mundur, si dhe në çdo rast jo më vonë se shtatë (7) Ditë pas ngjarjes së cilësdo prej pikave (i) dhe (ii) më lart.
- (d) Dështimi nga Pala e prekur që të dorëzojë njoftimin për Rastin e Forcës Madhore për Palën tjetër brenda periudhës prej pesë (5) Ditësh Pune apo periudhës njëzet e katër (24) orësh të përcaktuar sipas Seksionit 18.2(a) nuk e pengon Palën e prekur që të japë atë njoftim më vonë; me kusht, megjithatë, që në atë rast, Pala e prekur nuk do të lirohet, sipas Seksionit 18.4 nga asnjë dështim apo vonesë në respektim të obligimeve të saj në kuadër apo sipas kësaj Marrëveshjeje deri në dhënien e atij njoftimi. Nëse njoftimi i tillë është dhënë brenda periudhës prej pesë (5) Ditësh Pune apo njëzet e katër (24) orësh siç kërkohet me Seksionin 18.2(a), Pala e prekur lirohet për atë dështim apo vonesë sipas Seksionit 18.4 nga koha e fillimit të Rastit përkatës të Forcës Madhore.

18.3. Detyrimi për zbutje

Pala e prekur duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme (si dhe të sigurojë që Kontraktorët e saj të bëjnë gjithashtu të gjitha përpjekjet e arsyeshme) për të zbutur efektet e Rastit të Forcës Madhore, duke përfshirë pagesën e shumave të arsyeshme të parave nga apo në emër të Palës së prekur (ose Kontraktori i tillë), shuma të cilat janë të arsyeshme në kuptimin e efikasitetit të mundshëm të masave të zbutjes.

18.4. Dështimet apo Vonesat e shkaktuara nga Forca Madhore

- (a) Pas Rastit të Forcës Madhore:
 - (i) Pala e prekur nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dështim apo vonesë në përbushje të obligimeve të saj (përveç ndonjë obligimi për të bërë pagesë apo për të ofruar sigurim) në kuadër apo sipas kësaj Marrëveshjeje gjatë ekzistencës së Rastit të Forcës Madhore por vetëm deri në masën që Pala e prekur ka respektuar obligimet e saj sipas Seksionit 18.3; dhe
 - (ii) Çdo afat të përbushjes brenda të cilit Pala e prekur obligohet ta respektojë sipas kësaj Marrëveshjeje do të zgjatet ditë pas dite për numrin e ditëve për të cilat Pala e prekur është penguar të përbushë obligimet, si pasojë e Rastit të Forcës Madhore, por vetëm deri në masën që Pala e prekur të ketë përbushur obligimet e saj sipas Seksionit 18.3,

Me kusht, megjithatë, që asnjë lloj lirimi, duke përfshirë këtu zgjatjen e afateve për përbushje, nuk i lejohet Palës së prekur sipas këtij Seksioni 18.4 deri në masën që ai dështim apo vonesë që do të pësohej nga Pala e prekur edhe nëse nuk do të ndodhte Rasti i Forcës Madhore.

- (b) Pavarësisht nga sa më sipër, KEK Mihjet nuk do të kenë të drejtë në kërkesëpadi për vete dhe nuk do të lirohen nga detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, nga ngjarja e Forcës Madhore Politike , Ndryshimi në Ligj , Ngjarja e Forcës Madhore të Ujit Brut ose Ndryshimi në Cilësinë e ujit brut.

18.5. E drejta e shkëputjes pas një Rasti të Forcës Madhore Politike apo Ndryshimit në Ligj

Në rast se Marrëveshja e Implementimit shkëputet ose nga QEK-ja ose nga GenCo sipas paragrafit 20.3 (*Shkëputja pas Rastit të Forcës Madhore Politike, Ndryshimit në Ligj, Rastit të Forcës Madhore lidhur me Ujin Brut, apo Ndryshimit Në Cilësi të Ujit Brut*) të Marrëveshjes së Implementimit, atëherë secila palë mund të shkëpusë këtë Marrëveshje duke i dhënë njoftimin Palës tjetër.

Article 19
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

19.1. Njoftimi për Kontestin

Në rast se lind ndonjë Kontest, kundërthënie apo pretendim mes Palëve, që lind nga apo në lidhje me këtë Marrëveshje, apo shkelje, shkeljetje apo vlefshmëri të saj, Pala që dëshiron të deklarojë Kontestin duhet t'i dorëzojë Palës tjetër një njoftim me shkrim që përshkruan çështjen kontestuese në hollësi të arsyeshme.

19.2. Procedurat e Zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

19.2.1 Zgjidhja joformale e mosmarrëveshjeve nga Palët

Pas pranimit të njoftimit nga Pala tjetër për Kontestin, në pajtim me Seksionin 19.1 që përshkruan Kontestin në hollësi të arsyeshme, për një periudhë prej njëzet (20) Ditësh nga data e dorëzimit të atij njoftimi, Palët do të përpiqen që me mirëbesim të zgjidhin atë Kontest me diskutime ndërmjet përfaqësuesve të secilës Palë. Në rast se Palët nuk arrijnë të gjejnë pajtimin brenda asaj periudhe njëzet (20) Ditëshe, apo ndonjë periudhe më të gjatë sipas dakordimit të tyre, atëherë Kontesti zgjidhet në pajtim me procedurat formale të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, të përshkruar me Paragrafin 19.2.2.

19.2.2 Procedurat formale të Zgjidhjes së mosmarrëveshjeve - Forumi i Përshatshëm

- (a) Në rast se Palët nuk arrijnë të zgjidhin Kontestin me diskutime joformale sipas Paragrafit 19.2.1 si dhe ai Kontest është Kontest Teknik apo Kontest Pagese, atëherë ai Kontest zgjidhet me referim tek eksperti në pajtim me Paragrafin 19.3 (në rastin e Kontestit Teknik) ose në pajtim me Paragrafin 19.4 (në rastin e Kontestit në Pagesa), sipas rastit, në secilin rast duke respektuar Paragrafin 19.2.2(f).
- (b) Në rast se Kontesti mund të konsiderohet edhe Kontest Pagese edhe Kontest Teknik, atëherë Kontesti i referohet Paragrafit 19.4 si dhe eksperti i emëruar sipas tij përcakton, në pajtim me Paragrafin 19.4(c), nëse ai Kontest mund të zgjidhet, tërësisht apo pjesërisht, si Kontest Pagese. Nëse eksperti përcakton që Kontesti mund të zgjidhet ashtu, i tërë Kontesti apo pjesët e tij që mund të zgjidhen si Kontest Pagesash zgjidhen sipas Paragrafit 19.4 ndërsa pjesa e mbetur (nëse ka) i referohet dhe zgjidhet sipas Paragrafit 19.3.
- (c) Nëse Palët nuk mund të dakordohen arsyeshmërisht brenda pesë (5) Ditësh Pune mbi atë nëse Kontesti është Kontest Teknik, përcaktimi nëse Kontesti është Kontest Teknik do të zgjidhet sipas Paragrafit 19.3.
- (d) Nëse ndonjëra Palë nuk e pranon rekomandimin e ekspertit në lidhje me Kontestin Teknik apo të Pagesave, ajo mund ta referojë Kontestin për zgjidhje në pajtim me procedurat e përshkruara tek Seksioni 19.5; me kusht, megjithatë, që nëse ajo Palë nuk e ka referuar Kontestin për zgjidhje në pajtim me procedurat e parapara me Paragrafin 19.5 brenda nëntëdhjetë (90) Ditësh pas dorëzimit të rekomandimit nga eksperti, rekomandimi i tillë i ekspertit fiton fuqi obligative ndaj Palëve, deri në masën më të madhe të lejuar me ligj. Nëse eksperti nuk ka dorëzuar rekomandimin e tij tek Palët brenda periudhës kohore të paraparë me Paragrafin 19.3(f) (në rastin e Kontestit Teknik) apo Paragrafin 19.4(f)(në rastin e Kontestit të Pagesave) atëherë secila Palë mund ta referojë Kontestin për zgjidhje në pajtim me procedurat e parapara me Paragrafin 19.5..
- (e) Në rast se Palët nuk arrijnë të zgjidhin Kontestin me diskutime joformale në pajtim me Paragrafin 19.2.1.1 si dhe Kontesti i tillë nuk është as Kontest Teknik e as i Pagesave, atëherë Kontesti zgjidhet në pajtim me Paragrafin 19.5.
- (f) Palët mundën, me pajtim të ndërsjellë, të vendosin të zgjidhin Kontestin (përfshirë këtu Kontestin Teknik dhe atë të Pagesave) në pajtim me Paragrafin 19.5.

19.3. Kontestet teknike

Çdo Kontest Teknik në fushëveprimin e këtij Paragrafi 19.3 duhet të zgjidhet në pajtim me dispozitat vijuese:

- (a) Eksperti duhet të ketë ekspertizë të demonstruar në fushën e Kontestit Teknik, si dhe nuk mund të jetë agjent, i punësuar, apo kontraktor apo ish-agjent, punëtor apo kontraktor i asnjërës Palë të përfshirë, si dhe nuk mund të ketë kurrfarë interesi tjetër për Kontestin Teknik.
- (b) Pala që ka iniciuar dorëzimin e Kontestit Teknik tek eksperti duhet ta njoftojë Palën tjetër për atë veprim, duke nominuar personin që propozon të jetë ekspert nga lista e ekspertëve të paraparë me Skemën 2 këtu. Nëse Palët nuk arrijnë të emërojnë një ekspert nga lista e Skemës 2 apo nuk mund të pajtohen për një ekspert nga lista e Skemës 2, ose nëse Kontesti i Pagesave përmban çështje që kërkojnë një ekspert që nuk është në Skemën 2, Pala që inicion dorëzimin e Kontestit të Pagesave tek eksperti duhet t'i dorëzojë Palës tjetër një njoftim ku nominon personin që propozon të jetë ekspert. Brenda pesë (5) Ditësh Pune nga pranimi i njoftimit të tillë, Pala tjetër njofton Palën iniciuese nëse ai person është i pranueshëm. Nëse Pala që pranon njoftimin e tillë dështon të përgjigjet gjatë asaj periudhe apo njofton Palën iniciuese që personi nuk është i pranueshëm, atëherë nëse eksperti i propozuar nga Pala tjetër është në Skemën 2, ai person do të jetë ekspert për qëllimet e zgjidhjes së Kontestit të Pagesave. Përndryshe, Palët duhet, sa më shpejt që është e mundur, të takohen dhe të diskutojnë në mirëbesim për një periudhë prej pesë (5) Ditësh Pune për t'u pajtuar për personin që do të jetë ekspert. Nëse Palët dështojnë të takohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore ose nuk arrijnë të pajtohen për një ekspert në fund të asaj periudhe pesë (5) Ditësh Pune, Pala që inicion dorëzimin e Kontestit Teknik i kërkon Qendrës për Ekspertizë ICC që të emërojë ekspertin për procedurën ad hok në pajtim me Rregullat për Emërimin e Ekspertëve dhe personave Neutralë të Odës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) me kërkesë që Qendra e Ekspertizës së ICC-së ta emërojë brenda pesë (5) Ditësh Pune, apo sa më herët që është e mundur pas tyre, dhe ai Person i emëruar kështu do të jetë ekspert për qëllimet e zgjidhjes së Kontestit të Pagesave.
- (c) Brenda pesë (5) Ditësh Pune pas pranimi të materialeve të shkruara të parapara me Paragrafin 19.3(d), apo sa më herët që është e mundur pas tyre, eksperti përcakton nëse Kontesti është i mundur të zgjidhet si Kontest Teknik përmes përcaktimit të ekspertit sipas parashikimit të Paragrafit 19.3. Nëse eksperti përcakton që Kontesti nuk mund të zgjidhet ashtu, Kontesti zgjidhet sipas Paragrafit 19.5.
- (d) Pala që ka iniciuar dorëzimin e Kontestit Teknik tek eksperti duhet të dorëzojë, brenda dhjetë (10) Ditësh Pune pas emërimit të ekspertit, tek eksperti dhe tek Pala tjetër, materialet e shkruara që përmbajnë:
 - (i) Përshkrimin e saj për Kontestin Teknik në hollësi të arsyeshme; si dhe
 - (ii) Një propozim të detajuar me shkrim të zgjidhjes së Kontestit Teknik.
- (e) Brenda dhjetë (10) Ditësh Pune pas datës kur Pala i ka dorëzuar materialet e përshkruara në fjalinë paraprahe, Pala tjetër duhet t'i dorëzojë ekspertit dhe Palës iniciuese:
 - (i) Përshkrimin e saj për Kontestin Teknik në hollësi të arsyeshme; si dhe
 - (ii) Një propozim të detajuar me shkrim të zgjidhjes së Kontestit Teknik.
- (f) Secila palë duhet të caktojë një Person me njohuri për çështjet kontestuese që duhet të jetë në dispozicion për ekspertin për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe që të ofrojë informata plotësuese që kërkojnë nga eksperti. Përveç atij Personi, Palët nuk janë të obliguara, por munden, të ofrojë deklarata verbale apo prezantime për ekspertin, apo të vënë në dispozicion individë të caktuar për ekspertin.

- (g) Eksperti do të ketë një periudhë prej dhjetë (10) Ditësh Pune pas pranimit të kundër-propozimi nga Pala jo-iniciuese për të zgjedhur ose zgjidhjen e propozuar të Palës iniciuese ose atë të Palës tjetër si zgjidhje përfundimtare dhe të plotfuqishme të atij Kontesti Teknik duke respektuar të drejtat e Palëve sipas Seksionit 19.2.2(d) dhe Seksionit 19.3(h).
- (h) Përveç siç parashihet me Paragrafin 19.3(i) sa i përket pagesës së shpenzimeve, procedurat sipas këtij Paragrafi 19.3 nuk paragjykojnë Palën tjetër dhe dëshmitë apo deklaratat e dhëna gjatë këtij procesi nuk mund të përdoren kundër Palës në asnjë procedurë tjetër, përfshirë këtu edhe procedurën e arbitrazhit sipas Paragrafit 19.5. Procesi sipas këtij Paragrafi 19.3 nuk do të shihet si arbitrazh, por si zgjidhje e mosmarrëveshjeve, si dhe ligjet në lidhje me arbitrazhin tregtar nuk zbatohen.
- (i) Shpenzimet e angazhimit të ekspertit do të barten në mënyrë të barabartë nga Palët, ku secila Palë bart shpenzimet e veta në përgatitje të materialeve për ekspertin dhe për prezantimet para tij.

19.4. Kontestet në Pagesa

Çdo Kontest Pagesash në fushëveprimin e këtij paragrafi 19.4 duhet të zgjidhet në pajtim me dispozitat vijuese:

- (a) Eksperti duhet të ketë ekspertizë të demonstruar në fushën e Kontestit të Pagesave, si dhe nuk mund të jetë agjent, i punësuar, apo kontraktor apo ish-agjent, punëtor apo kontraktor i asnjërës Palë të përfshirë, si dhe nuk mund të ketë kurrfarë interesi tjetër për Kontestin e Pagesave.
- (b) Pala që ka iniciuar dorëzimin e Kontestit të Pagesave tek eksperti duhet ta njoftojë Palën tjetër për atë veprim, duke nominuar personin që propozon të jetë ekspert nga lista e ekspertëve të paraparë me Skemën 2 këtu. Nëse Palët nuk arrijnë të emërojnë një ekspert nga lista e Skemës 2 apo nuk mund të pajtohen për një ekspert nga lista e Skemës 2, ose nëse Kontesti i Pagesave përmban çështje që kërkojnë një ekspert që nuk është në Skemën 2, Pala që inicion dorëzimin e Kontestit të Pagesave tek eksperti duhet t'i dorëzojë Palës tjetër një njoftim ku nominon personin që propozon të jetë ekspert. Brenda pesë (5) Ditësh Pune nga pranimi i njoftimit të tillë, Pala tjetër njofton Palën iniciuese nëse ai person është i pranueshëm. Nëse Pala që pranon njoftimin e tillë dështon të përgjigjet gjatë asaj periudhe apo njofton Palën iniciuese që personi nuk është i pranueshëm, atëherë nëse eksperti i propozuar nga Pala tjetër është në Skemën 2, ai person do të jetë ekspert për qëllimet e zgjidhjes së Kontestit të Pagesave. Përndryshe, Palët duhet, sa më shpejt që është e mundur, të takohen dhe të diskutojnë në mirëbesim për një periudhë prej pesë (5) Ditësh Pune për t'u pajtuar për personin që do të jetë ekspert. Nëse Palët dështojnë të takohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore ose nuk arrijnë të pajtohen për një ekspert në fund të asaj periudhe pesë (5) Ditësh Pune, Pala që inicion dorëzimin e Kontestit të Pagesave i kërkon Qendrës për Ekspertizë ICC që të emërojë ekspertin për procedurën ad hok në pajtim me Rregullat për Emërimin e Ekspertëve dhe personave Neutralë të Odës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), me kërkesë që Qendra e Ekspertizës së ICC-së ta emërojë brenda pesë (5) Ditësh Pune, apo sa më herët që është e mundur pas tyre, dhe ai Person i emëruar kështu do të jetë ekspert për qëllimet e zgjidhjes së Kontestit të Pagesave.
- (c) Brenda pesë (5) Ditësh Pune pas pranimit të materialeve të shkruara të parapara me paragrafin 19.4(d), apo sa më herët që është e mundur pas tyre, eksperti përcakton nëse Kontesti është i mundur të zgjidhet si Kontest i Pagesave sipas parashikimit të paragrafit 19.4. Nëse eksperti përcakton që Kontesti nuk mund të zgjidhet ashtu, Kontesti zgjidhet sipas Seksionit 19.5; me kusht, megjithatë, që nëse Kontesti është referuar tek ky Paragraf 19.4 sipas Paragrafit 19.2.2(b), Kontesti zgjidhet sipas Paragrafit 19.3.

- (d) Pala që ka iniciuar dorëzimin e Kontestit të Pagesave tek eksperti duhet të dorëzojë, brenda dhjetë (10) Ditësh Pune pas emërimit të ekspertit, tek eksperti dhe tek Pala tjetër, materialet e shkruara që përmbajnë:
 - (i) Përshkrimin e saj për Kontestin e Pagesave në hollësi të arsyeshme; si dhe
 - (ii) Një propozim të detajuar me shkrim të zgjidhjes së Kontestit të Pagesave.
- (e) Brenda dhjetë (10) Ditësh Pune pas datës kur Pala i ka dorëzuar materialet e përshkruara në fjalinë paraprake, Pala tjetër duhet t'i dorëzojë ekspertit dhe Palës iniciuese:
 - (i) Përshkrimin e saj për Kontestin e Pagesave në hollësi të arsyeshme; si dhe
 - (ii) Një propozim të detajuar me shkrim të zgjidhjes së Kontestit të Pagesave.
- (f) Secila palë duhet të caktojë një Person me njohuri për çështjet kontestuese që duhet të jetë në dispozicion për ekspertin për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe që të ofrojë informata plotësuese që kërkohen nga eksperti. Përveç atij Personi, Palët nuk janë të obliguara, por mundën, të ofrojë deklarata verbale apo prezantime për ekspertin, apo të vënë në dispozicion individë të caktuar për ekspertin.
- (g) Eksperti do të ketë një periudhë prej dhjetë (10) Ditësh Pune pas pranimit të kundër-propozimi nga Pala jo-iniciuese për të zgjedhur ose zgjidhjen e propozuar të Palës iniciuese ose atë të Palës tjetër si zgjidhje përfundimtare dhe të plotfuqishme të atij Kontesti Pagesash duke respektuar të drejtat e Palëve sipas Paragrafit 19.2.2(d) dhe Paragrafit 19.4(h).
- (h) Përveç siç parashihet me Paragrafin 19.4(i) sa i përket pagesës së shpenzimeve, procedurat sipas këtij Paragrafi 19.4 nuk paragjykojnë Palën tjetër dhe dëshmitë apo deklaratat e dhëna gjatë këtij procesi nuk mund të përdoren kundër Palës në asnjë procedurë tjetër, përfshirë këtu edhe procedurën e arbitrazhit sipas Paragrafit 19.5. Procesi sipas këtij Paragrafi 19.4 nuk do të shihet si arbitrazh, por si zgjidhje e mosmarrëveshjeve, si dhe ligjet në lidhje me arbitrazhin tregtar nuk zbatohen.
- (i) Shpenzimet e angazhimit të ekspertit do të barten në mënyrë të barabartë nga Palët, ku secila Palë bart shpenzimet e veta në përgatitje të materialeve për ekspertin dhe për prezantimet para tij.

19.5. Arbitrazhi

- (a) Çdo Kontest në pajtim me Paragrafin 19.5 duhet që, sipas Paragrafit 19.5(c), të zgjidhet përfundimisht me Rregulloren e Punës për Procedurën e Arbitrazhit (“**Rregullat ICSID**”) të ICSID, themeluar me Konventën për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve mes Shteteve dhe Shtetasve të shteteve tjera (“**Konventa ICSID**”), si dhe secila nga Palët këtu jep pëlqimin për kompetencën e ICSID-it si dhe arbitrazhit të saj. Secila Palë e kësaj Marrëveshjeje thekson që transaksioni që lidhet me këtë Marrëveshje është “investim” në kuptimin e Konventës ICSID. Palët këtu pajtohen që, edhe pse Mihja e KEK-ut edhe GenCo janë shtetas dhe banorë të Kosovës, ndërsa ose Mihja e KEK-ut ose GenCo, sipas rastit, mund të jenë nën kontrollin e shtetasve të ndonjë Shteti tjetër Kontraktues (sipas termave të përdorur në Konventën ICSID) Mihja e KEK-ut apo GenCo, sipas rastit, trajtohen si shtetas të një Shteti tjetër Kontraktues (sipas termave të përdorur në Konventën ICSID) për qëllimet e Konventës ICSID.
- (b) Deri në masën që cilado Palë e kësaj Marrëveshjeje është NP e Specifikuar (si dhe deri në masën që ajo NP e Specifikuar është Ndërmarrje Publike), theksohet këtu që ajo Palë është Agjenci e QEK-së, si dhe që ajo Palë do të emërohet për ICSID-në nga QEK-ja në pajtim me nenin 25(1) të Konventës ICSID. Në pajtim me nenin 25(3) të Konventës ICSID, QEK-ja ka dhënë pajtimin e saj për pëlqimin e asaj Pale në këtë Marrëveshje për arbitrazh sipas Konventës ICSID.
- (c) Nëse kriteret e juridiksionit sipas nenit 25 të Konventës ICSID nuk plotësohen, ose nëse për ndonjë arsye tjetër Kontesti nuk mund të zgjidhet në pajtim me Rregullat e ICSID-së, Kontesti i

tillë duhet të zgjidhet përfundimisht me arbitrazh sipas Rregullave për Pajtim dhe Arbitrazh të Odës Ndërkombëtare Tregtare (“**Rregullat e ICC-së**”).

- (d) Gjuha që do të përdoret në procedurat e arbitrazhit do të jetë anglishtja.
 - (e) Përveç nëse Palët pajtohen ndryshe, numri i arbitrave do të jetë tre (3), ku arbitrat e tillë duhet të emërohen nga secila Palë që zgjedh një (1) arbitër brenda:
 - (i) Tridhjetë (30) Ditë pas inicimit nga njëra Palë të procedurës së arbitrazhit në pajtim me këtë Paragraf 19.5, për arbitrazh sipas Konventës së ICSID-së; ose
 - (ii) Periudhës së zgjedhjes së arbitrit të specifikuar me Rregullat e ICC-së,
- Si dhe dy (2) arbitrat e zgjedhur kështu, brenda tridhjetë (30) Ditësh pas zgjedhjes së arbitrit të dytë, zgjedhin arbitrin e tretë (3); me kusht, megjithatë, që deri në masën që më shumë se dy Palë marrin pjesë në arbitrazh, Oda Ndërkombëtare e Tregtisë do të caktohet si autoritet emëruar për qëllimet e përzgjedhjes së arbitrave në pajtim me Rregullat e ICC-së si Autoritet Emëruar.
- (f) Asnjëri arbitër i emëruar sipas këtij Paragrafi 19.5 nuk mund të jetë shtetas i juridiksionit të një Pale, e as që arbitri i tillë nuk mund të jetë aksionar, drejtor, punëtor, agjent apo kontraktor apo ish aksionar, drejtor, punëtor, agjent apo kontraktor i ndonjërës Palë.
 - (g) Selia (adresa ligjore) e arbitrazhit është në Londër, Angli.
 - (h) Palët pajtohen që grumbullimi i provave, paraqitja para seancës, si dhe dëgjimi i dëshmitarëve dhe ekspertëve, autorizuar sipas Rregullave 34 deri në 36 të Rregullores së ICSID-së (ose nenit 20 të Rregullave të ICC-së nëse ICC është autoriteti administrues), duhen trajtuar nga tribunali për t’i mundësuar cilësdio Palë që të kërkojë sigurimin e dokumenteve dhe informatave të tjera që me arsye llogariten të shpiejnë drejt zbulimit të provave që janë relevante për pohimet apo mbrojtjen në lidhje me Kontestin, duke përfshirë edhe mjetet vijuese:
 - (i) Procesverbalet e marrjes në pyetje;
 - (ii) Kërkesat për sigurim të dokumenteve, duke përfshirë sigurimin e informatave të ruajtura elektronikisht në format të pranueshëm elektronik në pajtim me Rregullat IBA; si dhe
 - (iii) Një numër arsyeshëm të mjaftueshëm të deklaratave verbale të duhura për lëndën e Kontestit, duke përfshirë deklarinimin e përfaqësuesit të caktuar nga subjekti si agjent i tij për të dëshmuar mbi pikat specifike në emër të tij;

Si dhe që t’i mundësojnë Palës jo-kërkuese që të kundërshtojë ndaj kërkesave të tilla, në të cilin rast, tribunali nxjerr vendim për atë kërkesë.

- (i) Secila Palë duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që këshilltarët, agjentët dhe kontraktorët e saj të jenë në dispozicion për çfarëdo lloj deklarimi dhe mekanizmi tjetër të paraqitjes së dëshmive që urdhërohet nga tribunali sipas dispozitave të parapara me paragrafin 19.5(h).
- (j) Secila Palë bart shpenzimet e veta ligjore dhe shpenzimet tjera në lidhje me arbitrazhin.
- (k) Vendimi i arbitrave është përfundimtar dhe i plotfuqishëm mbi Palët, si dhe nuk i nënshtrohet ankesës.
- (l) Secila Palë mund të parashtrojë mocion në gjykatë kompetente për të konfirmuar vendimin e arbitrazhit. Me kërkesë të ndonjërës Palë, arbitrat do të përpiqen të konfirmojnë atë vendim arbitrazhi në gjykatën më të lartë kompetente në Kosovë si dhe në çfarëdo gjykate tjetër të kërkuar nga Pala.

- (m) Vendimi i arbitrazhit hartohet dhe paguhet në Euro, si dhe vendimi duhet të përmbledhë edhe tatimet, përveç nëse shuma e paguar do t'i nënshtrohej Tatimit nëse paguhet në vazhdë normale.
- (n) Palët heqin dorë nga të drejtat e tyre për të kërkuar apo nxjerrë, si dhe arbitrat nuk do të marrin vendim për dhënien e tyre, dëmeve si masë ndëshkuese, të shumta apo të tjera shembullore, qoftë sipas ligjit formal apo praktikës (përveç deri në masën që ato dëme (i) janë aprovuar me vendim për një palë të tretë dhe i nënshtrohen alokimit mes Palëve ose (ii) shprehimisht janë caktuar të paguhen sipas kushteve dhe afateve të kësaj Marrëveshjeje).

19.6. Kontestet e ndërlihdura

- (a) Tribunali i arbitrazhit mund të përbashkojë rastin e arbitrazhit që lind nga apo ndërlihdet me këtë Marrëveshje me arbitrazhin që lind apo ndërlihdet me një apo më shumë Marrëveshje Projekti, nëse lënda e Kontesteve që lindin apo ndërlihdhen me to kanë substancialisht të njëjtët fakte apo transaksione. bashkimi i tillë i procedurave të arbitrazhit përcaktohet nga tribunali i arbitrazhit që është emëruar për procedurën e arbitrazhit që ka filluar e para në kohë.
- (b) Përveç siç parashihet ndryshe me paragrafët 19.1, 19.3 dhe 19.4, të drejtat e Palëve për të vazhduar me zgjidhjen e kontesteve sipas Paragrafëve 19.1, 19.3 dhe 19.4 do të jenë të pavarura nga të drejtat e tyre apo të drejtat e subjekteve të ndërlihdura për të procedurat me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve sipas cilësdo prej Marrëveshjeve të Projektit. Duke mos anashkaluar pikat paraprake apo ndonjë pikë tjetër që thotë të kundërtën në këtë Marrëveshje, vendosja përfundimtare e një Kontesti në kuadër të dhe në pajtim me ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit do të jetë vendim përfundimtar dhe i plotfuqishëm për të njëjtën lëndë me të cilën ka të bëjë, *mutatis mutandis*, me obligimet e Mihjes së KEK-ut apo GenCo-s këtu.

19.7. Obligimet Vazhdojnë

Vazhdimësia e Kontestit në vetvete dhe për shkak të tij nuk e liron asnjërin Palë nga detyrimet e tyre për të vepruar sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe secila Palë vazhdon të përmbushë obligimet e saj, si dhe ka të drejtë të ushtrojë të drejtat e veta, sipas kësaj Marrëveshjeje, në pritje të zgjidhjes së atij Kontesti, pa kufizuar Seksionin 17.5.

19.8. Aktet komerciale

KEK Mihja pajtohet pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme që ekzekutimi, dorëzimi dhe zbatimi nga ana e saj të kësaj Marrëveshjeje përbëjnë veprimet private dhe komerciale të saj.

19.9. Imuniteti Sovran; Juridiksioni

- (a) Mihja e KEK-ut pa kushte dhe në mënyrë të parevokueshme:
 - (i) Pajtohet që nëse iniciohen procedura ndaj Mihjes së KEK-ut apo asetëve të saj, në cilindo juridiksion, në lidhje me këtë Marrëveshje apo me transaksionet që trajtohen me këtë Marrëveshje, asnjë lloj pretendimi për imunitet ndaj atyre procedurave nuk do të kërkohej as nga ai e as në emër të Mihjes së KEK-ut, për vete apo për asetet e tij;
 - (ii) Heq dorë nga çdo e drejtë e imunitetit që ai apo ndonjë prej asetëve të tij ka tash apo mund të ketë në të ardhmen në cilindo juridiksion në lidhje me ato procedura;
 - (iii) Pajtohet që ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja nga ai e kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë Marrëveshje tjetër e Projektit në të cilën është palë përbën akt të tij privat dhe komercial dhe heq dorë nga cilido kundërshtim që mund të ketë tash apo të përfitojë më vonë sa i përket vendit të ndonjë mocioni apo procedure të iniciuar sipas pajtimit në këtë Paragraf 19.9(a), si dhe specifikisht heq dorë nga kundërshtimet në lidhje me iniciimin e atij mocioni apo procedure në forum të papëlqyeshëm si dhe pajtohet të mos kërkojë apo parashtojë të njëjtin;

- (iv) Pajtohet që dorëzimi i shkresave të rastit në atë mocion apo procedurë mund të bëhet në çfarëdo mënyre që lejohet me ligjin që zbatohet për gjykatën e lartpërmendur; si dhe
 - (v) Jep pëlqim të përgjithshëm për juridiksionin, në lidhje me veten dhe për të gjitha asetet dhe pronat e tij, si dhe pronën që e ka tash apo më vonë mund ta përvetësojë, e cilëso gjykatë me kompetencë për cilindo mocion të parashtruar nga GenCo për të përmbuar vendimin e cilitdo arbitër që është emëruar sipas kësaj Marrëveshjeje për të zgjidhur Kontestin ndërmjet Palëve.
- (b) GenCo pa kushte dhe në mënyrë të parevokueshme:
- (i) Jep pëlqim të përgjithshëm për juridiksionin, në lidhje me veten dhe për të gjitha asetet dhe pronat e tij, si dhe pronën që e ka tash apo më vonë mund ta përvetësojë, e cilëso gjykatë me kompetencë për cilindo mocion të parashtruar nga Mihja e KEK-ut për të përmbuar vendimin e cilitdo arbitër që është emëruar sipas kësaj Marrëveshjeje për të zgjidhur Kontestin ndërmjet Palëve.
 - (ii) Heq dorë nga çdo e drejtë e imunitetit që ai apo ndonjë prej aseteve të tij ka tash apo mund të ketë në të ardhmen në cilindo juridiksion në lidhje me ato procedura;
 - (iii) Heq dorë nga cilido kundërshtim që ka tash apo mund të ketë më vonë për vendin e ndonjë mocioni apo procedure të iniciuar sipas pëlqimeve në këtë Paragraf 19.9(b), si dhe specifikisht heq dorë nga kundërshtimi që ai mocion apo procedurë është iniciuar në forum të papëlqyeshëm si dhe pajtohet të mos kërkojë apo parashtrojë mocion për këtë; si dhe
 - (iv) Pajtohet që dorëzimi i shkresave të rastit në atë mocion apo procedurë mund të bëhet në çfarëdo mënyre që lejohet me ligjin që zbatohet për gjykatën e lartpërmendur.

Article 20 **Të ndryshme**

20.1. Njoftimet

- (a) Të gjitha njoftimet dhe komunikimet tjera të kërkuara apo lejuara për t'u dhënë nga një Palë (përfshirë faturat që kërkohen apo lejohen të dorëzohen këtu) duhet të bëhen me shkrim si dhe të dorëzohen ose personalisht ose me postë të shpejtë ose të dërgohen me faks apo email në adresën apo numrin e Palës tjetër të specifikuar si më poshtë:
 - (i) Nëse është për Mihjen e KEK-ut

Kosovo Energy Corporation J.S.C.
Nënë Tereza nr. 36,
Prishtinë, Kosovë
Për: Arben Gjukaj
Tel: + 381-38-528-684
Faks: + 381-38-527-275
E-mail: arben.gjukaj@kek-energy.com

një kopje për (që nuk përbën njoftim):

Qeveria e Kosovës
Rr. Nene Tereza Nr. 36,
Pristina, Kosovo
Për vëmendjen e: Ministri i Zhvillimit Ekonomik
Faks: _____
E-mail: _____

(ii) Nëse për GenCo:

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.
35-37 Avenue de la Liberté
L-1931 Luxembourg, Grand Duchy of Luxembourg
Për: The board of managers
Tel: + (352) 28 86 78 00
Faks: + (352) 24 52 73 26
Email: CGK_CEO@contourglobal.com dhe
CGK_GC@contourglobal.com

Me kusht, megjithatë, që Pala mund të ndryshojë adresën ku duhen dërguar njoftimet, duke dhënë njoftim paraprak me shkrim së paku tridhjetë (30) Ditë përpara për Palën tjetër në pajtim me këtë nen 20.1.

- (b) Asnjë njoftim e as komunikim nuk është efektiv deri sa të pranohet apo të konsiderohet i pranuar. Njoftimet apo komunikimet tjera konsiderohen të jenë pranuar nga Pala pranuese:
- (i) Kur dorëzohen, nëse dorëzohen personalisht;
 - (ii) Tri (3) Ditë Pune pas dërgimit, nëse dërgohen me postë të shpejtë ndërkombëtare;
 - (iii) Pas dërgimit, nëse dërgohen me faks, pas një konfirmimi të raportit të transmetimit të pandërprerë, si dhe me kusht që kopja në letër të dorëzohet jo më vonë se Dita vijuese e Punës tek pranuesi me postë të shpejtë ndërkombëtare ose dorëzim personal; ose
 - (iv) Pas dërgimit, nëse dërgohet me e-mail, me kusht që kopja në letër të dorëzohet jo më vonë se Dita vijuese e Punës tek pranuesi me postë të shpejtë ndërkombëtare ose dorëzim personal; me kusht, megjithatë, që Palët munden, kohë pas kohe, të pajtohen bashkë me shkrim që nuk nevojiten kërkesat për dorëzim të kopjes në letër, duke marrë parasysht komunikimet operationale të përditshme apo në rutinë të ngjashme.
- (c) Pala që dorëzon njoftimin apo ndonjë komunikim tjetër në pajtim me 20.1nenin duhet që të bëjë përpjekje të arsyeshme komerciale për t'i siguruar Palës pranuese përkthim arsyeshëm të saktë në gjuhën shqipe brenda pesë (5) Ditësh Pune pas dërgimit të atij njoftimi apo komunikimi tjetër në gjuhën angleze; me kusht, megjithatë, që Pala nuk do të jetë e detyruar të ofrojë përkthimin e skicave teknike apo dokumenteve inxhinierike. Në rast të mospërputhjeve ndërmjet origjinalit në anglisht dhe përkthimit në shqip të njoftimit apo komunikimeve të tjera, versioni anglisht do të mbizotërojë mbi versionin shqip. Për të shmangur dyshimet, dështimi në dorëzim të përkthimit të njoftimit apo komunikimeve tjera në pajtim me këtë Seksion 20.1(c)nuk e ndikon efektshmërinë e atij njoftimi apo komunikimeve tjera sipas përcaktimit të Seksionit 20.1(b).
- (d) Në rast se njoftimi i dorëzuar nga GenCo tek Mihja e KEK-ut sipas kësaj Marrëveshjeje obligon Mihjen e KEK-ut ose të jap përgjigje (përfshirë aprovimet apo mos-kundërshtimet) brenda një periudhe të caktuar kohore ose të konsiderohet të ketë aprovuar apo të mos ketë kundërshtuar marrjen e veprimeve nga GenCo, GenCo do të përfshijë në atë njoftim edhe përshtimin e periudhës së përgjigjes si dhe pasojat e dështimit të Mihjes së KEK-ut në përgjigje (përfshirë aprovimin apo mos-kundërshtimin e konsideruar si të tillë).

20.2. Ndryshimet

Ndryshimet apo modifikimet e kësaj Marrëveshjeje hyjnë në fuqi apo bëhen detyruese ndaj Palës vetëm nëse bëhen me shkrim dhe nënshkruhen nga përfaqësuesi i autorizuar i secilës Palë; me kusht, megjithatë, që ndryshimi i tillë të mos ndikojë në obligimet e QEK-së sipas Kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë Marrëveshjeje tjetër të Projektit, përveç nëse QEK-ja është palë e marrëveshjes për ndryshimin e kësaj

Marrëveshjeje (apo versionit të ndryshuar dhe të rishkruar të kësaj Marrëveshjeje), apo nëse QEK-ja ndryshe ka dhënë pëlqimin e për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje.

20.3. Bashkëpunimi, ndihma dhe informimi nga Mihja e KEK-ut

Gjenerimi i KEK-ut duhet të respektojë dispozitat e Paragrafit 3.2 (*Pa Diskriminim; Pa Shpronësim*), Paragrafit 3.4.2 (*Mbështetja në financim*), Paragrafit 3.4.3 (*Pëqlimi për caktimin kolateral*), si dhe Paragrafit 4.4 (*Mbështetja e QEK-së në marrje të pëlqimeve*) të Marrëveshjes së Implementimit sikur ato dispozita të ishin të vlefshme për Mihjen e KEK-ut dhe të ishin pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

20.4. Mbijetesa

- (a) Me skadimin e kësaj Marrëveshjeje apo shkëputjen e mëhershme të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha pajtimet, detyrimet, zotimet, dhe garancitë e kësaj Marrëveshjeje përfundojnë dhe nuk kanë më fuqi a efekt, si dhe Palët nuk kanë më obligime apo përgjegjësi sipas kësaj Marrëveshjeje; me kusht, megjithatë, që pikat vijuese shprehimisht vazhdojnë të mbijetojnë: (i) ato obligime dhe përgjegjësi që kanë lindur para dhe mbesin të papërbushura në datën e skadimit apo shkëputjes, si dhe (ii) ato obligime dhe përgjegjësi që shprehimisht mbijetojnë pas skadimit apo shkëputjes sipas Seksionit 20.4(b).
- (b) Përkundër të gjitha elementeve të përfshira në këtë Marrëveshje për të kundërtën, dispozitat e nenit 1 (*Përkufizime; interpretimet*), nenit 7 (*Rikultivimi i deponisë së hirit të GenCo dhe Deponisë së Gipsit të GenCo*), nenit 15 (*Zhdëmtimi*), nenit 16 (*Kufizimi i detyrimit*), nenit 19 (*Zgjidhja e mosmarrëveshjeve*), nenit 20 (*Të ndryshme*) shprehimisht mbijetojnë çdo ndërprerje apo skadim të kësaj Marrëveshjeje

20.5. Palët e Treta Përfituese

Përveç të drejtave të cekura shprehimisht në këtë Marrëveshje, kjo Marrëveshje është menduar vetëm për përfitim të Palëve dhe asgjë në të nuk interpretohet për të krijuar ndonjë të drejtë, detyrim, standard të kujdesit apo përgjegjësi ndaj çdo personi që nuk është Palë.

20.6. Nuk ka Heqje Dorë

Nga asnjë lloj kundërvajtjeje nga cilado Palë në përmbushje apo respektim të cilësdo dispozite të kësaj Marrëveshjeje nuk mund të hiqet dorë apo të lihet anash përveç me pëlqimin e shprehur me shkrim të Palës tjetër. Asnjë lloj heqje dorë nga cilado Palë ndaj kundërvajtjes së Palës tjetër në përmbushje apo respektim të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nuk mund të veprojnë e as të merret si heqje dorë nga diçka tjetër apo nga ndonjë kundërvajtje tjetër, të një natyre të ngjashme apo të ndryshme.

20.7. Marrëdhënia mes Palëve

- (a) Kjo Marrëveshje nuk është dhe nuk mund të interpretohet apo të merret që krijon ndonjë asocim, sipërmarrje të përbashkët apo partneritet mes Palëve, apo që të imponojë ndonjë detyrim ortakërie apo ndonjë përgjegjësi të ngjashme ndaj cilësdo Palë.
- (b) Asnjëra Palë nuk ka të drejtë, fuqi apo autoritet të lidhë marrëveshje apo sipërmarrje për, të veprojnë në emër të, apo të jetë agjent a përfaqësues, apo ndryshe të obligojë, Palën tjetër, si dhe asnjëra Palë nuk do ta konsiderojë ndonjë palë të tretë si bartëse të të drejtës, fuqisë apo autoritetit të tillë.

20.8. Shpenzimet e Palëve

Përveç sipas dakordimit tek Neni 16 (*Tarifat e Këshilltarëve dhe Inxhinierëve para dhe pas Përmbjlljes Financiare*) të Marrëveshjes së Implementimit apo siç mund të lidhet në ndonjë Marrëveshje tjetër Projekti, ndërmjet Palëve të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha shpenzimet e pësuara nga apo në emër të Palës, përfshirë tarifat dhe shpenzimet e agjentëve, përfaqësuesve, këshilltarëve dhe kontabilistëve të punësuar nga Palët në lidhje me përgatitjen e kësaj Marrëveshjeje dhe konsumimit të transaksioneve të trajtuara me

këtë Marrëveshje, do të barten ekskluzivisht nga Pala që ka pësuar ato shpenzime, ndërsa Pala tjetër nuk ka përgjegjësi në lidhje me to.

20.9. Pëlqimi

Përveç nëse parashihet ndryshe këtu, kurdo që kërkohet pëlqimi apo aprovimi nga Pala nga Pala tjetër, pëlqimi apo aprovimi i tillë duhet të jetë me shkrim, si dhe nuk mund të pengohet, kushtëzohet, apo vonohet pa arsye.

20.10. Gjuha

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën angleze, si dhe versioni në anglisht mbizotëron mbi çdo përkthim. Të gjitha njoftimet, vërtetimet dhe dokumentet e komunikimit tjera (përfshirë kopjet) e dhëna apo të hartuara sipas apo në lidhje me këtë Marrëveshje do të jenë në anglisht.

20.11. Ligji Qeverisë

Kjo Marrëveshje do të rregullohet dhe interpretohet në pajtim me ligjet e Shtetit të Nju-Jorkut.

20.12. Tërësia

Kjo Marrëveshje do të jetë shprehja e plotë dhe përfundimtare e dakordimit mes Palëve mbi çështjet e trajtuara këtu. Përveç Marrëveshjeve të tjera të Projektit dhe dakordimeve apo komunikimeve të kërkuara këtu, të gjitha zotimet, mirëkuptimet, ofertat apo komunikimet tjera të cilitdo lloj, me shkrim apo me gojë, mes Palëve në lidhje me Projektin Kosova e Re para kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet QEK-së dhe Sponsorit Ultimativ më 18 dhjetor 2015, shfuqizohen dhe tërhiqen.

20.13. Caktimi

- (a) Brenda gjashtëdhjetë (60) Ditësh nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje, GenCo mund t'ia caktojë të drejtat, titujt dhe interesat brenda dhe mbi, si dhe të delegojë obligimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, CG Kosovës. Për më tepër, GenCo mund t'ia bartë si kolateral interesat e saj sipas kësaj marrëveshjeje Huadhënësit apo ndonjë Personi tjetër në lidhje me ushtrimin e të drejtave kolaterale të Huadhënësit. Përveç sipas lejitimit të shprehur sipas këtij paragrafi 20.13(a), kjo Marrëveshje nuk mund të bartet nga GenCo tek asnjë palë tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të Mihjes së KEK-ut.
- (b) Sipas paragrafëve 20.13(c) dhe 20.13(d), kjo Marrëveshje nuk mund të bartet nga Mihja e KEK-ut tek asnjë palë pa pëlqimin paraprak me shkrim nga GenCo.
- (c) Palët marrin në njohuri dhe pajtohen që QEK-ja mund të privatizojë, apo të ndajë nga Mihja e KEK-ut, funksionet e kapaciteteve gjeneruese të Mihjes së KEK-ut. Pa anashkaluar paragrafin 20.13(b), në rast se ndodh Riorganizimi apo Privatizimi i Mihjes së KEK-ut, Mihja e KEK-ut mund t'ia bartë të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat në dhe nga kjo Marrëveshje Pasardhësit të Licencuar të Mihjes së KEK-ut nëse (i) QeK pa ndërprerje garanton përmbushjen nga Pasardhësi i Licencuar i Mihjes së KEK-ut të të njëjtave kushte dhe afate si Garanci e Qeverisë, apo që ai sigurim komercial sigurohet për obligimin e Pasardhësit të Licencuar të Mihjes së KEK-ut që në gjykimin e arsyeshem afarist të GenCo-s ofron alternativë adekuate ndaj Garancisë Qeveritare, (ii) Pasardhësi i Licencuar i Mihjes së KEK-ut është arsyeshem i aftë të përmbushë të gjitha të drejtat dhe obligimet e Mihjes së KEK-ut sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe (iii) bartja e tillë nuk do të çojë drejt Efektit Material mbi GenCo-n. Përtërirja e kësaj Marrëveshjeje apo bartja e aseteve nga Mihja e KEK-ut sipas këtij Paragrafi 20.13 nuk e liron Mihjen e KEK-ut nga obligimet e veta sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit apo ndonjë Dokumenti për Financim që ekziston në datën e asaj përtërirjeje, transferimi apo caktimi.

- (d) Pa anashkaluar paragrafin 20.13(a), në rast se QEK-ja merr përsipër të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat e GenCo-s në dhe mbi Stabilimentin TCKR ose (i) me skadimin e afatit të Marrëveshjes së Implementimit sipas Seksionit 20.6 (*Skadimi i Afatit*) të Marrëveshjes së Implementimit ose (ii) sipas Nenit 20 (*Të drejtat dhe obligimet pas shkëputjes; Kompensimi*) të Marrëveshjes së Implementimit pas shkëputjes së Marrëveshjes së Implementimit, GenCo duhet që, deri në masën që parashihet me Marrëveshjen e Implementimit, pa nevojë për pëlqim nga Mihja e KEK-ut, QEK-ja apo ndonjë Person tjetër, t'ia bartë të gjitha të drejtat, titujt dhe interesat në dhe mbi këtë Marrëveshje QEK-së (apo një të caktuari nga QEK-ja, sipas përzgjedhjes në pajtim me kushtet e Marrëveshjes së Implementimit), si dhe pala bartëse do të lirohet nga të gjitha përgjegjësitë apo obligimet sipas kësaj Marrëveshjeje që lindin pas datës së atij caktimi dhe përtërirjeje. Nëse kërkon GenCo, Mihja e KEK-ut ekzekuton, bashkë me QEK-në dhe GenCo-n, të gjitha marrëveshjet dhe dokumentet e arsyeshme dhe të zakonshme të domosdoshme për të implementuar bartjen dhe ripërtërirjen e kësaj Marrëveshjeje nga dhe pas datës së asaj shkëputjeje. Nëse QEK apo Mihja e KEK-ut nuk zbatojnë arsyeshëm këtë Paragraf 20.13(d), GenCo do të ketë të drejtë të shkëpusë këtë Marrëveshje duke i dorëzuar njoftimin Mihjes së KEK-ut. Bartja apo caktimi i asetëve nga GenCo sipas këtij Paragrafi 20.13(d) nuk e liron Mihjen e KEK-ut nga obligimet e tij sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit apo ndonjë Dokumenti për Financim që ekziston në datën e asaj bartjeje apo caktimi.
- (e) Kjo Marrëveshje obligon dhe vlen për dobi të Palëve dhe çdo pasardhës apo të autorizuar që përfiton një interes sipas kësaj Marrëveshjeje në pajtim me Paragrafin 20.13(a) dhe Paragrafin 20.13(b).
- (f) Çdo transferim në kundërshtim me këtë Paragraf 20.13 do të jetë nul dhe i pavlefshëm.

20.14. Kontraktimi

- (a) Secila Palë mund të delegojë përgjegjësitë e saj sipas kësaj Marrëveshjeje tek një apo më shumë Kontraktorë; me kusht, megjithatë, që delegimi i tillë të mos lirojë Palën përkatëse nga obligimet apo përgjegjësitë e saj sipas kësaj Marrëveshjeje. Secila Palë me kontratë obligon të gjithë Kontraktorët e saj të kenë të gjitha aftësitë dhe kapacitetet e nevojshme për të kryer apo për të mundësuar kryerjen e çfarëdo detyre që marrin përsipër në kohë dhe me profesionalizëm, duke zbatuar parime të shëndosha inxhinierike, procedura të menaxhimit të projekteve, procedura të mbikëqyrjes si dhe praktika përgjithësisht të pranura industriale.
- (b) Deri në masën që Pala delegon përgjegjësitë e saj sipas kësaj Marrëveshjeje tek një apo më shumë Kontraktorë, ajo Palë duhet të sigurojë që secili Kontraktor i tillë, të jetë i obliguar, sipas kontratës së saj me atë palë, të përmbushë obligimet e saj në pajtim me Standardet e Aplikueshme. Pala e tillë duhet t'i ofrojë Palës tjetër kopjet e të gjitha kontratave të tilla, kontrata këto që mund të redaktohen sipas nevojës për qëllimet e konfidencialitetit.

20.15. Konfidencialiteti

- (a) Sipas paragrafit 20.15(d), kjo Marrëveshje dhe të gjitha informatat e paraqitura këtu apo në lidhje me këtë Marrëveshje do të trajtohen si konfidenciale, si dhe në pajtim me paragrafin 20.15(c) informatat e tilla nuk mund të zbulohen, tërësisht apo pjesërisht, nga cilado Palë, pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër.
- (b) Ky obligim nuk vlen për informatat që (kur përdoren apo zbulohen) janë bërë publike në mënyrë tjetër që nuk është shkelje e kësaj Marrëveshjeje, apo është marrë, apo ka mundur të jetë marrë, ligjërisht nga Pala.

- (c) Duke mos anashkalar dispozitat e paragrafit 20.15(a), asnjëra Palë nuk obligohet të marrë pëlqimin paraprak të palës tjetër në lidhje me zbulimin e informatave:
- (i) Para drejtorëve dhe punëtorëve të degëve të ndërlidhura të asaj Pale, me kusht që ajo Palë të ketë bërë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që degët e tilla të ndërlidhura të ruajnë konfidencialitetin e informatave të zbuluara me të njëjtat kushte si ato që parashihen me këtë paragraf 20.15;
 - (ii) Para Personave që profesionalisht janë angazhuar nga apo në emër të asaj Pale (duke përfshirë këshilltarët, konsulentët dhe agjentët siguroes të saj); me kusht që Personat e tillë të obligohen nga ajo Palë të ruajnë konfidencialitetin e informatave të tilla si dhe që ajo Palë të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar respektimin e zotimit të tillë;
 - (iii) Para ndonjë departamenti qeveritar apo ndonjë agjencie qeveritare apo rregullative që ka juridiksion mbi atë Palë, por vetëm deri në masën që ajo Palë është e obliguar me ligj që të bëjë zbulimin e tillë;
 - (iv) për:
 - (A) çfarëdo institucioni huadhënës apo tjetër financiar, përfshirë Grupin e Bankës Botërore, në lidhje me financimin apo rifinancimin e operacioneve të asaj Pale, dhe në çdo rast, këshilltarëve, konsulentëve dhe siguroesve të tyre në lidhje me financimin apo rifinancimin;
 - (A) Çfarëdo agjencie vlerësimi (rejtingu), si dhe këshilltarëve, konsulentëve dhe siguroesve të tyre;
 - (B) Çfarëdo investitori aktual apo potencial të ekuitetit, si dhe në çdo rast, këshilltarëve, konsulentëve dhe siguroesve të tyre; ose
 - (C) Çfarëdo pale pranuese të bartjes apo caktimit bona fide (si dhe në çdo rast, këshilltarëve, konsulentëve dhe siguroesve të tyre) të të gjithë apo një pjese të të drejtave dhe interesave të Palës zbuluese sipas kësaj Marrëveshjeje,

Por (në secilin rast) vetëm deri në masën e nevojshme në lidhje me sigurimin e atij financimi rifinancimi, rejtingu, investimi në ekuitet, apo në lidhje me caktimin e propozuar si dhe duke pasur parasysh Personin e tillë apo të caktuarin apo të barturin që pajtohet me atë Palë që të obligohet me dispozitat e konfidencialitetit që janë substancialisht të njëjta me ato që parashihen me këtë nen 20.15; ose
 - (v) Para ndonjë eksperti apo arbitri të emëruar në bazë të si dhe sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.
- (d) Duke mos anashkalar dispozitat e paragrafit 20.15(a), Palët pajtohen që (i) QEK-ja mund ta shpallë këtë Marrëveshje dhe cilëndo prej Marrëveshjeve tjera të Projektit para publikut në çdo moment pas Datës së Bartjes (por vetëm deri në masën që ajo shpallje të jetë e kërkuar me Ligjet e zbatueshme të Kosovës apo politikat e publikimit të QEK-së, si dhe me kusht që informatat e ndjeshme komerciale të redaktohen deri në masën ligjërish të lejueshme), si dhe (ii) që palët, QEK dhe degët e tyre të Ndërlidhura mund të ndajnë secilën Marrëveshje Projekti në pajtim me dispozitat e secilës prej atyre Marrëveshjeve të Projektit. Pas shpalljes së kësaj Marrëveshjeje apo ndonjë pjese të saj para publikut nga QEK, kufizimet e përcaktuara me këtë paragraf 20.15 nuk vlejné më për GenCo-n në lidhje me informatat e tilla të shpallura për publikun.

20.16. Nuk ka përgjegjësi për shqyrtim

Asnjë lloj shqyrtimi apo aprovimi nga Pala të ndonjë marrëveshjeje, dokumenti, instrumenti, skice, specifikimi apo projektimi të propozuar nga ndonjë Palë apo ndonjë inspektim të kryer nga një Palë sipas

kësaj Marrëveshjeje nuk e liron Palën nga përgjegjësia që përndryshe do të kishte për neglizhencën e saj në përgatitjen e asaj marrëveshjeje, dokumenti, instrumenti, skice, specifikimi apo projektimi, apo kryerjen e atyre punëve, apo dështimi në respektim të LiGJeve të zbatueshme të Kosovës, apo që të përmbushë obligimet e Palës në këtë Marrëveshje, e as që Pala mund të jetë përgjegjëse para Palës apo ndonjë personi tjetër për arsye të shqyrtimit apo provimit nga ai të marrëveshjes, dokumentit, instrumentit, skicës, specifikimit apo projektimit apo të inspektimit të tillë.

20.17. Palët homole

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në dy (2) apo më shumë ekzemplarë origjinalë, si dhe secila kopje mund të ekzekutohet nga secila Palë në parafime të ndara, ku secila kopje kur ekzekutohet dhe dorëzohet nga Palët konsiderohet origjinale, por të gjitha këto bashkërisht përbëjnë një dhe të vetmin instrument.

20.18. Sigurimet e mëtutjeshme

Secila Palë ekzekuton të gjitha dokumentet e arsyeshme e të domosdoshme për të vënë në zbatim qëllimet e kësaj Marrëveshjeje.

20.19. Pandashmëria

Nëse ndonjë kusht apo dispozitë e kësaj Marrëveshjeje shpallet nga një gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër me kompetencë që të jetë e pavlefshme, e pavlerë, e paligjshme, e pazbatueshme, apo në kundërshtim me politikat publike, (i) dispozitat tjera të kësaj Marrëveshjeje mbeten plotësisht në fuqi dhe efekt, si dhe nuk ndikohen në asnjë mënyrë nga ai vendim, si dhe (2) Palët duhet të takohen shpejt dhe të negociojnë zëvendësimin e asaj dispozite apo pjese, e cila deri në masën më të madhe ligjërisht të lejueshme, do të zbatohet qëllimin fillestar të Palëve.

20.20. Pavlefshmëria e Pjesshme

Paligjshmëria, pavlefshmëria, apo pazbatueshmëria e cilësdo dispozitë në këtë Marrëveshje, të tërë apo pjesërisht, sipas ligjit të cilitdo juridiksion, nuk ndikon:

- (a) As ligjshmërinë, vlefshmërinë apo zbatueshmërinë sipas ligjit të ndonjë juridiksioni tjetër; e as
- (b) Ligjshmërinë e dispozitave apo pjesëve të tjera të saj.

NË DËSHMI TË KËSAJ, Palët ekzekutojnë dhe dorëzojnë këtë Marrëveshje në Prishtinë, Kosovë, në datën e shkruar si më lart.

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Kosovo Energy Corporation J.S.C.


Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Schedule 1 Përshkrimi i Minerave B&M

Minierat B&M janë ilustruar në hartën më poshtë:



Shtesa 1 - 1

Schedule 2
Lista e Ekspertëve

1. Ekspertët e Kontesteve teknike:

Sipas pajtimit mes Palëve kohë pas kohe.

2. Ekspertët e Kontesteve të Pagesave:

Sipas pajtimit mes Palëve kohë pas kohe.

Schedule 3
Toka e KEK Mihjes

Përshkrimi i Tokës së KEK Mihjes duhet të zhvillohet nga Palët në përputhje me nenin 4.5.